



EKSPRES SPORT

Viti i 18^{te} i botimit
Nr. 233 (4479) E shtunë 25 gusht 2012 Çmimi 30 lekë
(Në Greqi 1.5 euro)

SHOQËRI E RUAJTJES DHE SIGURISË FIZIKE



Rr. "Adem Jashari",
Njësia Bashkiake
Nr. 5, Tiranë

Tel: +355 4 226 7883
Fax: +355 4 224 8470

info@eurogjici-security.com
Cel: 0682022718

Gaz Demi, pronari i ri i Partizanit!

Lulzim Sallaku do të jetë presidenti dhe administratori ligjor

Shuma prej 1.7 milionë eurosh do të shlyhet në këtë mënyrë: Një pjesë e mirë e borxhit që Xhani i ka Demit do të likuidohet brenda vlerës së shitjes, ndërsa pjesa tjetër do të jepen me këste në harkun e disa viteve
faqe 11

Xhani: Largimin tim e kam shpallur më 13 gusht në... "Sport Ekspres"



Aksioneri kryesor: Habitem kur lexova në shtyp që unë qënkam larguar. E kam bërë këtë gjë që 10 ditë më parë në një deklaratë publike në gazetë

Fillon kampionati



... Viori lë futbollin!

Pejiç bën Sinanin, erdhën kampionët!

Vllaznia-Skënderbeu 1-3

REPORTAZH

Në "Loro Boriçi", aty ku gjithnjë "ngelesh borxh"

Shkodra është po ajo. Edhe "Loro Boriçi". Pak asfalt më shumë në rrugën që e rrethon, mjediset e brendshme të bëra gati si për festë, fusha e "qethur" me finesë, shumë fëmijë që shpërndahen në jeshillëk me banderolat ku janë shkruar emrat e ekipeve, një vajzë që thotë në miokrofon, pak si i gjatë "fjalimi", se për ç'janë mbledhur tërë këta njerëz, presidentë klubesh e drejtues të lartë të FSHF-së që e kanë disi ... **f.m.**

f.3

Ndeshjet sot

**Tomori-Tirana
Laçi-Besa
Apolonia-Kastrioti**

Ylli i Bajernit pozon me shokët e skuadrës helvete



Kjo foto e Xherdan Shaqirit ka indinjuar shumë tifozë në rrjetin social, që e thërrasin "tradhëtar" dhe madje përdorin edhe fjalë fyese. Flamuri zviceran është pikturuar gjatë grumbullimit me përfaqësuesen helvete. Në shtator luan kundër...
Shqipërisë

Ky, nuk është shqiptar!

Do të ketë ulje rroge! Bordi, apel Bashës:

Mos e mbaj më Rubion trajner!

Debate në mbledhjen e djeshme me kryetarin. Rubio nuk ishte i pranishëm. A do të pranojë FSHF ta ulë në stol pa kontratë?! Klubi kërkon t'i ulë rrogën, sepse ai nuk është më dhe menaxher. Situatë e paqartë, ka shumë mundësi që vendimi zyrtar të merret të hënën

Absurde!

Tirana është i vetmi klub në Europë që ndeshjen e parë të kampionatit trajneri ende nuk ka firmosur kontratën

Intervista

Marçelo Lipi: "Bardhezinjtë favoritë të qartë, humbja do të jetë dështim"

speciale në faqet 14-15-16

Speciale Seria A

Nis sot kampionati italian, quajeni sezoni i të "varfërve"

Juve mbetet favorite, më pas Interi, Milani, Roma dhe Napoli shpresojnë vetëm te problemet në stolin bardhezi për shkak të dënimit të trajnerit Conte

Sherr Alegri-Galiani te Milani, trajneri kërcënon me dorëheqje

Post "El clasico"

Pike: Të humbësh me Realin është si të hash m...

Bungesliga

Shokon Hajnkes: Iki nga Bajerni në fund të sezonit!

Sot Mavraj përballë Riberi & co

Çiklizëm

"Shpohen gomat", Armstrongut i hiqen 7 titujt e Tour de France për doping!

Hapje kampionësh, Vllaznia 1 - Pejiç 3!

VLLAZNIA 1
SKËNDERBEU 3

Shënues: Smajli 77' / Pejiç 19', 34', 48'
E premtë, 25 gusht 2012, në stadiumin "Loro Boriçi" të Shkodrës
Vllaznia: Vujadinoviç, Smajli, Osmani, Beqiri, Begaj (Shtubina 70'), Nallbani, Delić (Semina 53'), Hysa, Hajdari (Belisha 82'), Rexha, Dragoi. Tr. Sh.Duro
Skënderbeu: Shehi, Radas, Bicaj, Gvozdenoviç, Arapi, Kërçiku (Çaushaj 90+1'), Lilaj, Orelesi, Dimo (Vrapi 64'), Plaku (Kuli 84'), Pejiç. Tr. M.Josa
Gjyqtarë: L.Alla, D.Rexha, D. Kolleshi
Vëzhgues: P.Kotherja
Delegat: I.Shulku
Kartona të verdhë: Osmani, Belisha, Rexha / Lilaj

Golat

19' Pejiç merr bukur një top në zonën e rreptësisë pas një gabimi të mesfushorit malazez, Ivan Delić në mesfushë. Pasi driblon bukur me një lëvizje të trupit Beqirin, i vetëm përballë portierit Vujadinoviç nuk e ka të vështirë ta dërgojë topin në rrjetë dhe **0-1**.

34' Pejiç e gjen mbrojtjen e Vllaznisë në gjumë pas një topi të gjatë të pasuar nga mesfusha. Pasi kalon më lehtësi mbrojtjen, gjendet sërish i vetëm përballë portierit dhe shënon golin e dytë. **0-2**

48' Pejiç përfiton nga një kros i lartë në zonën e rreptësisë shkodrane të ardhur që nga mbrojtja. Ndonse i dubluar mes mbrojtës Beqiri e Begaj, këto të fundit nuk merren vesh me njëri-tjetrin dhe Pejiç shfrytëzon bukur hapësirën që i krijohet. Përsëri përballë portierit shkodran, shënon golin e tretë personal dhe të skuadrës. **0-3**

77' Smajli gjuan fuqishëm me një gjysmë kthesë drejt portës së mbrojtur nga Shehi. Gjuajtja e tij devijohet drejt traversës dhe topi kalon vijën fatale, por rikthehet sërish në një përplasje tjetër në traversë. Shehi mundohet me të gjitha mënyrat për të kapur topin por aty ndërhyjnë dhe Rexha, duke penguar në një farë mënyre portierin, por topi devijohet më pas nga shtylla e majtë e portës korçare, duke përfunduar në rrjetë dhe 1-3.

Filloi kampionati, në orën 17:00, në stadiumin "Loro Boriçi" të Shkodrës. Ishte një ndeshje që ne kemi dëshirë të themi nën ndriçimin e prozhektorëve, pra që të jep përshtypjen se luhet në mbrëmje, por vapa ishte sërish e paparë, aq sa arbitri Alla urdhëroi në pjesën e parë të ndërprerit ndeshja dhe ndërsa futbollistët pinin ujë, ne që e shihnim ndeshjen nga ekrani u bëmë ujë në djersë. Takimi filloi me një rit, që nuk mund të quhet festë, pasi Vioresin Sinani ka lënë edhe zyrtarisht futbollin. E filloi dhe e përfundoi si simbol "fair play" dhe e mbylli me karton të verdhë. Në fakt nuk

ia dhanë, pasi nuk do të luante në fushën e lojës, por sigurisht që do të ketë luajtur nga mendja në shkallët e stadiumit, duke parë skuadrën e tij, që nuk është e gatshme për të fituar titullin kampion, madje mundet në shtëpi si të jetë një skuadër femijësh. Në fillim ishte Vllaznia, që duket se donte t'i tregonte presidentit të Skënderbeut, Ardian Takaj, se e kishte gabim që nuk ishte informuar për kundërshtarët, por e la për ditën e fundit. Dragoi, Hysa dhe Hajdari u munduan të zhbllkojnë rezultatit që në fillim, por flitet vetëm për 15 minutat e para, kur tifozët ende nuk e kishin mbushur

Sulmuesi kroat shënon tre herë në portën e kuqbluve, si për të konfirmuar dhe njëherë se kampionët e Skënderbeut nuk janë shkërmoqur, përkundrazi janë më të fortë se kurrë



stadiumin, madje edhe Sinani nuk kishte mbërritur ende në sektorin e drejtuesve. Më pas është fjala e korçarëve, të cilët kishin paralamëruar që më parë, se kanë një skuadër të ngjashme me të vjetshmen, kur fituan titullin e madh dhe shkuan në të gjitha finalët e mundshme për trofetë e mbetur. Për gjithçka mendon Pero Pejiç, i cili lëviz pak, por gjendet gjithmonë në vendin e duhur. Shënon fillimisht, pas një goditjeje potente, duke mos i lënë asnjë shans portierit malazez të Vllaznisë, Vujadinoviç, të cilin do ta kishte patriot, nëse nuk do të ishte shpërbërë Jugosllavia. Më

pas një gol i dytë, pas një kërcimi të Kërçikut, i cili nja tre mbrojtës që kishte qark tij i trajtoi si minorene dhe në fund është përsëri Pejiç që shënon. Skënderbeu i Takajit thjeshtë dominon, ndërsa Vllaznia duket sikur po luan në Gjirokastër.

Mbase do t'i shohim shkodranët në pjesën e dytë, por në minutat e para as që bëhet fjalë. A po, ka kënduar Bujar Qamili në pushim të dy pjesëve, por ahengu më shumë i ka bërë efekt Orelesit, sigurisht edhe Pejiçit, që sigurisht dje është sjellë shumë keq me portierin Vujadinoviç. Josa luan me logjikë dhe pasi ka mbaruar

Top & Flop

Nëse flitet për Vllaznia - Skënderbeu, atëherë duhet të përmendet, që përballë ishin dy skuadra, njëra që e ka filluar aktivitetin prej kohësh dhe kjo është sigurisht ajo e ardhur nga Korça, ndërsa përballë shkodranët që kanë bërë vetëm stërvitje. Skuadra e Takajit është e sistemuar, ndërsa ajo e drejtuar nga kryebashkiaku i Shkodrës, Lorenc Luka, por sigurisht nuk është konceptuar prej tij, çdon në të gjitha drejtimet. Në qendër të mbrojtjes ishte një gropë e madhe, gjatë të gjithë 90 minutave, por edhe krahët nuk funksionuan. Mënyra se si u mendua për t'u mbuluar Pero Pejiç ishte diletante dhe kroati mundi të bënte gjithçka që kishte mundësi. Ndoshta në një skuadër siç është Vllaznia është e tepërt të fusësh duart pa kriter, pasi kërkohet të ruhet bosh-ti, ashtu siç ka bërë presidenti i ri i Skënderbeut.



Sharjet ndaj Duros!

Trajneri Shpëtim Duro është sharë në mënyrë sistematike nga persona të veçantë në tribunën kryesore dhe nuk ka qenë e bukur t'i dëgjoje nga TV e jo më të ishe në stadium

Tifozë, të fjetur!

Përjashtoj grupimin Ultras, pjesa tjetër e tifozerisë shkodrane ishte thjesht shumë e fjetur. Kontestime ndaj gjyqtarit dhe skuadrës së tyre por jo ndihmë ekipit

Shishe të hedhura

Vllaznia rrezikon një gjobë të majme për hedhje shishesh në pjesën e dytë të ndeshjes. Tifozët nuk pajtoheshin me rezultatit dhe krijuan mini incident që mund ta vuajnë shumë në të ardhmen.

Më të mirët

PEJIÇ - Një mbi të gjitha! Ky është një sulmues i vërtetë, një nga ata që shënon nga çdo pozicion. Skënderbeu ka bërë një superblerje.

ORELESI - është gjithnjë ai, i pakalueshëm dhe jash-tëzakonisht agresiv. Mesfushori shkatërrues më i mirë i këtij kampionati.

KËRÇIKU - nuk bëri mrekullinë, por ky djalë meriton më shumë përkrahje. Luajti një ndeshje të mirë. Një asist për gol realisht i saktë.

Më të dobët

BEQIRI - Mbrojtësi me përvojë i përfaqësueses nuk u ngjiti në asnjë moment në lojën e tij më të mirë.

DELIÇ - Konfuz, duket qartë që ka cilësi, por gabime të papara në markim e në pasim.

HYSA - Hije e vetvetes. Ky lojtar duhet të ishte talenti i madh i ndeshjes!

punë me mbrojtjen shkodrane, që në ndeshjen e djeshme ishin thjeshtë "dezhurnë", apo me talentin e paparë Delić, që i hapi ndeshjen korçarëve, bëri ndërhyrje të zgjuara, duke dërguar në fushë futbollistë që mendojnë më shumë për mbrojtjen. Tani janë shkodranët që duhet t'i bëjnë "hyzmet" spektaklit, nëse kanë dëshirë ta bëjnë një gjë të tillë. Dhe në fakt vendasit tentuan dhe e shënuan një gol, por pas një ekzekutimi spektakolar të Smajlit. Josa e mbyll duke falenderuar Vilmën e "Supersportit", e cila është e bukur, por nuk shënoi asnjë gol, ndërsa Duro,

gjatë një interviste disa minutëshe, e quajti një herë ndeshjen si të barabartë, duke bërë fatkeqin dhe në minutat e fundit deklaroi që Skënderbeu ishte superior. Nëse gaboi mbrojtja mesfusha dhe sulmi, atëherë është normale që don të fitonte Josa. Dhe në fund, ashtu siç nuk e kishim menduar, në fushë u hodhën një mori shishesh plastike nga tifozët që ishin akomoduar në tribunën përballë dhe nëse arbitri anësor do t'i kishte mbledhur pas ndeshjes, padyshim që do të kishte bërë ndonjë lek, por t'i çonte në pikën e grumbullimit.

SAIMIR DEMI



Kryeredaktor: FATMIR MËNERI; Zv/kryeredaktor dhe përgjegjës i sektorit të brendshëm: GJERGJI STEFA;

Përgjegjës i sektorit të jashtëm: ALTIN SHORDI; Redaktor online: DRITAN IKONOMI;

Sektor i brendshëm: SAIMIR DEMI, GJERGJ VYSHKA, ARBI LAÇI, ANTON CICANI, MARIO NIKOLLI, ERJON SALIU

Sektor i jashtëm: VASIL BAKALLBASHI, GJERGJ CICANI, KLODIAN SADE, GENT MEMA

RAIFFEISEN BANK
Dega Nr 1, TIRANË

Nr. i Llogarisë: 4037 / 3621

ADRESA E REDAKSISË:

Rr. "Fadil Rada", Nr. 102
(pranë Agjencisë Telegrafike Shqiptare)

Tel&Fax: 00 355 4 235591 Adresa në Internet: www.sportekspres.com

Kontakt: redaksiaspek@hotmail.com

Vioresin Sinani lë futbollin në një atmosferë madhështore



Golashënuesi më i mirë i të gjitha kohërave për skuadrën e Vllaznisë, Vioresin Sinani i ka dhënë lamtumirën zyrtare futbollit të luajtur. Ceremonia ishte planifikuar nga drejtuesit e skuadrës të zhvillohej para startit të ndeshjes së hapjes së sezonit futbollistik. Nën praninë e mijëra tifozëve shkodrane dhe në thirrjet "Ujku, Ujku, Ujku", Sinani del së bashku me skuadrat i rreshtuar në vijën e parë të Vllaznisë. Më pas ai shkëlmon topin para fillimit të ndeshjes. Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka dhe nënkryetari i Bashkisë, Ritvan Trashani. Presidenti Duka në emër të Federatës i ka dhuruar Sinanit një trofe dhe një çmim për kontributin që ka dhënë në futbollin shqiptar. Nën brohoritjet e tifozerisë shkodrane, të famijlarëve të tij, Sinani është respektuar me një duartrokitje të gjatë nga gjithë tifozët të pranishëm në stadium. Zyrarisht Sinani njuh mbi 200 gola të shënuar në kampionatin shqiptar të futbollit. Ndërkohë që deri tani ai është golashënuesi më i mirë për skuadrën e Vllaznisë.

Të veçantat

■ Të pranishëm në tribunën "VIP" kanë qenë drejtuesit më të lartë të dy skuadrave si të Vllaznisë dhe të Skënderbeut. Në sy ka rënë mungesa e presidentit të kuqbluve Lorenc Luka, por që ishte zëvendësuar nga dy nënkryetarët.

■ Për të ndjekur ndeshjen hapëse të sezonit të ri futbollistik 2012-2013, Federata Shqiptare e Futbollit në bashkëpunim me akademinë e Vllaznisë ka organizuar një ceremoni hapëse me flamuj të vendosur në fushë, që përmbanin emrat e skuadrave pjesëmarrëse në Superligë.

■ I pranishëm në stadium ka qenë dhe presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit Armando Duka, që përveç startit të sezonit të ri, ka respektuar dhe lënien e futbollit për sulmuesin Vioresin Sinani

■ Nuk ka munguar dhe prania e ish-presidentit të Vllaznisë, Valter Fushaj. Përveç tij ka qenë i pranishëm dhe Paro Laço, e figura të tjera të rëndësishme të futbollit për të parë më nga afër supersfidën mes Vllaznisë dhe Skënderbeut.

Sulmuesi kroat, Pero Pejiç vazhdon të tregojë një formë shumë të mirë. Ai e ka nisur kampionatin me një tripletë kundër Vllaznisë, duke dhënë një sinjal të fortë për gjithë kundërshtarët. Në një prononcim për "Sport Ekspres", bomberi u shpreh i kënaqur për debutimin e tij në kampionat me fanelën e Skënderbeut dhe shpreson ta ndihmojë sa më shumë skuadrën me golat e tij. "Jam shumë i lumtur që në ndeshjen time të parë në kampionat me fanelën e Skënderbeut, shënova 3

Pejiç: Askush nuk do ta ketë të lehtë në Shkodër

Sulmuesi kroat e ka nisur me një tripletë sezonin e ri. Ai nuk nxitohet në deklaratën e tij, teksa thekson: "Po mendoj për sfidën e radhës kundër Apolonisë"

gola. Dua të them që ishte një ndeshje shumë e fortë dhe e vështirë për ne. Vllaznia ka një skuadër të mirë dhe një tifozeri të mrekullueshme. Kishim shumë presion prej tyre por për fat të mirë e kaluam me sukses provën e parë e cila është shumë e rëndësishme për ne. Çdo skuadër që do të luajë në Shkodër, ja siguroj që nuk do ta ketë aspak të lehtë. Përsa i përket golave të mi, ndihem i lumtur pasi kjo është detyra ime, të shënoj. Dua ta ndihmoj sa më shumë skuadrën dhe jemi në rrugën e duhur. Nuk

mendoj asnjëherë për numrin e golave që do të kem shënuar deri në fund të sezonit. Gjithçka mendoj është për sfidën e radhës që kemi ndaj Apolonisë. Do të luajmë në fushën tonë dhe mezi po pres të prezantohem edhe para tifozëve tanë. Mendoj që edhe me disa përfundime do jemi më të kompletuar dhe rikthimi i Shkëmbit do e ndihmojë shumë skuadrën. Për mua ai është një ndër lojtarët më të mirë të kampionatit në këto vitet e fundit", përfundoi Pejiç.

MARIO NIKOLLI

3

trofe ka fituar Pejiç në Shqipëri. Një titull kampion, një kupë dhe një superkupë. Po aq gola shënoi edhe në sfidën e djeshme ndaj ekipit të Vllaznisë, në Shkodër

29

vjeç është kroati shtatlart, Pero Pejiç i cili gjatë verës u transferua nga Flamurtari tek Skënderbeu

Duro, zhgënjim nga mbrojtja; Josa: Ishim dhe me fat

Një debutim i hidhur për trajnerin Duro. "Futbolli i tillë është. Ishte një humbje jo normale. Një rezultat i tillë nuk i shkon aspak për shtat ndeshjes së parë. Mendoj që u goditëm në momentin tonë më të mirë pasi krijuam disa situata shumë të mira, para portës kundërshtarë. Gabuam dhe nga pakujdesia jonë kundërshtarit përfitoi. Diferenca na ndëshkoi dhe mund të them që ishte Shehi ai që e shpëtoi Skënderbeun. Ne gabuam si në golin e parë ashtu edhe në të dytin, megjithatë them përsëri që skuadra i kishte mundësitë e saj pavarësisht presionit të tifozerisë. Edhe pasi pësuam gol mund ta kishim barazuar takimin. Në përgjithësi ishte një ndeshje jo shumë pozitive për ne.

Duhet të përmirësohemi në mbrojtje pasi ndaj Skënderbeut, Osmani dhe Beqiri nuk i justifikuan vlerat e tyre. Nga java në javë do të kemi ndryshime. E thashë që në disa raste skuadra jonë ishte superiore por diferencat i bëri Pejiç, pasi ne nuk i shfrytëzuam siç duhet rastet tona. Uroj që ekipi të marrë formën e duhur për sfidat e ardhshme", përfundoi prononcimin e tij tekniku Duro.

Josa-Trajneri i Skënderbeut, Mirel Josa u shfaq mjaft i kënaqur në konferencën për shtyp, pas përfundimit të ndeshjes. "Ishte një fitore e merituar nga ana jonë. Vimin pas një humbjeje në Superkupë dhe djemtë e menaxhuan mjaft mirë situatën. Fitorja



Duro

"Kundërshtari na ndëshkoi në momentin tonë më të mirë. Mund ta kishim barazuar takimin pasi i kishim të gjitha mundësitë për ta bërë këtë gjë"



Josa

"Të hënën dhe të martën do të vendosim përfundimisht për afrimet e bëra. Skuadra ka nevojë për lojtarë pasi kampionati është i gjatë dhe rrugës ka dëmtime e mungesa për arsye kartonash"

e djeshme, nuk ishte një hakmarrje për mua, pasi dihet që trajnerët sot janë në një skuadër dhe nesër në një tjetër. Dua të falenderoj tifozerinë shkodrane për mikpritjen që më bëjnë mua personalisht dhe skuadrës time. Përsa i përket takimit, kishim disa momente jo të mira. Kundërshtari ynë mund të shënonte shumë shpejt por ne ishim shumë me fat. Pas rasteve të Vllaznisë, ne shënuam dhe zhbllokimi i rezultatit na e lehtësoi punën. Ishte një 3-pikësh shumë i vlefshëm. Mund të them që 2-3 lojtarë nuk janë akoma në gjendjen e tyre optimale, për shkak të pushimit që kanë bërë pas Kupave të Europës. Mendoj që javën e ardhshme do të punojmë për të rritur gjendjen fizike të skuadrës dhe dy ditët e para do jetë deçizive për të afruar futbollistët të rinj. Besoj shumë tek dyshja e sulmit Pejiç - Plaku. Mendoj që kam në skuadër sulmuesit më të mirë të kampionatit. Triumfi ndaj Vllaznisë na ndihmon më shumë për të vazhduar përpara", tha trajneri Josa.

Shkodra është po ajo. Edhe "Loro Boriçi". Pak asfalt më shumë në rrugën që e rrethon, mjediset e brendshme të bëra gati si për festë, fusha e "qethur" me finesë, shumë fëmijë që shpërndahen në jeshillëk me banderolat ku janë shkruar emrat e ekipeve, një vajzë që thotë në miokrofon, pak si i gjatë "fjalimi", se për ç'janë mbledhur tërë këta njerëz, presidentë klubesh e drejtues të lartë të FSHF-së që e kanë disi të vështirë të zënë vend në tribunën vogël VIP: sidoqoftë, gjithçka gati për start. Nuk është ajo që pritej e megjithatë për vapën që është duhet të jesh i kënaqur me numrin e shikuesve të pranishëm, sidomos në tribunën karshi. Në atë anësore janë vendosur jo shumë djem të grupimit "Vllaznit", që gjithsesi e kanë aftësinë "për të bërë zhurmën" e zakonshme. OK, deri këtu...

Pas nxemjes së zakonshme lojtarët u drejtohen edhe një herë dhomave të zhjveshjes. Në stolin e vendasve, gati-gati me një lloj përtësje është ulur Zydi Çoba, doktori "I përjetshëm"

i Vllaznisë. "I sati kampionat asht? 74,a? E po unë i kam kalua nja 75 trajnerë", thotë Zydia, që edhe pse mund të jetë i saktë për këtë shifër, nuk është në gjendje të thotë saktësisht se kur e ka nisur këtë zana. "Loro Boriçi" është po ai. Stëmadh dhe me idenë e të pakufishmes - krijuar më së shumti, jo nga përmasat e një impianti olimpiq, se sa nga pjesa anësore në krahun jugor sot e kësaj dite e papërfunduar - ai është i tillë edhe në shpirt. Mirel Josa që shkel pas ca kohësh (jo aq sa për t'u "hamuar") në cilësinë e trajnerit "amik", përipiqet të shkojë drejt stolit të Skënderbeut pa u ndjerë. Ndoshta ka pritje edhe ndonjë romuz. Por, jo: mjafton që dikush të thërrasë dhe të gjithë ata që janë në tribunën qendrore, në kor, brohorasin emrin e tij.

Reportazh

Në "Loro Boriçi", aty ku gjithnjë "ngelesh borxh"

Një tjetër emër që do të thirret - këtë radhë shumë më fort, dhe kjo është mëse e pritshme - është ai i Vioresin Sinanit. "Ujku" ka zgjedhur këtë ditë për t'u ndarë me publikun. Në ato hapa "të fundit" drejt karshisë që ngrihet e tëra në këmbë për ta përshëndetur. Edhe pse kjo lamtumirë ka kohë që është lajmëruar, dhe në një farë mënyre je ambientuar me "varjen e këpucëve në gozhdë", sërish ndjen një lloj boshllëku tek e sheh që del në pistë e heq nga trupi fanelën e ua dhuron fansave. Është simbolike, pasi Viori u ka falur atyre shumë më tepër se një fanelë...! Ndaj duket krejt normale që në fushë zbresin, si presidenti i FSHF-së Duka, ashtu dhe nënkryetari i Bashkisë së Shkodrës, Troshani. Një pllakatë, një titull mirënjohje, gjithsesi duken pak për atë që ka

prej 1997-së largët në fushën e futbollit. Ajo që "godet" është kur mëson se në klub gati-gati e kanë vendosur që fanelën me numër 9 "ta heqin nga qarkullimi". Dhe të kujtoshe se atë fanelë, para tij e ka pasë veshur "një farë" Sabah Bizi!

Pjesa tjetër, ndeshja, edhe pse ka katër gola, "kapërdihet" me vështirësi. Kuqeblutë pranojnë përunjshëm supermacinë e kampionëve dhe për Pero Pejiçin është gati një lojë fëmijësh të shënojë tre herë, në tre rastet e vetme që iu paraqitën, apo i krijoi. Tifozeria vendase e pranon, por dhe e vuan. Ndaj duket sikur "i vë shkrepset" kur pas një gjuajtje të Smajlit, rënies së topit në tra e pastaj tej vijës fatale, anësori në krahun e karshisë i përgjigjet me vonesë me flamar. Kaq mjafton që ai "i ziu" të pësojë tërë dufin e të dërmuarve tifozë. Dhe krejt pa zë, me ndonjë ofshamë a të sharë më së shumti nëpër dhëmbë, largohen nga shkallët e "Loro Boriçi" duke e kthyer kokën pas. A thua se fusha u kishte ndonjë borxh...

FATMIR MWNERI

Prag Bylis-Flamurtari/ **Ndeshja luhet të dielën, ora 17:00, në Berat**

Muça "urdhëron" mjekët: E dua Memellin në fushë!

Edhe dje, sulmuesi Memelli nuk është stërvitur me grupin, por ka kryer vaprime të lehta rreth fushës. Këtë i ka rekomanduar stafi mjekësor, ndaj Memelli ka zbatuar gjithçka deri në fund. Ndërkohë pas stërvitjes, trajneri Muça ka zhvilluar një takim me mjekët, ku pasi është njohur me gjendjen e sulmuesit, iu ka lënë detyrë, që të punohet për ta bërë gati futbollistin për ndeshjen e ditës nesërme, atë ndaj Bylisit.

Trajneri i Flamurtarit ka filluar që dje të mendojë zgjidhjet e tij, për të kompozuar sulmin vlonjat edhe pa Memellin e Sozën. I detyruar të ndryshojë skemën e vendosjes, nga 4-4-2 në 4-2-

3-1, Muça ka provuar në stërvitjen e djeshme të luaj me Brunild Pepën si sulmues të deklaruar dhe pas tij të vendos tre mesfushorët, Muzakën, Vukçević dhe Lenën dhe diku pak më larg tyre dyshen kroate Bratiç-Pezo. Kurse në mbrojtje, të konfirmuar do të jenë përpara portierit Koliqi, mbrojtësit Arbëri, Rajović, Veliu dhe Mici. Në prononcimin e bërë me këtë rast, trajneri Muça është shprehur: "Është një zgjidhje e detyruar, nga dëmtimet që kemi të Memellit dhe Sozës, por skuadra në sulm funksionon mirë. Asgjë nuk duhet quajtur e përfunduar".

MOISIDALIPI



Memelli

Në kampin vlonjat janë duke dhënë dorën e fundit përgatitjeve, për ndeshjen e hapëse të kampionatit, atë të ditës nesërme kundër Bylisit. Besimi për ta fituar këtë ndeshje është prezent tek çdo futbollist, si dhe konfirmohet edhe nga kapiteni Franc Veliu: "Edhe pse kemi në dispozicion edhe një ditë tjetër për të mbyllur përgatitjet tona për këtë ndeshje, mendoj se gjithçka është gati, për ta nisur mbarë kampionatin e ri. Tani duhet vetëm mobilizim dhe përqendrim nga të gjithë futbollistët". Por ndoshta problemi i Flamurtarit nuk është në sektorin e tij, pasi bashkë me të në mbrojtje do të jenë edhe Arbëri, Mici, apo Rajović, por edhe të tjerët, që janë të gatshëm për ta ndihmuar skuadrën tonë, për ta fituar me çdo kusht këtë ndeshje. Ne si mbrojtës garantojmë vetëm që të mbrojmë portën, ndërsa më pas duhet të mendojnë edhe të tjerët". Por të djelën, Flamurtari do të ketë një

Veliu: Betejat ia kemi lënë të shkuarës

Mbrojtësi: Kundër ballshiotëve, jo më një atmosferë e tendosur



Veliu

tjetër ndeshje të vështirë, pasi ballshiotët nuk janë treguar shumë të dashur me skuadrën nga Vlora gjatë viteve të fundit. "Sidokoftë, ndeshja do të luhet diku tjetër, në Berat, dhe nuk ka shanse të përsëriten ato "beteja" të viteve të kaluara. E vetmja gjë që mund të përsëritet në këtë ndeshje është fitorja e ndeshjes të fazës parë të kampionatit kaluar, kur Flamurtari fitonte në Ballsh me rezultatin 3-1. Por nuk duhet të harroni, që përballë do të kemi një skuadër të fortë, e cila nuk impresionohet nga emri i kundërshtarit, ndërsa ne na duhet të bëjmë maksimumin", përfundon mbrojtësi i Flamurtarit, Franc Veliu.

Tifozët përgatisin udhëtimin për në Berat

Sapo morën njoftimin në fillim të javës, se ndeshja e parë e kampionatit Bylis - Flamurtari do të luhet ditën e dielë, në orën 17:00, në stadiumin e qytetit të Beratit, tifozët vlonjatë kanë filluar përgatitjet për të qenë të pranishëm, në mbështetje të skuadrës së tyre. Dje është mësuar, se ata do të jenë të shumtë në numër dhe kanë kërkuar nga klubi t'iu caktohet tribuna e tyre në stadiumin "Tomori".

Poli kundër Klodit, një ndeshje brenda familjes

Sulmuesi i Bylisit, Klodjan Arbëri, duket se e ka "ngacmuar" nipin e tij, mbrojtësin e djathtë të Flamurtarit, Polizoi Arbërin, kur është shprehur në shtyp: "Nipi duhet të ketë respekt për xhaxhain". Kaq është dashur, që të reagojë edhe Polizi. "E ka provuar xhaxhai edhe dy herë të tjera, kur ka qenë në fushë kundër nipit të tij. Sa për tifozët, ai mund të sjelli në stadium

vetëm dhjetë beratas të moshës tij, kurse mua më kanë thënë fjalën grupet ultrase të moshës time, nga lagjet Mangalem dhe Kala, se do të mbështesin Flamurtarin dhe mua në këtë ndeshje. Në rolin e specialistit për të bërë vlersimin e paraqitjes në ndeshje për të dy ne, unë propozoj të jenë Theodhori dhe Arben Arbëri".

M.D

Këtu Bylis

"Rekord ndërkombëtar" Një koloni afrikane në qytetin e naftës

Presidenti i Bylisit, Besnik Kapllanaj, ka sjellë në Ballsh 15 futbollistë të huaj, një pjesë e të cilëve do të huazohen në skuadra të tjera

Skuadra e Bylisit, këtë sezon të ri futbollistik do të mbahet mend gjatë për numrin më të madh të lojtarëve të huaj, të përfshirë në radhët e saj. Presidenti i Bylisit, Besnik Kapllanaj, nuk ka hezituar të investojë, për të pasur sërish një skuadër të niveleve të larta. Në këtë kampionat, përveç maqedonasit Kire Ristesveski dhe brazilianit Da Silva, të cilët kanë dy sezona që luajnë me Bylisin do të jenë edhe disa futbollistë nigerianë, si Adebaio, Bola dhe Izuçuku, të cilët u aktivizuan dhe bindën me lojën e tyre. Por gjithsesi, numri i nigerianëve vazhdon të sh-

tohet edhe me 17-vjeçarët Piter dhe Santos, të cilët konsiderohen si talente dhe me shumë prespektivë. Por nuk mbaron këtu numri i lojtarëve afrikane. Në kampin ballshiot kanë mbërritur edhe të tjerë, si Ajali, Tay, Xhejms, Akim,

Natyrish që ditën e diel, sportdashësit ballshiotë presin nga skuadra e tyre një rezultat pozitiv, duke shpresuar sigurisht tek ky grup futbollistësh, të cilët tashmë janë konfirmuar si pjesë e formacionit

Kenedi, Mikail, Ibrahim dhe Ambrose. Gjithsesi, sita e trajnerit të Bylisit, Agim Canaj do të vazhdojë deri në fund të gushtit, kur është edhe afati i fundit i merkatos, për të vendosur se cilët nga të huajt e fundit do të qëndrojnë në Ballsh. Edhe pse rregullat e FSHF-së janë të tilla, që nuk lejojnë më shumë se pesë lojtarë të huaj në fushë, kjo nuk e ka penguar presidentin e Bylisit, Kapllanaj, për të vazhduar "rekrutimin" e futbollistëve nigerianë. Madje, një pjesë e tyre janë huazuar te skuadra të tjera, siç është Elbasani dhe një pjesë tjetër do të vazhdojë të huazohet nga skuadra të tjera. Ndërkohë, një pjesë e tyre do të jenë prezent në ndeshjen hapëse të kampionatit, që Bylisi do ta luajë kundër Flamurtarit, në stadiumin "Tomori" të Beratit. Dhe flitet për futbollistë shumë të rëndësishëm të formacionit të Canajt.

ENEAMETAJ

Vëmendja e Bylisit është përqendruar tërësisht tek ndeshja e parë e kampionatit me Flamurtarin. Madje skuadra është akomoduar në Kuçovë, ndërsa seancët stërvitore i ka zhvilluar në Berat. Trajneri i Bylisit, Agim Canaj, pothuajse e ka konceptuar formacionin, megjithëse nuk kanë mundur edhe problemet. Mesfushori Gërxho është i dëm-

Izuçuku-Gërxho të dëmtuar, Canaj shqetësohet

tuar dhe nuk do të jetë as i grumbulluar për këtë ndeshje. Gjithsesi, ajo që është shumë shqetësuese për stafin e Bylisit ka të bëjë me sulmuesin Izuçuku, i cili për shkak të një viroze nuk

ka dalë në stërvitje. Mjekët e skuadrës, pas një kure intensive shpresojnë, që futbollisti afrikane të rikuperohet dhe të mund të aktivizohet në ndeshjen me Flamurtarin. Në kampin ballshiot ndihet optimizëm. "Jemi të karikuar në maksimum", thotë njëri nga lojtarët më në formë tek Bylisi, Hektor Idrizi.

E.M.

www.sportekspres.com

The screenshot shows the website's interface with a navigation menu including 'FUTBOLL', 'SHUMESPORTESH', 'SPORT BOTA', 'GOSSIP', 'OPINIONE', and 'KONTAKT'. A main article titled 'Ejani, kampioni!' is featured, along with other news items like 'Nga Vendi' and 'Gazeta ne PDF!'. The website is dated '24 gusht 2012'.

➤ Ndiqni ndeshjet e kombëtares, e klubeve tona në Europë dhe të Superligës në kohë reale në faqen tonë të internetit

➤ Lajmet më të fundit, gjithçka rreth aktualitetit të futbollit shqiptar, kombëtares, legjionarëve dhe ngjarjeve nëpër botë

➤ Forum, sondazhe dhe komente, për të gjithë ata që duan të bëhen pjesë e zërit të "Sport Ekspres"

Tomori-Tirana/ **Ndeshja luhet sot, në 17:00, në Berat**

Debate në mbledhjen e djeshme me kryetarin.

Rubio nuk ishte i pranishëm. A do të pranojë FSHF ta ulë në stol pa kontratë?! Klubi kërkon t'i ulë rrogën, sepse ai nuk është më dhe menaxher. Situata e paqartë, ka shumë mundësi që vendimi zyrtar të merret të hënën

Nga Gjergji STEFA

Diferencat ndonjëherë mes zyrtares dhe praktikës nuk janë shumë të mëdha. Në Tiranë e zakonshme të polemikave (provoni t'ua thoni gazetarëve...) ka gjithnjë të reja dhe pavarësisht se reja është e këndshme për t'u shitur e pse jo për t'u lexuar, telenovela e spanjollit Rubio në stolin e Tiranës po bëhet kaq e bezdisshme, sa dhe tanimë, edhe tifozë më indiferent ka filluar, pasi të shqetësohet dhe të qeshë nga humori që po krijon klubi bardheblu në lidhje me pankinën. Rubio sot do të ulet në stolin e Tiranës pa një kontratë të firmosur dhe nuk dihet ende nëse delegate i FSHF-së do ta pranojë apo jo një gjë të tillë. Çudira bardheblu!

Mbledhja - dje bordi drejtues i Tiranës ka kryer një takim së bashku me

Do të ketë ulje rroge!

Bordi, apel Bashës: Mos e mbaj më Rubion trajner!

Absurde!

Tirana është i vetmi klub në Europë që ndeshjen e parë të kampionatit trajneri ende nuk ka firmosur kontratën

Popullor!

Rubion nuk e dorëdo drejtues por ai ka një popullaritet të jashtëzakonshëm në mjedisin bardheblu, sidomos mes lojtarëve e patjetër mes tifozëve!

Fitues!

Rubio në një vit qëndrimi te Tirana ka fituar tre trofe dhe gjithashtu ka kaluar një tur në Europë!

Superpagesë!

Rubio është pa asnjë diskutim trajneri më i paguar ndonjëherë në kampionatin shqiptar të futbollit!

kryetarin Basha për të diskutuar në lidhje me çështjen e trajnerit. Pikë së pari u arrit akordi në unison që trajneri nuk do të përfitoj 170 mijë euro në dy sezona, aq sa ishte thënë fillimisht. Kjo për shkakun se teknikut iu premtua kjo shifër duke pasur parasysh premtimin e tij se do të bënte menaxherin. Në një mbledhje të Rubios disa ditë më parë, ai e pranoi se nuk e kish bërë mirë detyrën e menaxherit, duke mos arritur të sjellë lojtarët e duhur te Tirana dhe kjo thënie e tij në diskutim e sipër mesa duket u mor si legjitime. Njëherazi Basha pyeti të gjithë anëtarët e bordit nëse sipas tyre duhet apo jo mbajtur Rubio si trajner. Të gjithë pa përjashtim thanë që nuk duhet të ishte më trajner i Tiranës, madje kish dhe nga ata që e akuzuan Rubion rëndë. Basha i dëgjoi të gjithë, megjithatë

Rubio: Nuk jam nervoz, por kontrata është një gjë serioze

Trajneri spanjoll: Dhe në Superkupë isha pa kontratë. Sevilja në Tiranë? Ok, gjë e bukur

Trajneri Rubio mesa duket nuk dëshiron ta ndryshojë filozofinë e tij të përgjigjeve dhe, edhe në këtë situatë e krizës së kontratës mendon për sfidën kundër Tomorit.

-Ajeni i bezdisur nga fakti që kontrata nuk është nënshkruar?

- Jo! Për mua s'ka problem. Unë kam asnjë problem të firmos sepse dua të rri, por kontrata duhet të jetë konform rregullave.

-E pamundur të mos jeni nervoz në këto kushte?

- Jam gjithnjë i qetë. Kemi bërë dymbledhje deritani dhe asnjëherë nuk është folur për kontratën time.

-A do të qëndroni te Tirana?

- Ndoshta, por nuk mund ta them. Ndoshta deri në 31 gusht e

realizojmë akordin. Unë isha gati të firmosja dhe përpara ndeshjes me Alesundin dhe kjo nuk ndodhi.

-Ajeni në dijeni se ka pasur një mbledhje bordi?

- Ata mund të mbledhen kur të duan.

-Ashkohet me motivin e duhur në Berat?

- Shkojmë gjithnjë për të fituar. Luajmë përballë një skuadre që kërkon të na prishë planet, por nuk heqim dorë nga synimi për të marrë tri pikët.

-Akeni një skuadër të plotë?

- Ka lojtarë që janë në gjendje të mirë por ka dhe nga ata që nuk kanë arritur formën. Por gjithsesi të gjithë kanë përqendrimin e duhur.

-A do luani medysulmues?

- Vetëm këtu dëgjoj që duhet luajtur me dy sulmues. Nuk dua ta diskutoj më këtë histori.

-Sido operohet në merkato?



- Është një temë delikate sidomos kur flitet për lojtarë që nuk i ke parë. Ofrohen lojtarë që kanë luajtur vetëm disa minuta. Megjithatë klubi po punon në këtë drejtim

-A e doni që do të vijë Sevilja për të luajtur një ndeshje miqësore ndërkohë që mund të vijë dhe Barcelona?

- Jo, nuk e dija. Për mua është kënaqësi e madhe. Kam shumë miq në të dy kampet.

nuk tutej nga opinioni se ndoshta ai duhet të jetë trajneri i bardhebluve. Në fund si rëndom në mbledhjet e Tiranës nuk u vendos asgjë zyrtare. Basha autorizoi Taganin që sot të diskutojë sërish në lidhje me trajnerin për kontratën, por nuk ka shumë optimizëm se Rubio do të tërhiqet nga kërkesat e tij financiare. Shumica e palëve thanë se Rubio do ta pranojë gjithsesi kontratën e re, por ajo që binte në sy gjatë mbledhjes ishte mllefi që anëtarët e bordit flisnin për trajnerin spanjoll. Të jetë vetëm xheloz? Është për t'u theksuar që Tagani dhe Tafaj nuk morrën pjesë në diskutime teknike por vetëm relacion në lidhje me situatën.

E ardhmja-Basha kërkoi nga palët më shumë bashkëpunim. Ai i kërkoi në veçanti Fortuzit dhe Memës që të jenë pranë stafit dhe trajnerit në këtë fund merkato. Një gjë e tillë nënkupton që Basha ka dëshirë që Rubio të vijojë të jetë trajner i Tiranës. Nga ana tjetër, ai kërkoi që kjo çështje përfundimisht të mbyllet ditën e hënën.

Reklama-Tirana ka ulur shumë pikë si klub në mënyrën se si po menaxhon situatën e stolit. Bardheblutë pretendojnë të fitojnë titullin kampion, ndërkohë që edhe pas ndeshjes së parë askush nuk di të thotë nëse spanjollit do të jetë apo jo në krye të pankinës. Pa as më të voglin dyshim që Tirana është i vetmi klub europian që ditën e parë të kampionatit nuk ka një trajner zyrtarisht në stol. Dëshitim i klubit!

Formacioni, Abilalialaj ende pa karton

Duro dhe Lika do të luajnë pas Çotës. Sina nuk luan, të hënën mund të bashkohet me Flamurtarin. Kalari në të djathtë

Tirana sot kundër Tomorit nuk do të luajë me formacionin më të mirë. Elvis Sina nuk do të luajë për bardheblutë pasi mund të shkojë në Vlorë të hënën, ndërkohë që Pashaj është ende i dëmtuar. Ferraj gjithashtu vuan dëmtim, ndërkohë që nga ana tjetër Abilalialaj ka ende probleme me dokumentacionin.




Tomori/ Mile "shkelmon" topin: Tiranën do ta mundim me... tifozë

Sfida që do të luhet sot me Tiranën ka ngritur në këmbë jo vetëm Beratin, por edhe rrethinat afër qytetit muze. Parashikohet që në stadium të jenë mbi 6000 mijë shikues. Skuadra është e motivuar dyfish. Dje, beratasit kanë zhvilluar seancën e fundit stërvitore, në prag të përballjes së shumëpritur me bardheblutë. Trajneri Mile është optimist dhe ka deklaruar: "Do të futemi në fushë për të fituar, madje Tiranën do e mundim vetëm me tifozë. E respektojmë si emër, por lojtarët e mi do e thyejnë sot". Nga tekniku Mile, është bërë mëse e qartë edhe për "Sport Ekspres", se Tomori do të luaj me skemën 4-4-2.

Nostalgji-Sot në skuadrën e Tomorit janë disa nga përfaqësuesit dhe protagonistët e skuadrës nënkampione të vitit 2000, teksa në pankinë është e njëjta dyshe drejtuese si Mile dhe Kovaçi, po kështu Madrid Muxhaj që ishte kapiten dhe portier, së bashku me qendërmbrojtësin Fani, sot gjenden në stafin si trajner portierësh dhe tjetri si fizioterapist. Pra, ka vërtetë pak aromë nga finalja e madhe e Elbasanat, ballafaqimi i sotëm në Berat.

Përgatitjet e tifozëve-Nga ana e tifozerisë "Ultras Tigrat" është përgatitur një dekor festiv që do të kulmojë me shpalosjen e një baneri të madh 20 metra i gjatë, ku në të janë kompozuar dy nga

Berati në këmbë për të mundur Tiranën. Tifozët dhe drejtuesit kërkojnë fitore me çdo kusht ndaj bardhebluve



EDISPAHIU

12 vjet

më parë është zhvilluar në Elbasan, finalja e kampionatit për titullin kampion, Tirana-Tomori, ku beratasit e quajtën fitore të vjedhur

6000

tifozë pritët që të bëjnë tifo sot për Tomorin

Laçi-Besa/ Sot në ora 17:00, në stadiumin e Laçit

Laçi, kapiten është një i Kombëtares

Skuadra laçiane do të presë sot në orën 17:00 në stadiumin e saj ekipin e Besës. Shumë risi dhe ndryshime tek skuadra kurbinase për këtë sezon. Largimi i Erjon Xhafës ka lënë skuadrën pa kapiten dhe shiritin për sezonin e ri do ta mbajë talenti Erjon Vucaj. Një tjetër vlerësim ky për 21-vjeçarën i cili padyshim ka kaluar verën më të suksesshme pasi luajti në Champions me Skënder-

3

sezone
ka luajtur Vucaj me ekipin e Laçit. Sot ai do të startojë të katërtin rradhaz. Falë punës së madhe që ka bërë, nga një lojtar që nuk grumbullohej në 18-tëshe, sot është bërë kapiten



Vucaj

Vucaj merr shiritin këtë sezon, ndërkohë që një vit më parë këtë e mbante Erjon Xhafa

beun, u grumbullua me Kombëtares dhe ka pasur shumë oferta nga jashtë vendit. Në një prononcim për "Sport Ekspres", shkodrani ka treguar objektivat e tij personale dhe emocionet për "gradimin" si kapiten i skuadrës. Vucaj do të jetë lojtari më i ri në Superiore që do të mbajë një shirit kapiteni. "Sot do të luajmë një sfidë të cilën e kemi pritur prej shumë kohësh. Na ka munguar shumë fusha jonë dhe sigurisht që për ne lojtarët do të jetë një emocion i veçantë që do të luajmë në praninë e tifozëve tanë. Besoj që stadiumi do të jetë i mbushur plot dhe përkrahja e tyre do të na ndihmojë shumë".

MARIO NIKOLLI



Ka formacion sulmues

Trajneri Përparim Daiu ka provuar dje 11-tëshën bazë që mund të luajë sot ndaj Besës që nga minuta e parë. Në formacionin e kurbinasve tani nuk mungojnë alternativat dhe kavajasi pritët të hedhë në fushë lojtarë sulmues si Nimani, Bilibashi, Vucaj, Abazaj dhe Emurllai.

Optimizëm në Facebook

Tifozët e skuadrave të Laçit dhe të Besës në prag të sfidës së sotme janë shprehur optimistë që skuadrat e tyre do ta fitojnë takimin. Sharje dhe ofendime nuk ka pasur, pavarësisht mendimeve të ndryshme. Gjithsesi, fusha do të vendosë se cila palë ka menduar drejt para fillimit të takimit.

Pritet firma e Oluasinës

Drejtuesit e klubit të Laçit e kanë përpiluar kontratën për nigerianin Abe Oluasina dhe menaxheri i futbollitit e ka marrë atë në dorëzim. Tani, laçianët janë të pritje të emailit që do të vijë me kontratën e firmosur nga nigeriani, i cili e ka shtyrë ardhjen në Shqipëri për shkak se skuadra e tij ka kaluar një tjetër tur në Champions.

Portieri Alban Hoxha, Bruno Dita dhe Florent Haziri me shumë mundësi nuk mund të luajnë në sfidën e sotme kundër Laçit. Drejtuesit e klubit kanë hasur vështirësi për regjistrimin e tyre në FSHF. Portieri Hoxha ka kontratë me Kastriotin dhe drejtuesit krutanë kanë dërguar një padi për Hoxhën i cili nuk është paraqitur në stërvitje gjatë gjithë kësaj periudhe nga grumbullimi i skuadrës deri sot. Ndërkohë që Bruno Dita nuk e ka marrë akoma lejen e kalimit nga skuadra e Dinamos. Të njëjtin problem si Dita ka edhe mesfushori Haziri i cili është akoma i regjistruar tek skuadra e Tiranës.

Hoxha-Qendërmbrojtësi me shumë përvojë i Besës, shtatlarti Ernad Hoxha nga burime të sigurt, mësohet se po kërkohet me ngulm nga ekipi i Kukësit. Madje, drejtuesit e skuadrës veriore, kanë kërkuar që lojtari mos të aktivizohet në sfidën e sotme kundër Laçit, në mënyrë që transferimi i tij në Kukës, mos të ketë shumë vështirësi. Vetë futbollisti ka thënë se nuk ka nënshkruar një kontratë të re me Besën, më saktë ta rino-

Gjoha e kartona, katër probleme për Besën

Hoxha është paditur nga Kastrioti, Haziri nuk ka marrë lejen e kalimit nga Tirana, ndërsa Dita vuan të njëjtin problem me Dinamon. Ndërkohë mbrojtësi Hoxha kërkohet nga Kukësi

vonte atë sepse ashtu sikurse me lojtarët e tjerë që kanë nënshkruar duke marrë edhe një këst parash, për të nuk ka ndodhur kjo gjë. Ndaj dhe mes dyshimit për mos shlyerjen e parë fillestare, por dhe kërkesës për të luajtur rolin e tij si titullar në formacion, dyzimi i futbollitit tani ka shpërthyer për të bërë një tjetër largim nga Besa. Hoxha në fakt nëse do të kalojë te Kukësi do ta ketë të tretën lëvizje në karrierën e tij. Mbrojtësi ka luajtur 122 ndeshje në karrierën e tij dhe ka shënuar dy gola në kampionatin e fundit në radhët e Besës.

Uniformat

Besa do të zbrësë sot në fushën e lojës me uniformat e saj të reja, verdhezi. Ndryshimi është se fanelat do të mbajnë logon "Dajti Ekspres". Baza materiale ka mbrtur dje dhe pas stërvitjes i janë shpërndarë 18 futbollistëve që janë përfshirë në grupin që do të udhëtojnë në transfertën e sotme.



Apolonia-Kastrioti/ Ndeshja luhet sot në 17:00, në "Loni Papuçiu"

Gjithnjë çështje parash, portieri grek qëndron 24 orë

Trajneri i fierakëve, Ernest Gjoka gjithsesi, shpreson që të ketë mbështetjen e tifozëve, për ta nisur me fitore në premierën me Kastriotin. Portierit grek, Mitrushis, s'i pëlqejnë kushtet

Portieri grek, Ilija Mitrushis, duket se do të rikthehet në Greqi, sepse nuk u përshtat siç duhet me kushtet në Fier. Të paktën këtë e kanë konfirmuar edhe burime pranë menaxherit të lojtarit. Ndërkohë, trajneri Ernest Gjoka, sot do të debutojë në Superiore me Apoloninë, të cilën e ka drejtuar me sukses edhe në Kategorinë e Parë, para dy

edicionesh. Në një prononcim që ka dhënë enkas për "Sport Ekspres", trajneri i fierakëve, Ernest Gjoka, ka pohuar: "Sot është ndeshja e parë e këtij sezoni dhe ne e kemi vlerësuar shumë, aq më tepër që luajmë në "shtëpi", ndaj Kastriotit në sytë e tifozëve tanë të zjarrtë. Kam besim te Apolonia ime, sepse jemi një skuadër shumë e fortë dhe



me kualitete. Këshilla ime për lojtarët që do të luajnë është që ata të realizojnë me përpikmëri detyrat e ngarkuara nga unë. Duhet ta fillojmë mbarë, duke kaluar me sukses Kastriotin dhe javë pas javë optimizmi do të shtohet, - u shpreh fillimisht trajneri i fierakëve, Gjoka.

ARBËR EMIRI

3 skuadra

ka drejtuar trajneri Gjoka, Apoloninë në të parën para dy sezonesh si dhe Kamzën e Tomorin në Superligë



Do 50.000 euro, nigeriani Ibrahim largohet nga fierakët

Një nga titullarët e skuadrës fierake, Ibrahim Adevale, i cili u huazua nga Bylisi sezonin e kaluar, nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Gjokës. Lojtari dhe klubi i Bylisit që ka kartonin e tij kanë kërkuar 50 mijë euro. Klubi fierak nuk ka hyrë fare në negociata dhe Ibrahim është rikthyer në Ballsh.

Dy Erjon Xhafa në qendër të Kastriotit

Kastrioti, është treguar aktiv në merkato, duke qenë se ka pasur shumë largime titullarësh. Skuadra krutanë, dje ka bërë të vetin edhe qendërmbrojtësin lushnjar, Erjon Xhafa, i cili ka luajtur edhe në të shkuarën me këtë ekip në Superiore. Xhafa, kishte disa ditë që stërvitej në Fier, megjithatë oferta e kru-

tanëve e ka bërë për vete shtatlartin që dje është vënë nën urdhrat e trajnerit të krutanëve, Artan Mërgjyshi. Së bashku me Erjon Xhafën tjetër (të birin e mesfushorit të shquar të Dinamos së tri dekadave më parë, Gani Xhafa) krijohet një dyshe me të njëjtin emër në mbrojtje.

ERJON SALIU

5 serbë ka në përbërje skuadra krutane, Boroviciani, Laziç, Prodanoviç, Ashçeric



Kukësi-Luftëtari/ Ndashja zhvillohet të dielën, në orën 17:00

Në qytetin verilindor të Kukësit, këtë fundjavë do të organizohen shumë dasma, por të gjithë shprehen se dasma më e madhe do të jetë ajo që do të bëhet në stadiumin "Ze-qir Ymeri", ku skuadra kukësi-ane luan për të parën herë në Superiore, në praninë e qindra tifozëve, në duelin ndaj Luftëtarit. Gjithsesi, siç deklaroi edhe kryetari i këshillit bashkiak, njëkohësisht edhe anëtari i kryesisë së klubit të futbollit, Bari Elezi, se kjo ditë është e shënuar, por edhe e veçantë në historinë e sportit. "Po presim në këtë duel miqtë nga Gjirokastra. Për vetë ndeshjen, pastaj edhe si fillim i sezonit, ne kemi marrë të gjitha masat organizative që futbollistët e Luftëtarit, stafi teknik e të gjithë ata që e shoqërojnë atë në Kukës, do të gjejnë një ambient tepër vëllazëror. Ne kërkojmë që kundërshtari ynë të vijë që ditën e shtunë në Kukës dhe të akom-

Një qytet në stadium: Këtë radhë s'ka dhunë

Kukësi premtan që situata kundër Luftëtarit të jetë e qetë dhe jo si në sfidën e fundit të sezonit të shkuar

dohet në një nga hotelet e qytetit tonë. Gjithashtu, mendoj se duhet të lëmë pas edhe disa anë negative që janë manifestuar nga ne, në takimin e zhvilluar sezonin e kaluar ndaj Luftëtarit. Për të gjitha këto nuk dua të vë kryefjalë dhe do t'ia lëmë të kaluarës dhe tani të mendojmë për duelin e rradhës. Falenderojmë kolegët tanë gjirokastritë për kërkesën që kanë bërë që në stadiumin "Ze-qir Ymeri", i penalizuar, të marrin pjesë edhe tifozët kuksianë. Në ditën e inaugurimit të një feste të madhe", përfundoi Elezi.

ZYLFI TOLA



Në foto: Në stadiumin e Kukësit sapo janë instaluar stolat e rinj



Në foto: "Sport Ekspres" ka qenë e para në 21 gusht që në formë zyrtare ka deklaruar që ndeshja ndërmjet Kukësit dhe Luftëtarit do të luhej me dyer të hapura. Madje gazeta njoftoi se Kukësi më pas, gjashtë ndeshjet e ardhshme do t'i luajë pa praninë e tifozëve, sipas vendimit të Disiplinës

Luftëtari/ Shenaj: Jemi të qetë, presionin e kanë vendasit

Fejzo Shenaj, është një nga afrimet më të rëndësishme që presidenti Bime ka kryer gjatë merkatos verore. I rikthyer pas pesë sezonesh në ekipin "mëmë", mesfushori i njohur, pas një dëmtimi që pësoi në ditët përparime në Greqi, tani është rikuperuar plotësisht dhe garanton një rendi-

ment maksimal. Gjithashtu, ai ka besim se Luftëtari, në përballjen çelëse të garës, do të kryejë një paraqitje mbresëlënëse.

- Pësuat një dëmtim në fazën përparime në Greqi, duke mos ju lejuar të stërviteni për një kohë të konsiderueshme. Aktualisht, a

është i gatshëm Shenaj për përballjen e së dielës?

- Dëmtimi më veçoi nga përgatitjet me grupin për rreth 10 ditë, por tani jam plotësisht i rikuperuar. Kam punuar fort ditët e fundit dhe jam në dispozicion të trajnerit Dede. - Si e konsideroni ekipin vendas, kur drejtuesit e tij

27 vjeç është mesfushori gjirokastrit i Luftëtarit i cili pas tre sezonesh tek Shkumbini, është rikthyer në Gjirokastrë 3 gola ka shënuar Shenaj sezonin e fundit, me skuadrën peqinase

kanë kryer një merkato të fuqishme?

- Ekipi i Kukësit është forcuar dhe është një kundërshtar shumë i fortë. Nënvlërësimi do të jetë gabimi më i madh. Sigurisht, nuk luhet me emra, por me atë që jep në fushën e lojës. Intervistoi: PIRRO QIQI

Shkumbini-Teuta/ Ndashja luhet nesër, në Peqin, në orën 17:00

Përballja e parë e kampionatit është në prag dhe peqinasit ndihen të gatshëm për të pritur Teutën. Kapiteni Lorenc Pasha, në një prononcim për "Sport Ekspres" është shprehur optimist që skuadra e tij do të marrë rezultat pozitiv në përballjen e parë. Ekipi i Shkumbinit nuk i ka lënë mënjane vështirësitë, që siç duket do të jenë pjesë edhe këtë fillim kampionati, por pikërisht kjo i ka bërë ata edhe më të fortë. Për këtë, mbrojtësi Pasha i sheh të motivuar të gjithë ekipin për të arritur një rezultat pozitiv. "Do ta nisim sezonin e ri me një ndeshje në fushën tonë dhe kjo është një gjë e mirë për ne. Jemi koshient që përballë kemi një ekip shumë të mirë, nënkampionët e vendit. Skuadra e Teutës, gjithnjë ka qenë një ekip i vështirë për ne, ndaj kjo na detyron të jemi të kujdesshëm dhe të mos e nënvlerësojmë aspak situatën. Fakti që do të luajmë në shtëpi, por pa tifozët tanë, është padyshim një argument për t'u përmendur. Megjithatë tashmë është e qartë se kampionati është në

Shkumbini/ Pasha: Me Teutën e nisim me fitore

start dhe duhet të bëjmë një nisje pozitive. Për mua mendoj se kjo ndeshje vlen sa gjysma e fazës së parë. Nëse e nisim me fitore, morali i ekipit do të jetë i lartë dhe padyshim që edhe çdo skuadër tjetër do të mendohet mirë kur të udhëtojnë në drejtim të Peqinit. Po ashtu mendoj se një fitore në këtë takim duhet për të përgëzuar por edhe për t'iu dhënë kënaqësi edhe të gjithë atyre që nuk do të mund të na ndjekin në stadium, por që do të jenë deri në vërshëllimën e fundit duke na ndjekur sipas mundësive. Ekipi ka zhvilluar një fazë përparime të mirë dhe mendoj se ka të gjitha mundësitë dhe potencialin për t'ia arritur qëllimit për fitoren e parë në shtëpi", përfundoi kapiteni Pasha. LULZIM RESULI



Tifozët: Ju mbështesim nga TV

E diela do të jetë një ditë e mbushur plot me takime të rëndësishme, përballje të kampionatit shqiptar por edhe të kampionateve më të rëndësishme të Europës. Por për "Besnikët" e gjithë vëmendja dhe përqendrimi mbetet tek takimi i javës së parë Shkumbini - Teuta. Duke mos patur mundësi për të qenë në stadium në mbështetje të ekipit, të gjithë tifozët kanë menduar të organizohen në lokalet më të afërta pranë stadiumit, por edhe në shtëpitë pranë tij për ta ndjekur takimin. Pjesa më e madhe e tyre do të përqendrohet tek "Restorant Karina", mbështetësi kryesor i ekipit të Shkumbinit. Para nisjes së takimit ata do të kujdesen për vendosjen e banderolave të përparimitura enkas për këtë fillim kampionati. Ndërsa pjesa kryesore e organizimit do të jetë për transfer tën e javës së dytë përballë Tiranës.

Teuta/ Në Peqin me Mancakun e Xhafajn në sulm

Në kampin bregdetar të gjithë besojnë se, nesër ata kanë shumë mundësi për t'u kthyer me tre pikë nga Peqini. Teuta do të nisë kampionatin përballë një skuadre e cila ka synime të ndryshme me të, siç është skuadra Shkumbinit. Pavarësisht nivellit aktual të kundërshtarit, "djemtë e detit" kërkojnë ta vlerësojnë maksimalisht Shkumbinin, për ta nisur me një trepikësh mjaft të vlefshëm. Trajneri Hasan Lika dëshiron nga futbollistët e tij një impenjim maksimal, me qëllim për të mos i lënë kundërshtarit asnjë mundësi për ta rrezikuar, teksa deklaroi se: "Vërtetë nuk luajmë përballë një prej ekipeve që priten si pretendentë për trofe, por në fushën e tij Shkumbini është një skuadër e vështirë për t'u mundur, pavarësisht nga prania ose jo e tifozëve. Duhet të bëjmë kujdes dhe të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë tona për të qenë fitues të kësaj ndeshjeje të parë sezonale", tha trajneri i Teutës, Hasan Lika. Formacioni-Kur kanë mbetur dhe pak orë nga fillimi i ndeshjes me Shkumbinin, në kampin durrsak

formacioni është gjithnjë e më i qartë. Trajneri Lika ka bërë shumë pak lëvizje nga 11-tëshen që hodi në ndeshjen miqësore një javë më parë ndaj Lushnjës. Para portierit Rizvani, pritet të rreshtohen katërshja e mbrojtjes, Jakupi, Sheta, Sakaj dhe Deliallisi. Në mesfushë konkurrenca është mjaft e madhe, por shanset më shumë për të qenë në fushë i kanë Tairi, Velliaj, Nika dhe elbasanasi Hyshmeri, që mendohet se po i afrohet gjithnjë e më shumë kondicionit optimal dhe mundësisë për të qenë në nivelet e sezonit të kaluar. Trajneri Lika do të paraqitet në sulm me dyshen, Mancaku - Xhafaj. Në ndeshjet e fundit miqësore, Teuta ka nisur lojën pikërisht me këtë dyshë e cila ka treguar një formë shumë të mirë. Tekniku Lika, për ndeshjen e parë ndaj Shkumbinit do të lërë në pankinë mesfushorin Dosti. Për teknikun, Xhafaj kuptohet më mirë me Mancakun prandaj lojtari i Shpresave do të qëndrojë në pankinë, duke i dhënë mundësi Mancakut të luajë që nga minuta e parë.

BLEDA KADIU Trajneri Lika do të luajë në sulm me dyshen Xhafaj - Mancaku. Vlonjati kuptohet më mirë me Mancakun, prandaj Dosti do të ulet në stol

Me Seviljen "në xhep", presidenti i Flamur-tarit, Shpëtim Gjika, është duke punuar për miqësoren e dytë, atë që do të ishte qershia mbi tortë për të gjithë sportdashësit vlonjatë, por jo vetëm. Po flasim për skuadrën e "tiki-taka"-s, atë të Vilanovës, Barcelona e frikshme e Lionel Mesit, Ksavit dhe Iniestës, pa harruar këtu edhe yjet e tjerë. Pasi është vendosur zyrtarisht miqësorja me Seviljen, Gjika do të takohet ditën e martë me drejtuesit e Barcelonës, në ambjentet e Hotel "Sheraton", pranë stadiumit "Qemal Stafa",

Pas Seviljes, Gjika takon të martën Barçën

Presidenti, takim me drejtuesit katalanas te hotel "Sheraton". Mundësitë për të luajtur një miqësore të dytë dhe me skuadrën e Vilanovës janë të mëdha

për të vendosur nëse ka mundësi për të luajtur me katalanasit, ose jo. Sipas presidentit Gjika, shanset janë të mëdha që kjo ndeshje e shumëpritur dhe që do të kthente në mendje kujtime të jashtëzakonshme të zhvillohet.

Sevilja—Është konfirmuar zyrtarisht si kundërshtar në miqësoren që do të zh-

villohet gjatë kohës kur Kombëtares do të zbrisin në fushë për turin eliminator të grupeve Brazil 2014, Botërori i ardhshëm. Dhe pikërisht kjo mund të detyrojë Seviljen që të udhëtojë drejt Tiranës, për të luajtur në "Qemal Stafa", me shumë rezerva. Shkak bëhen grumbullimet e Kombëtareve të disa futbol-

listëve që përbëjnë kontigjentin e skuadrës spanjolle. Flasim për spanjollët Hezus Navas, Alvaro Negredo, Diego Lopez, por edhe ndoshta portieri Palop, megjithëse ai që është i sigurt për thirrjen e Del Boskes është vetëm mesfushori Navas. Ndërkaq, të huajt që luajnë me Seviljen dhe që mund të mungojnë janë: kapiteni boshnjak Emir Spahiç, kileni Geri Medel, gjermani Trokovski, kolumbiani Espinoza, senegalezi Diavara, kroati Rakitiç dhe holandezi Maduro. Të gjithë këta mund të mos jenë në "Qemal Stafa".


SAIMIR DEMI



Shaqiri mban Zvicrën në zemër, shpërthen urrejtja në "Facebook"!

Edhe pse duhen edhe thujtë tre javë deri në ndeshjen Zvicër-Shqipëri, që do të luhet më 11 shtator, polemikat dhe tensionet kanë nisur që të dalin në sipërfaqe. Nëse çështja e biletave ishte dhe është një nga më të nxehtat, këtu duhet futur edhe urrejtja për "tradhëtarët" që zgjodhën fanelën e Zvicrës dhe jo atë të Shqipërisë, edhe pse vendlindja e tyre është në Kosovë dhe jo në vendin helven. Ata janë pesë momentalisht (Granit Xhaka, Gjerdan Shaqiri, Valon Behrami, Blerim Xhemaili dhe Admir Mehmedi), por ka mjaftuar gjesti i njërit prej tyre për të nderur polemikat në "Facebook", ku fyerjet s'kanë munguar. Është rasti i yllit të ri të Bajern Mynihut, Shaqirit, që u largua nga Bazeli si

Një foto e mesfushorit të Bajernit ka indinjuar shumë tifozë në rrjetin social, që e thërrasin "tradhëtar" dhe madje përdorin edhe fjalë fyese



18

ndeshje ka luajtur deri tani me Zvicrën Gjerdan Shaqiri, duke shënuar edhe pesë gola. Mesfushori ka luajtur në të gjitha Kombëtares e moshave, që kur ka qenë 15 vjeç.

lider dhe fitues i titullit dhe ka bërë menjëherë për vete tifozët bavarezë dhe kritikët, që e krahasojnë me Mehmet Shollin. Mesfushori i lindur në Gjilan, duke pozuar me fanelën e Kombëtares së Zvicrës, bashkë me shokun e skuadrës, Inler, pasi ka hequr fanelën, ka shfaqur një vizatim të bërë mbi zemrën. Nuk ishte një simbol, por flamuri i kuq me kryq të bardhë i Zvicrës. Një foto që ka ngjallur tërbimin e tifozëve në rrjetin social "Facebook". Aty ka nisur një debat i ashpër mes atyre që e mbronin dhe atyre që e fyenin dhe e akuzonin si tradhëtar. Shaqiri, në faqen e tij zyrtare, shpesh shkruan në shqip dhe është kjo ajo që irriton më shumë shqiptarët. Ndërsa për disa mesfushori s'ka asnjë faj që ka zgjedhur Zvicrën, pasi e ka shkolluar dhe i ka dhënë mundësi të shkëlqejë. Shaqiri, në të shkuarën, është duartrokitur nga shqiptarët, pasi në këpucët e tij të futbollit ka treguar flamurin kosovar dhe atë shqiptar, duke dhënë idenë se ende ndjen për atdheun e tij. Gjithashtu, ai bashkë me Granit Xhakën, janë akuzuar nga mediat helvete se nuk këndojnë himnin.

Axhenda

Shqipëria do të luajë ndeshjen e saj të parë të grupit ndaj Qipros, më datën 7 shtator, në stadiumin "Qemal Stafa", ndërsa të dytën do të luajë katër ditë më pas, më 11 shtator, në Lucernë, në stadiumin "Swissporarena", ndaj Zvicrës

Biletat
Vazhdon të jetë problematike çështja e biletave. Ankesat për mungesën e tyre kanë xhindosur tifozët që jetojnë në Zvicër dhe Gjermani, pasi duan të jenë me çdo kusht, por numri i tyre është i limituar

Kundërshtari Dosa Xhunior, një portugez është pika më e fortë e Qipros!

Nëse shihni në foto formacionin e Qipros, atëherë do të vini re se me helenët luan edhe një futbollist me ngjyrë. Një nga ata për të cilët është diskutuar shumë javët e shkuara, për sa i përket pashaportizimit dhe faktit që vesh fanelën e Kombëtares. Bëhet fjalë për Omar Hasamo Xhunior Dosa Momade. Një emër kilometrik, por që shkurt e thërrasin Xhunior. Luan në qendër të mbrojtjes dhe është titullar i padiskutuar te AEL Limasoli, skuadra e portierit shqiptar, Isli Hidi. Këtë vit, vendimi i Federatës Qipriote të Futbollit

Është diskutuar mjaft federimi i tij për Kombëtaren ishullore, por qëndrimi i tij prej më shumë se shtatë vitësh në tokën helene, bindi Federatën ta merrte

për ta thirrur në Kombëtare befasoi të gjithë, por duket se ata kishin parë mirë dhe zbuluan një futbollist që sot është një nga pikat më të forta të skuadrës. I lindur në Portugali, por resident prej më shumë se shtatë vjetësh në Qipro, duke luajtur me ekuipën qipriote, Xhunior ka bërë të gjithë për vete. I tiji është edhe një nga golat që mban të nderur ëndrrën e AEL-it për të luajtur në fazën e grupeve të Champions. Dosa Xhunior i shënoi Anderlehit me kokë, një nga armët e tij më të forta. Mavraj dhe Cana janë të paralajmëruar.

Ukrainë

Bakaj, sot përballë Dinamo Kievit

Ndërkaq, dje, Vorskla e Dallkut dhe Januzit, që luajtën 90 minuta, barazoi 1-1 ndaj Zarias

Pas humbjes së thellë 1-5, brenda fushës ndaj Shakhtar Donetskut, një tjetër provë e vështirë për skuadrën e Elis Bakajt. Çernomorets Odesa do të luajë në fushën e Dinamo Kievit. Një ndeshje tepër e vështirë për mesfushorin shqiptar dhe shokët e skuadrës. Bakaj do të ketë mundësi të përballet me shqiptarin tjetër të Dinamos, sulmuesin Admir Mehmedi, që luan për kombëtaren e Zvicrës.

Vorskla Poltava ka arritur të barazojë në sfidën e djeshme të luajtur ndaj Zarias, në fushën e këtyre të fundit. Ekipi vendas kaloi i pari në avantazh me anë të Haliuzas, që shënoi me 11-të metërsh, ndërsa në pjesën e dytë Roman Bezus gjeti golin që vendosi 1-1 përfundimtar. Në këtë ndeshje, dy shqiptarët e Vorskles, Armend Dallku dhe Ahmed Januzi luajtën nga fillimi deri në fund. Për sulmuesin duket se kohët e vështira kur qëndronte në stol kanë përfunduar. Vorskla vazhdon të renditet në vend të dhjetë në kampionat, ndërsa Zaria renditej e pesta.

Azerbajxhan

Agolli dhe Teli titullarë, Karabak barazon

Ansi Agolli dhe Admir Teli, dy shqiptarët që luajnë në kampionatin azerbajxhanas, me skuadrën e FK Karabak, nuk kanë mundur t'i japin skuadrës së tyre mbështetjen e duhur për të fituar sfidën e mbrëmshme të luajtur ndaj skuadrës Ravan Baku, në javën e katërt të kampionatit. Ka qenë një ndeshje e luajtur në një portë ajo e djeshmja, me dyshen shqiptare që e nisi nga minuta e parë. Agolli, madje, rrezikoi portën kundërshtare në një moment të ndeshjes.

Botërori U-20

Dy shqiptare luajnë për femrat e Zvicrës

Futbollistet shqiptare, Mirnije e Egzona Selimi po paraqiten me përfaqësuesen e Zvicrës në Botërorin U-20 që po mbahet në Japoni. Zvicra të mërkurën u mposht nga Meksika me rezultatin 2-0, në ndeshjen e dytë të fazës grupore. Përfaqësuesja helvete kishte humbur edhe takimin e parë, nga Zelanda e Re me shifrat 2-1. Ndeshjen e fundit Zvicra e luan të dielën kur përballë do të ketë Japoninë. Kundër Meksikës, Mirnije Selimi ishte startuese dhe luajti deri në minutën e 74-t. Egzona Selimi u aktivizua nga fillimi i pjesës së dytë. Mirnije Selimi është vetëm 15-vjeçare dhe luan për skuadrën Grasshoper. Egzona (18 vjeç) luan për Zyrihun. Të dyja janë mesfushore.

Plas në Zagreb

Fatos Beqiraj grindet me trajnerin Çaçiq!

Sherr te Dinamo Zagrebit. Fatos Beqiraj, shqiptari që luan për klubin kroat dhe për kombëtaren e Malit të Zi, ka kërcënuar largimin, pasi kuptoi se trajneri i tij, Ante Čačić, preferoi një futbollist tjetër në vend të tij, në mesfushë, në sfidën që skuadra pati me Mariborin. Kjo acaroi mesfushorin, i cili kërkoi të largohej, por u ndal nga shokët e ekipit dhe reflektoi, duke kthyer këtë vendim.


44

ndeshje ka zhvilluar Mavraj, me fanelën e Greuther Furthit, skuadër me të cilën luan që prej vitit 2011

2

gola ka shënuar mbrojtësi kuqezi sezonin e shkuar, duke u shpallur në fund të kampionatit si ndër më të mirët e Bundesligës II

MAVRAJ "DAY"



Duhet të jetë e vështirë për një mbrojtës që të përballët me yjet e Bundesligës, por aq e vështirë është gjithashtu kur debuton përballë Bajernit të Mynihut. E megjithatë, Mergim Mavraj, futbollisti kuqezi dhe një nga elementët më të rëndësishëm dhe të fituar të Xhani de Biazit, i cili pasi e provoi në ndeshjen me Katarin në dyshe me Canën, nuk e hoqi më nga fusha, duke e "blinduar". E si të mos jetë ndryshe, kur bëhet fjalë për një mbrojtës që vetëm pak kohë më parë mori shiritin e kapitenit të Grojther Furthi, edhe pse ishte më i ri se disa të tjerë. Por, votimi i fshëhtë bëri që ta fitonte ai balotazhin për të drejtuar skuadrën jashtë dhe brenda fushës. Sot, Mavraj ndihet më i pjekur dhe gati për Riberinë me shokë.

- Mergim, përballë jush Bajerni i frikshëm. Skuadra e Riberisë, Shvainshtajgerit, Manxhukicit, Pizarros e kështu me radhë. Cilin do të mbani të parin?

- (qesh) Do të provoj t'i ndaloj të gjithë njëherësh... Bëj shaka, normale që kam përballë futbollistë të klasit Botëror dhe që nuk kanë nevojë për t'u konfirmuar. Sigurisht, do të përpiqem që të bëj më të mirën time.

Sot, mbrojtësi i Kombëtares, në fushë me Greuther Furthin

"Bundesliga, debutimi, Bajerni dhe... Zvicra, ju tregoj sfidat e mia!"

Përpara tij, Riberi & Co: "Në dhjetë raste, nëntë herë fitojnë ata. Por, nëse shfrytëzojmë atë 1%, atëherë mund të jemi perfektë për një pasdite"

Shaqiri

"Nuk më intereson të flas për faktin që pse zgjodhi Zvicrën dhe jo Shqipërinë. I bashkohem kapitenit Cana kur thotë se është problemi i tyre. Në fushë do të jetë kundërshtar i zakonshëm"

Biletat

"Zvicra dhe FIFA vendosin për sasinë e tyre. Federata Shqiptare dhe tifozët s'mund të bëjnë asgjë për të ndryshuar rregullat. Edhe pse të vjen keq të mendosh se vetëm 800 mund të lejohen"

Shiriti

"Është privilegj për mua që të luaj në Bundesligë dhe të përfaqësoj Greuther Furthin. Sidomos për faktin se jam i vetmi shqiptar i Kombëtares që luaj në këtë kampionat. Do të nderoj fanelën dhe kombin tim"



Mergim Mavraj

- Por, si mund të ndalen këta yje?

- Le të themi që nga dhjetë ndeshje, nëntë herë të shënojnë dhe bëjnë një ndeshje super. Uroj që skuadra ime dhe unë të kalojmë një pasdite të bukur dhe të bëhemi pjesë i atij 1% të shanseve për të qenë perfektë. Nuk duhet të zbresim në fushë të dorëzuar, ndryshe ndeshja jonë përfundon pa filluar ende.

- A e dini se jeni i vetëm shqiptar që do të luani në Bundesligë?

- Jo, jo. Ka edhe të tjerë, nëse shihni mirë.

- Por nuk e kemi fjalën për ata që nuk luajnë për Kombëtaren Shqiptare.

- Atëherë po, jam i vetmi. Është një privilegj i madh për mua dhe shpresoj që të përfaqësoj ngjyrat kuqezi në mënyrën më dinjitoze në Gjermani.

- Meqë prekëm temën e nxehtë të shqiptarëve të tjerë, mund të na thuash diçka për përballjen mes teje dhe Gjerdan Shaqirit, mesfushorit të Bajernit që luan për Zvicrën?

- S'më intereson se më kë luan, por do ta respektoj thjesht si kundërshtar dhe do të mundohem ta ndal në fushë. Po ashtu do të jetë edhe kur Shqipëria do të luajë në Zvicër, më 11 shtator.

- Megjithatë, fakti që ata zgjodhën Zvicrën dhe jo Shqipërinë nuk është një polemikë e vogël. Si mendon, duke qenë se t'i gjithashtu ke pasur probleme të tilla përpara se të merrje pasaportën kuqezi?

- Situatën time e kam shpjeguar më së miri dhe nuk dua të kthehem më te ajo temë. Për sa i përket shqiptarëve të Zvicrës, jam në një mendje me kapitenin Cana kur thotë se s'na intereson dhe se janë punët e tyre. S'më pëlqen të polemizoj në lidhje me këtë temë, pikë!

- Ndërkaq, për tifozët kuqezi do të ketë vetëm 800 bileta në një stadium 17 000 vendësh. Nuk të duket një injorim?

- Dëgjo, na vjen keq, pasi do të doja që stadiumi të ishte i gjithi kuqezi, por UEFA dhe Zvicra e caktojnë buxhetin e biletave dhe Federata Shqiptare nuk mund të bëjë asgjë në lidhje me këtë.

- Ndeshjet me Qipron dhe Zvicrën po afrojnë. Me Moldavinë nuk u duk një Shqipëri brilante nga aspekti fizik dhe teknik. Si mendoni se do t'i nisim eliminatorët e Botërorit 2014?

- Së pari, më duhet të them se te miqësorja nuk u pa Shqipëria e vërtetë. Së dyti, jam i bindur plotësisht se do të jemi gati për ato dy ndeshje. Rëndësi ka që ta nisim mirë dhe një rezultat pozitiv dhe tri pikë ndaj Qipros do të ishin maksimumi. Besoj se brumi është i mirë dhe mund të befasojmë.

- E megjithatë, trajneri De Biazit tha se duhet të kemi besim te kjo Kombëtare që po lind?

- Sigurisht. Ndonjëherë ia vlen të presësh dhe unë them se kur grupi të jetë konsoliduar dhe futbollistët të kenë kapur formën, do të mund të tregojmë vlerat e vërteta.

Intervistoi: ANTON CICANI

TALENTI KUQEZI

Tani është zyrtare: Kabashi te Juventus!

Elvis Kabashi do të luajë sezonin e ardhshëm në kampionatin e të rinjve me Juventusin. Sulmuesi do të ketë mundësi të provohet te skuadra bardhezi, e drejtuar nga Marko Baroni, ish-lojtar i njohur italian

E kishte pritur këtë moment që nga dita e parë kur agentët bardhezi ndoqën disa ndeshje të tij dhe i bënë të ditur Empolit se do të ishte gjatë gjithë kohës në monitorim, por që sot mund të thuhet se ëndrra e Elvis Kabashit bëhet realitet. Në fakt, vetëm dje ka ardhur zyrtarizimi, pasi edhe Liga italiane e futbollit, në adresën e saj, ka bërë të ditur lajmin. Talenti shqiptar, 18-vjeçar i Empolit, do të luajë sezonin e ardhshëm me të rinjtë e Juventusit, pasi bardhezinjtë dhe skuadra toskane kanë arritur këto ditë që të bëjnë disa operacione merkatoje, në të cilat është përfshirë edhe kartoni i të riut shqiptar, që debutoi me kombëtaren U-19 të drejtuar nga Foto Strakosha në sfidën miqësore ndaj Bosnje Hercegovinës, ku futbol-

listi luajti 90 minuta dhe shënoi madje edhe një gol. Kabashi luajti sezonin e shkuar 15 gola, duke realizuar edhe katër gola.

Detajet - Kabashi, që vjet ka qenë një nga më të dalluarit për skuadrën e Empolit, është ndjekur për disa kohë nga agentët e Juventusit, por edhe ata të Parmës, Sienës dhe, madje nga përfaqësues të klubeve të huaja. Në këtë operacion mes Juventusit dhe Empolit, janë bërë disa huazime dhe shkëmbime, si ato të Spinacolës dhe Boniperit Jr, ndërsa në Torino kanë shkuar mbrojtësi Rugani, në formë huazimi me të drejtë blerje dhe Kabashi. Megjithatë, kartoni i sulmuesit, thuhet në Ligën Italiane të Futbollit, nuk është blerë përfundimisht nga bardhezinjtë. A.C

1

gol ka shënuar Kabashi me fanelën e Kombëtares U-19 kuqezi të drejtuar nga Foto Strakosha



Flet Jorlen Lulo, aktualisht pjestar i stafit blu: "Me brazilianët bëra dietë enkas në Maqedoni, jemi skuadra me rendiment më të lartë fizik në të parën"

Dinamo ka edhe mjek-psikolog: Brazilianët 10 kile mbi peshë!

Dinamo edhe pse merr pjesë në Kategorinë e Parë, ka një staf për t'u pasur zili. Duke filluar që nga trajneri Zhupa, ndihmësi i tij Qosja, trajneri i portierëve Gjika, përgatitësi atletik, por edhe mjekun e specializuar Jorlen Lulo, i cili punon edhe në një prej spitaleve private të kryeqytetit. Gjatë fazës përgatitore, mjeku Lulo, ka bërë edhe dietën për lojtarët, madje në një intervistë enkas për "Sport Ekspres", ai tregon se kryesisht lojtarët brazilianë kanë qenë totalisht jashtë forme kur kanë ardhur, madje edhe mbi peshë!



Jorlen Lulo, mjeku i Dinamos

- Fakti që jeni pjesë e stafit të Dinamos, tregon që ke lidhje me futbollin apo është rastësi?

- Faktikisht më bëri ftesë trajneri Eduart Zhupa, nisur edhe nga eksperiencia e madhe që unë kam në profesionin e mjekut. Bëhet fjalë për një skuadër me emër në Shqipëri dhe unë jam tifoz, nuk kisha pse e refuzoja, një eksperiencë më shumë.

- Ka probleme futbollit shqiptar në këtë aspekt?

- Natyrisht që ka shumë

skuadra që nuk kanë mjek fare, madje mjaftohen me një masazhator, por unë nuk mendoj kështu. Sepse mjeku ka tjetër detyrë dhe masazhatori tjetër. Madje ekipet shqiptare duhet që të kenë edhe psikolog, por vë re që këtu nuk bëhet fjalë fare. Te Dinamo po ndërtohet një klub me baza profesioniste.

- Që do të thotë?

- Unë për shembull, kam bërë mjekun, por duke qenë se kam bërë disa specilizime jashtë vendit dhe nga

eksperiencat që kam, jam munduar që të bëj dietë enkas për lojtarët. Kishte disa prej tyre që ishin mbi peshë. Madje, sulmuesi brazilian De Paula dhe Dos Santos e Tiago, mund të kenë qenë afro dhjetë kile më tepër. Tashmë ata kanë rënë afro 7-8 kilogramë. Madje, unë gjatë fazës përgatitore në Maqedoni, kam përgatitur edhe menunë e ushqimit që ka qenë e veçantë. Sepse edhe qumështin në mëngjes, duhet ta pinin pa yndyrë, e jo

më ushqimet në drekë apo darkë.

- Çfarë këshille jepni për ekipet shqiptare dhe drejtuesit e tyre?

- Më mirë një mjek, apo një masazhator e psikolog se sa të blesh një lojtar në treg. Janë shumë të domosdoshëm sepse kërkohet që futbollit të modernizohet. Në qoftë se duam të ecim me hapat e Europës, duhen zbatuar ato që unë thash më sipër.

Intervistoi
ERJON SALIU

Pas dy viteve "stazh" te Flamurtari, Spaho i vë "drynin" portës së Lushnjës

Erjon Spaho do fitore me Besëlidhjen, që do të thotë një rival më pak që në start dhe sa më pak gabime, që mos të ndodhë si një vit më parë

Porta e Lushnjës pësoi ndryshime rrënjësore në periudhën e verës, teksa verdhëjeshilëve iu larguan të tre portierët. Bejte te Besa, Guga te Tërbuni dhe Kaloshi te Bylis. Lushnja riktheu në portë 30-vjeçarin Mikel Spaho, që luajti për dy sezone te Flamurtari, ndërsa portieri i dytë do të jetë 19-vjeçari Elton Harremi, i cili është aktivizuar para dy sezonesh në moshën 17-vjeçare. Spaho, portieri kryesor është shprehur për rëndësinë e pranisë së tij në "Roza Haxhiu".

Spaho tha se është i përgatitur për një sezon të mirë, kur para syve ka një prapavijë të blinduar me emra të njohur. "Kam përfutur shumë me dy vitet te Flamurtari. Kam formën dhe eksperiencën për një ekip që kërkon të rikthehet në Superiore. Këtë sezon besoj se do ta realizojmë. E rëndësishme është që ta nisim mbarë duke mundur Besëlidhjen në shtëpinë tonë", - është shprehur portieri i Lushnjës, që të enjten e ardhshme do të mbushë 30 vjeç.

ALBANALUSHI

3

portierë u larguan nga Lushnja këtë sezon: **Bejte, Kaloshi dhe Guga, dy të parët në Superiore dhe i treti në Kategorinë e Parë**

3

brazilianë ka në përbërje Dinamo: **De Paula, Dos Santos e Tiago**

4

miqësore kanë zhvilluar blutë deri më tani, **2 herë kanë fituar me Karamenin, barazuan me Ohrin dhe dje me Ilirinë**

Tifozët të interesuar, por zhgënjehen nga paraqitja e bluve

Sfidën me Ilirinë e kanë ndjekur edhe afro 50 tifozë, pjesa më e madhe ultras të bluve, të cilët kanë qenë të interesuar të ndjekin ecurinë e skuadrës së tyre të zemrës. Kur kanë parë disa lojtarë të njohur nga Kategoria e Parë ata janë shfaqur optimistë, por në fund kur skuadra ka humbur, kanë pohuar se Dinamo ka ende nevojë për përforsime për t'u rikthyer në Superligë.

Erjon Kule, ofertë nga Apolonia, e kontakton kryebashkiaku Zeqaj

Largimi i nigerianit Alo nga Apolonia, duket se ka lënë bosh një vend në qendër të mbrojtjes. Kryebashkiaku Baftjar Zeqaj, që është edhe president i skuadrës ka kontaktuar Erjon Kule, 24-vjeçar që aktualisht stërvitet me blutë. Kule në të shkuarën është aktivizuar në Kategorinë të Parë dhe Superiore me skuadrën "mëmë". Megjithatë, ai bën pjesë në planet e Zhupës.

Fushë-Kruja në festë, trajneri Sala: Mundëm Dinamon, tashmë s'ndalemi!

Iliria ka mundur Dinamon, me rezultatin e pas-trës 3-0 në miqësoren që është zhvilluar të enjten në "Selman Stërmasi". Skuadra e trajnerit Fatmir Sala, zhvilloi një futboll të bukur, madje spikati sulmuesi Brata, i cili vazhdon të mos ndalet edhe në miqësore. Trajneri Fatmir Sala, në një prononcim për "Sport Ekspres", ka pohuar: "Skuadra tregoi se ka kualitete. Më shumë se rezultati, më bindi loja e skuadrës në prag të kampionatit. Luajtëm ndaj një skuadre me emër si Dinamo, ndaj duhet që të justifikojmë shpenzimet kolosale të Bashkisë dhe sponsorëve në kampionat duke bërë paraqitje dinjitoze".

FILIP GJOKEJA

Syla ofertë Brahos, Tërbuni sot miqësore me Ilirinë

Presidenti i Tërbunit, Petrit Syla, dje ka pasur një takim me një nga lojtarët e dalluar të Kategorisë së Parë, sulmuesin girokastrit, Florian Braho, në kryeqytet. Syla e pëlqen ish-sulmuesin e Luftëtarit dhe i ka bërë ofertën, për ta pasur në skuadër sezonin e ardhshëm, duke qenë se ka pretendime për të kapur një nga dy vendet e para. Dje, palët kanë dëgjuar kërkesat e njëri-tjetrit dhe një përgjigje do të jepet në ditët e ardhshme.

Miqësorja-Sot pasdite pujanët do të zhvillojnë një ndeshje miqësore. Kundërshtar i tyre do të jetë Iliria e Fushë-Krujës. Ka gjasa që kjo të jetë miqësorja e fundit për skuadrën e trajnerit Dalipi, duke qenë se javën e ardhshme fillon kampionati. **GANI PEMA**

TELETEKST KATEGORIA E PARË

NAFTËTARI-Në kampin e skuadrës kuçovare pritet që në kampionatin e ri, tekniku veteran Sofokli Vasili së bashku me ndihmësin e tij Koroveshi, t'i besojnë skuadrën dhe të mbështeten plotësisht në kontributin e futbollistëve "veteranë" vendas. Të tillë janë vëllezërit binjakë Sajmir dhe Ardian Gega, që së bashku me mbrojtësin dhe kapiteinin Kaja, si dhe mbrojtësin tjetër të njohur si Sokol Çela. Këta do të jenë shtylla e kuçovarëve sezonin e ri

Edi Spahiu

HIMARA-Miqësoret që ka zhvilluar skuadra e Himarës, në Bilisht por edhe me Pogradecin, i kanë vlejtur trajnerit Roland Nenaj, për të parë imtësisht se sa gati është skuadra e tij që të përballojë kampionatin. Ndërsa nga ndeshja me Butrintin, Nenaj nuk nxorri asnjë konkluzion, duke qenë se u ndërpre. Himariotët do të bëjnë sërish merkato, madje janë në negociata me lojtarë nga Flamurtari dhe Apolonia.

E. Saliu

MAMURRASI-Mateo Metaj është njëri nga lojtarët kryesorë të Mamurrasit. Edhe në këtë sezon ai ka pranuar të bëhet pjesë e skuadrës së presidentit Ndreca. Në miqësoren ndaj Tërbunit, Metaj ka mundur të shënojë duke kaluar ekipin e tij në avantazh. Ai ka premtuar se në këtë sezon është në një formë më të mirë dhe Mamurrasi do të pretendojë. Skuadra tashmë ka mbyllur dhe merkaton e verës, duke menduar për sfidën e parë me Dinamon

Ahmet Zani

Shuma prej 1.7 milionë eurosh do të shlyhet në këtë mënyrë: Një pjesë e mirë e borxhit që Xhani i ka Demi do të likuidohet brenda vlerës së shitjes, ndërsa pjesa tjetër do të jepet me këste në harkun e disa viteve. Lulzim Sallaku do të jetë presidenti dhe administratori ligjor

Enigma për njeriun që do të blejë 60% të aksioneve të Partizanit që ish-in në pronësi të Albert Xhanit do të marrë fund në ditët në vijim. Gaz Demi, një ndër biznesmenët më të njohur në vend, aksionet e një prej spitaleve më të rëndësishëm në vend, do të jetë njeriu i cili do të blejë pikërisht paketën maxhoritare. Xhani dhe Demi, dy miq të vjetër, janë ulur prej ditësh në bisedime dhe në fund kanë arritur një marrëveshje e cila ende nuk është firmosur zyrtarisht por shumë shpejt ajo do të bëhet publike. Ndërkohë detajet e kësaj marrëve-

shjeje janë zbardhur. Demi dhe Xhani duke qenë se kanë qenë miq të vjetër kanë pasur dhe raporte personale me njëri-tjetrin. Mësohet që Xhani i ka një shumë të konsiderueshme borxh Demi dhe kjo shumë do të futet në vlerën e shitjes së aksioneve. Shuma e mbetur do të jepet në llogari të Xhanit në formë këstesh në harkun e disa viteve. Pra, në këtë moment Demi bëhet zotëruar i aksioneve të Partizanit pa hedhur para për momentin, ndërkohë që Xhani largohet kësajsoj pa marrë asnjë kacidhe në këtë moment.

Zyrtarisht—Shoqëria

Gaz Demi, pronari i ri i Partizanit!



Në foto: Tifozët e Partizanit shprehjnë që ndryshimet në klubin e kuq të kenë ndikim pozitiv

aksionere vendosi dje që presidenti, njeriu i cili do të drejtojë në publik skuadrën dhe njëkohësisht dhe administratori do të jetë Lulzim Sallaku, i cili nuk do të ketë asnjë aksion por është një i zgjedhur nga ana e shoqërisë aksionere. Një akt marrëveshje e bërë në klub është dërguar dje në FSHF dhe ka marrë miratimin e organit të lartë të futbollit. Paro Laçi është aksioneri me 40% të aksioneve por ai nuk do të jetë administrator dhe as president në këtë klub.

E ardhmja—Nuk ka shumë kohë për sezonin e ri dhe drejtuesit e rinj të klubit janë duke menduar për të formatuar skuadrën dhe për të nisur nga puna. Partizani gjendet në Kategorinë e Parë dhe synimi kryesor i klubit është patjetër dalja në një kategori më sipër, atë Superiore.

GJERGJI STEFA

“Largimin tim e kam shpallur më 13 gusht në... “Sport Ekspres”

Albert Xhani dhe Partizani është një raport i cili po jeton ditët e tij të fundit. Një gjë e tillë e rikonfirmon vetë aksioneri kryesor i klubit të kuq, i cili pohon sërish se ndoshta dhe disa orë përpara fillimit të sezonit zhvillimet në kampin e kuq mund të sjellin ndryshime në paketën aksionere.

- A i qëndroni faktit që keni nxjerrë në shitje aksionet?

- Po, e kam deklaruar në 13 gusht në gazetën “Sport Ekspres”, në një intervistë zyrtare. Nuk e kuptova lajmin që kishin botuar dy të përditshmet e tjera sportive dje. Nuk kish asgjë të re. Unë kam qenë i qartë në atë intervistë që kam dhënë. Intervista ka qenë reale. Shes 60% të aksioneve, që do të thotë largohem.

- Aksioneri tjetër i klubit Laçi tha dje se është gati të

blejë aksionet tuaja?

- Po, dhe këtu nuk ka asgjë për t'u habitur. Ligji për shoqëritë aksionere thotë qartë që nëse një aksioner nxjerr aksionet në shitje brenda një afati të caktuar kohor, atëherë aksioneri tjetër ka të drejtën e parablerjes. Nuk e kam mohuar një gjë të tillë, madje në 13 gusht në intervistën e dhënë e kam thënë që në fillim. Por sigurisht kjo blerje duhet bërë brenda një fati kohor të caktuar.

- A është gjithçka brenda afateve?

- Këto janë çështje që i përkasin shoqërisë aksionere.

- Vazhdoni të jeni të bindur se vlera e 60% aksioneve do të jetë 1.7 milionë euro?

- Po aksionet do të shiten në atë vlerë.

- Sot është diskutuar dhe emri i Gazmend Demit në lidhje me ndonjë blerje të

Aksioneri kryesor: Habitem kur lexova në shtyp që unë qënka larguar. E kam bërë këtë gjë që 10 ditë më parë në një deklaratë publike në gazetë. Po punoj për të shitur maxhorancën. Për momentin QKR më njeh mua si administrator, dhe askush nga lojtarët nuk ka firmosur ende. Sallaku aksioner? Jo, asnjë tratativë. Demi? Pyeteni vetë më mirë!



13 vite ka Xhani që është aksioner i Partizanit
60 përqind të aksioneve zotëron për momentin Xhani
2 trofe ka fituar Partizani në kohën e drejtimit të tij, një Kupë dhe një Superkupë
7.8 milionë euro pretendon që ka shpenzuar Xhani gjatë presidencës së tij, ndërkohë që të ardhurat kanë qenë rreth 25% e kësaj shume

mundshme të aksioneve?

- Pyeteni vetë më mirë. Unë nuk mund të them me kë do bëj tratativa. Unë do flas vetëm kur gjërat do të bëhen zyrtare.

- Ndërkohë skuadra ka filluar nga përgatitjet nën drejtimin e aksionerit tjetër, Paro Laçi?

- Nuk jam në dijeni të asaj që ndodh. Unë i kam nxjerrë aksionet e mia në shitje.

Por megjithatë klubi është duke punuar dhe si doqoftë ky është një sinjal pozitiv për Partizanin?

- Për momentin jam i shqetësuar që aksionet e mia të shkojnë në duar të sigurta që Partizanin mund ta ngrenë lart e më lart.

- Partizani, duhet të luajë në fushë dhe gjithsesi deri sa të përfundojnë problemet e brëndshme në klub, një skuadër duhet të jetë ajo jo?

- Po, mendoj që po.

- Kush është për momentin administrator i klubit?

Për momentin me vendim të shoqërisë aksionere është Sallaku.

- Tifozëve u intereson më shumë emri i Partizanit dhe ecuria e tij?

- Edhe mua!

Intervistoi: GJERGJI STEFA



Shoqëria jonë që nga themelimi i saj dhe në vijim ka përm-bushur me sukses dhe brenda kërkesave ligjore, të gjitha kontratat e lidhura me institucionet shtetërore e private, duke marrë vlerësime për shërbimin e ofruar. Kualifikimi i stafit menaxherial & teknik i punonjësve të shërbimit, rritja e kapaciteteve financiare dhe modernizimi i teknologjisë në përdorim, ka bërë të mundur që në të ardhmen, shoqëria të rrisë shkallën e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve, për të gjithë fushën e veprimtarisë së saj.

Rr. “Adem Jashari”, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë
Tel: +355 4 226 7883 info@eurogjici-security.com
Fax: +355 4 224 8470 Cel: 0682022718



Besëlidhja është shkthyer në një "koloni" shkodrane, vitet e fundit. Shkodrani Bruno Kepi është bërë pjesë e lezhjanëve qysh në fillim të sezonit të kaluar, ku ka luajtur të gjitha ndeshjet. Kepi, shquhet për daljet e shpeshta në ndihmë të sulmit nga ku ka kontribuar në shumë aksione shënimi. Golin e fundit e ka shënuar në miqësoren ndaj Vllaznisë ku Besëlidhja barazoi 1-1 në Shkodër. Në një prononcim për "Sport Ekspres", ai shfaqet optimist për Besëlidhjen pavarësisht se janë larguar shumë titullarë. "Në sezonin që po fillon padyshim që do të jemi pretendentët kryesorë për Superiore. Ky besim i imi është i pa lëkundur. Edhe pse janë larguar shumë titullarë, gati gjysma e ekipit, por mungesa e tyre nuk po ndihet. Në të gjitha miqësoret e luajtura deri tani skuadra ka luajtur lojën e vet tradicionale,

Besëlidhja, tashmë "koloni" shkodrane

Mbrojtësi goleador, Bruno Kepi, nuk i trembet rivalëve, përkundrazi skuadra do të kërkojë tri pikët në sfidën e parë

e cila i ka dhënë shumë fitore sezonin e kaluar, pavarësisht se në fund mbetëm në të parën", pohoi fillimisht shtatlarti Kepi.

Përgatitjet-"Grupi nën drejtimin e trajnerit Sokol Meta po konsolidohet nga dita në ditë, si fizikisht, po ashtu dhe teknikisht. Ne, do t'i përballojmë me sukses të gjitha ndeshjet. Tashmë që ka mbetur vetëm një javë nga starti i kampionatit të Kategorisë së Parë po mendojmë seriozisht për sfidën në transfertë me

Lushnjën rivale. Një fitore me lagunarët, do të rrisi moralin në skuadër gjatë gjithë kampionatit. Duke treguar forcën karshi rivalëve do të jemi më afër Superligës", e mbylli prononcimin, Bruno Kepi.

5 shkodranë luajnë aktualisht në radhët e skuadrës lezhjane, duke filluar që nga Kepi, Shytani, Pepa, A. Dibra dhe K. Dibra



Bruno Kepi dhe Albert Kaçi (d)



Shkodrani gjatë një grumbullimi me Besëlidhjen

TELETEKST KATEGORIA E DYTË Rrogzhina në festë, sot miqësore me Partizanin

EGNATIA - Sot në orën 18:00, Partizani, do të jetë mysafirë në Rrogzhinë. Duke mos dashur të luajë në një terren jo të përshtatshëm si në Luz, dy nga drejtuesit e skuadrës së kuqe Paro Laçi dhe Petrit Haxhia, kanë bërë një vizitë në stadiumin e Rrogzhihës dhe kanë mbetur të kënaqur me kushtet, duke parë edhe dëshirën e vendasve për ta organizuar sa më mirë këtë miqësore. Egnatia deri më tani ka fituar 2-1 me skuadrën e Akademisë së Gjilanit, të dytën e kanë humbur 0-3 ndaj Albpetrolit.

Indrit EFICA
LUZI 2008 - Ashtu si ndaj Partizanit edhe dje ndaj Albpetrolit, Luzi, nuk ka shkuar më tepër se barazim 0-0. Asnjë gol në dy ndeshjet e para miqësore. "Nevojiten lojtarë cilësorë në sulm. Natyrisht që kemi luajtur kundër dy ekipeve shumë të forta dhe skuadra jonë është në organizim e sipër. E rëndësishme është që pas këtyre dy testeve e kemi të qartë se ku duhet të ndërhyjmë", - tha presidenti i Luzit, Albert Lusha.

Fatmir Efica
ERZENI - Erzeni ende nuk është grumbulluar dhe mund të jetë skuadra e vetme që nuk ka nisur punën për sezonin e ri. I vetmi që i ka dal për zot skuadrës është trajneri-donator, Fundim Dollaku, i cili për "Sport Ekspres", thotë: "Është e patolerueshme që një skuadër me një eksperiencë të madhe në futboll të katandiset në këtë gjendje për shkak të indiferentizmit të pushteti vendor. Shpresojmë që ata të kujtohen për skuadrën", - ka pohuar Dollaku.

Fiqiri Shehu
SKRAPARI - Skrapari ka një fushë të shkëlqyer, nisur edhe nga përkushtimi i punëtorëve të mirëmbajtjes në qytetin e Çorovodës, që i kanë qëndruar në "kokë". Por, për sezonin e ri ka një skuadër me shumë elementë të rinj, por duhen edhe lojtarë me eksperiencë. Drejtuesit kanë menduar që t'i afrojnë nga Tomori dhe Naftëtari në formë huazimi.

Edi Spahiu
BILISHT SPORT - Ekipi bilishtar zhvilloi takimin e tretë testues, duke luajtur ndaj paratërinjve dhe fitoi me rezultat të thellë 5-1. Trajneri Meraku provoi në këtë takim dy futbollistë korçarë një mbrojtës dhe një mesfushor dhe vlerësoi pozitivisht lojën e tyre duke i bërë pjesë të grupit. Ai është i shqetësuar për mungesën e Zylyftarit dhe Xhogës dhe bilishtarëve që janë studentë në Tiranë të cilët s'kanë vendosur se ku do të luajnë.

Thanas Gjata
VELEÇIKU - Kryebashkiaku dhe presidenti Ramadan Lika, ka pasur një takim me trajnerin Besnik Duli. Burime të sigurta bëjnë me dije se skuadra e Veleçikut javën që vjen do të fillojë stërvitjen. Përzgjedhja e futbollistëve do të bëhet nga trajneri. Kontigjentit të futbollistëve që kanë mbetur nga sezoni i kaluar, do t'i shtohen edhe lojtarë cilësorë nga Akademia "Vllaznia" dhe do të synohet rikthimi në të parën.

Bashkim Ramekaj
SUKTHI - Skuadra sukhiane vazhdon me intensitet fazën përgatitore. Lidhur me këtë fakt, sulmuesi durrsak i Sukthit, Billaca shprehet: "Po vazhdojmë me një ritëm të lartë stërvitjen nën drejtimin e teknikut Ismail Çira. I kemi kushtuar kujdes të veçantë harmonizimit të reparteve, sepse kemi mjaft lojtarë të rinj që po ambientohen mirë me ato me më shumë përvojë. Synimi ynë është ngjitja në të parën", - tha Billaca.

Fiqiri Shehu

Trajneri Abazi bën llogaritë, Pogradeci do një pikë me Ilirinë

Me ardhjen e portierit Festim Miraka edhe për trajnerin Ardian Abazi është plotësuar e gjithë skuadra pogradecare. Me grupin e krijuar prej tij është i kënaqur edhe Abazi, që ka arritur të sjell në skuadër ata lojtarë që i duheshin. Sipas trajnerit Abazi, ekipi ka funksionuar në të gjitha takimet miqësore të luajtura gjatë kësaj faze përgatitore. Por, trajneri pranon se tjetër gjë është kampionati. Takimin e parë për këtë sezon, liqenoret e luajnë në transfertë me Ilirinë, ekip i fort në fushën e vet, por që Pogradecarët do të kërkojnë një pikë.

MARJEL KARADAKU

Kuçi, një kampion në Gramsh: Këtu hyjmë në histori!

Një nga futbollistët më në zë tek skuadra e Gramshit, është mesfushori elbasanas Gerti Kuçi i cili ishte i pari që firmosi. Kuçi ka eksperiencë edhe me Elbasanin, Shkumbinin dhe Bylisin në Superligë, madje me verdheblutë ka dalë edhe kampionë kur ishte fare i ri në moshë. Në një prononcim për "Sport Ekspres", ai ka pohuar: "Pas takimit të parë që pata me presidentin Dritan Bici, rashë dakort të firmosja. Në këtë qytet të vogël por dashamirës në futboll po investohet shumë dhe kanë ardhur kualitete si: Bello, Basriu, Çapja, Lena, Mehmetaj por edhe të tjerët si: Kote, Trash, Çekrezi, Kaloshët, Lezi, Marishta".

Butrinti, "shpartallon" 4-0 Memaliajn, në "nxemjen" para Kamzës

Butrinti, në kuadër të përgatitjeve në prag të startit të sezonit të ri, dje në stadiumin "Andon Lapa", zhvilloi miqësoren e radhës me Memaliajn. Trajneri Bedini hodhi në fushën e lojës 11-shen më të mirë. U duk qartë epërsia e Butrintit ndaj modestëve memaliotë. Sarandiotët fituan me rezultatin e thellë 4-0, ndërkohë që golat u shënuan nga Muço, Dalipaj, Tepelena, Bazaj. Të dyja skuadrat në pjesën e dytë aktivizuan të gjithë lojtarët që patën të gatshëm. Butrinti, tregoi nivel të kënaqshëm loje, duke bindur trajnerin Bedini, drejtuesit dhe tifozët që ndoqën me interes takimin e djeshmë, që shërbeu edhe si një "nxemje" në prag të sfidës së parë me Kamzën.

THOMA NIKA

Pjetrani bën gati golat: Burreli do të jetë në elitë!

Sulmuesi shkodran, Florian Pjetrani është i bindur se Burreli këtë sezon do të jetë në elitën e Kategorisë së Parë. "Ka konkurrencë dhe në skuadër nuk mungon cilësia. Stërvitja ka kohë që ka nisur dhe shoh një angazhim të të gjitha hallkave në klubin matjan. Ndaj edhe ne lojtarët duhet që të japim maksimumin. Sa i përket ndeshjes së javës së parë me Adën, ne do të hyjmë në fushë për të fituar, pavarësisht se ku do të luhet sfida", - tha shkodrani Pjetrani.

HASAN PASHA

Elbasani ka harruar pretendimet, tani afirmon lojtarë

Theodhor Krekasi, një ndër të rinjtë e verdhebluve mbështet idenë për të pasur sa më shumë lojtarë vendas dhe jo "miell hua"

Elbasanit gjatë kësaj vere iu larguan pothuajse gjysma e lojtarëve që ishin pjesë e formacionit bazë të verdhebluve, të cilët u aktivizuan me këtë skuadër sezonin e kaluar. Një gjë e tillë në kampin elbasanas konsiderohet si normale, pasi vera si gjithmonë është periudhë merka-

toje dhe ashtu siç do të largohen lojtarë nga skuadra, natyrisht që do të ketë edhe afrime. Të gjithë të rinjtë që i janë bashkuar Elbasanit shpresojnë se ky vit sportiv do jetë i mbarë për ta. Disa prej tyre besojnë se te verdheblutë ata do të të gjejnë më shumë hapësira në këtë sezon. Mesfushor-sulmues Theodhor Krekasi, në një prononcim për "Sport Ekspres", ka pohuar: "Ky do të jetë sezoni im i dytë tek Elbasani dhe shpresoj që të jetë më i mirë se ai i vitit të kaluar. E them këtë si për aspektin personal, por edhe në atë të skuadrës. Ne duhet që patjetër të arrijmë në Superiore. Kam besim se do ta nisim me fitore ndaj Naftëtarit. Fillimi i mbarë është gjysma e punës", - përfundon Krekasi.

FATMIR POPJA

Moshat, tri qytete për tri Kupa

Në tre fusha sportive të Qarkut të Elbasanit gjatë kësaj fundjave do të zhvillohen ndeshje të grupmoshave 12-17 vjeç, të organizuara nga zyra Rajonale e Federatës Shqiptare të Futbollit. Sipas Artin Kovaçit, shefit të kësaj zyre për Qarkun e Elbasanit ndeshjet do të zhvillohen në qytetet e Elbasanit, Librazhdit dhe në Belshit. Ky është aktiviteti më i rëndësishëm i Zyrës Rajonale të F.SH.F-së për këtë Qark, në prag të fillimit të vitit të ri sportiv 2012-2013. Sipas Kovaçit për grupmoshën U-12 do zhvillohet Kupa "Librazhdi 2012", për grupmoshën U-15 do zhvillohet Kupa "Elbasani 2012" dhe për grupmoshën U-17 do të zhvillohet Kupa "Belshi 2012". Qëllimi është rritja e konkurrencës duke i motivuar talentet.

F.POPJA



Të dielën e kaluar sulmuesi lezhjan Kreshnik Ivanaj dogji shaminë e beqarisë

Fotot: Hasan Pasha

Basketboll/ Kuqezinjtë shpërftyrohen dhe në ndeshjen e tretë kualifikuese EURO 2013

Bravo Dardan! Shqiptari s'pranon të luajë kundër kuqezinjve të Avramit



Mungon presidenti Avni Ponari

Në ndeshjen e djeshme të kuqezinjve ka munguar presidenti i Federatës Shqiptare të Basketbollit, Avni Ponari. Sekretari i përgjithshëm i kosit shqiptar, Korab Llazani, ka shpjeguar se jashtë vendit për arsye shërbimi. Ndoshta dhe kështu, por mundet që paraqitet e do të ta të kuqezinjve të mos e sjellin më në Pallat sporti "Asllan Rusi". Sepse turpi është i madh

Kusurmadhja Federatë dhe tifozët kuqezinjtë me shashka

Federata Shqiptare e Basketbollit duket se qenka e destinuar që pas çdo ndeshje në Tiranë ta ketë nga një fletë-gjobjë. Pas plisave, dje kanë ardhur tifozët Kuqezinjtë e Zi, rreth 20 veta. E kanë nisur me brohoritje e pa filluar ende perioda e dyta kanë hedhur dy shashka, që në Pallatin e Sportit "Asllan Rusi" kanë bërë zhurmë të madhe. Ka ndërhyrë policia, pas së cilës tifozët Kuqezinjtë e Zi nuk janë ndjerë më. Kanë lënë gjithçka dhe e kanë parë ndeshjen si njerëz të thjeshtë. Por për aty dy shashka, pas flakadanëve të Plisave me Zvicrën, sërish do të ketë gjobjë për FSHB-në.

Pa bileta shumica e tifozëve

Edhe pse Federata Shqiptare e Basketbollit kishte nxjerr në shitje bileta për ndeshjen Shqipëri-Poloni, me çmim jo shumë normal për atë që jep kombëtarja e kosit në parket, pra 1000 lekë të reja. Por në fakt, nuk janë shitur më shumë se dhjetë bileta, kurse një shumicë njerëzish kanë hyrë pa bileta. Një humbje për Federatën Shqiptare të Basketbollit.

SHQIPËRI-POLONI 67-105 (19-28, 14-28, 16-14, 18-35)

E premte, 24 gusht 2012, ora 20:30 në Pallatin e Sportit "Asllan Rusi", Tiranë

Shqipëria: Karaj, Ndoja (16), Hysenagolli (13), Shima (14), Bilali (2)/Llazani, Vogli, Aliaj (3), Gjonaj (3), Daliu (2), Ljuca (14) Trajner: R.Avrami

Polonia: Visnievski (7), Gortat (11), Kozarek (10), Injerski (14), Vazinski (7)/Skibnievski (12), Kulig (5), Pamula (5), Karnovski (6), Ponitka (17), Vojshieshovski (7), Zamojski (14) Trajner: A.Pipan

Gjyqtarë: D.Muhviç (Kroaci), A.Manos (Greqi), M.Koljensic (Mali i Zi)

Vëzhgues: M.Hafner (Slloveni)



Si "qenj të rrahur", na nënshtron dhe Polonia vetëm me polakë

Grupi E

Dita e katërt (24 gusht 2012)

Finlandë - Belgjikë	97-60
Shqipëri - Poloni	67-105
Zvicra - pushim	
RENDITJA	N F H Kosh. P
Finlanda	3 3 0 290-216 6
Polonia	4 2 2 321-278 6
Belgjika	3 2 1 222-203 5
Zvicra	3 1 2 191-229 4
Shqipëria	3 0 3 195-293 3

Bravo Dardan! Patriotizmi i kosovarit, që prej vitesh luan me Poloninë, teksa nuk ka pranuar të ndeshet me shqiptarët e Roland Avramit, ka bërë për vetë çdo shqiptar në Pallatin e Sportit "Asllan Rusi" dje në mbrëmje. Në fakt, Berisha që një ditë më parë për "Sport Ekspres" kishte deklaruar se do të luante ndeshjen e tij më të vështirë të karrierës ndaj Shqipërisë. Por e premtia në mbrëmje, pse jo ndjenja e zhvilluar patriotike, si jo çdo shqiptar, e ka bërë që të ulet me trajnerin Alen Pipan. I pari i pankinës kuqezinjtë, ndonëse jo me dëshirë, e ka pranuar dhe mirëkuptuar lojtarin. Dhe Berisha nuk është në dymbëdhjetëshen e Polonisë ndaj Shqipërisë. "Do të ishte një gjë shumë e vështirë që të luaja përballë Shqipërisë. Kam folur me trajnerin dhe më ka mirëkuptuar", thotë Berisha, që në fakt polakët e kanë patur në dyshim për ta sjellë në Tiranë, paçka se Pipan në prag të ndeshjes nuk e ka pranuar këtë variant. Mirëpo sinjeritet dhe mosdëshira për t'u ndeshur me shqiptarët si kundërshtar e Dardan Berishës nuk përfundon këtu. "Unë të njëjtën gjë - thotë Berisha - do ta bëj dhe më 8 shtator. E di që do të jem nën presionin e gazetarëve dhe të tifozëve. Por për mua ka rëndësi që ndjehem mirë për atë që bëra në ndërhyrjet tona. E them dhe një herë, nuk mund të luaja si kundërshtar me Shqipërinë". E është i rrallë si akt, sepse teksa

më 11 shtator në ndeshjen e kombëtareve të futbollit, Zvicër-Shqipëri, do të kemi tre kosovarë kundër (Xhaka, Shaqiri e Mehmeti), kjo e Berishës tregon se shqiptarët e duan Shqipërinë dhe flamurin kuqezinjtë. Na ka ndodh shumë raste që, për një gjë, të bëjmë "gjakun ujë", të ndërrojmë kombësinë dhe identitetin, e të pranojmë të dalim kundër dëshirës dhe kundër flamurit. Mirëpo dje Berisha e dha një sinjal prej së cilës duhet të mësojmë të gjithë, paçka se kusuret e tij në Poloni do të jenë të mëdha. Ndoshta Pipan, edhe përtë treguar që nuk ka më nevojë për polak "gjakprishur", mund dhe të mos e aktivizojë Dardan Berishën, për të cilin kohë më parë askush nuk ishte kujtuar për ta veshur kuqezinjtë. Dhe për këtë i duhet thënë Bravo Dardan Berisha, sepse ishte e vetmia fitore e Shqipërisë së kosit, jashtë anës teknike, si dhe suksesi i të gjithë shqiptarëve bashkuar në një flamur.

Ndeshja-Ajo që kemi bërë dje në mbrëmje ndaj Polonisë ishte vazhdimi i "rekordëve" negative të këtyre ndeshjeve kualifikuese. Pasi jemi mundur me Zvicrën në "Asllan Rusi" me 25 pikë, pasi na ka rrahur Finlanda me 35 pikë në Helsinki, vjen dhe kjo shuplakë e polakëve të Polonisë me jo pak, por 38 pikë. Në fakt, krahasuar me atë që dha Zvicra rreth nëntë ditë më parë, Polonia nuk ishte ndonjë kundërshtar që të merrte përpara. Përkundrazi sikur tanët të

mos kishin pësuar dy "bomba" në fundin e periodës së parë, që e thelluan në 8 pikë diferencë rezultatin, 19-28. Madje perioda e tretë, me aksione të humbura nga polakët dhe fituar nga tanët 16-14, kur dhe shtatlartit Gortat nuk e fuste dot topin në rrjetë, mundet të sillte ndryshimin. Mirëpo të mësuar me "dajak" dhe si gjithnjë si "qenj të rrahur", atëherë Polonia pret dhjetë minutëshin e katërt për të bërë diferencën. Spektakël në veprime, kosha me zhytje, aq sa po thyej koshi dhe në fund, me kokën ulur e të dorëzuar, jemi mundur 67-105 nga Polonia.

GJERGJVYSHKA

Pas ndeshjes

R.Avrami (Trajneri i Shqipërisë) - "E kemi gabim që thoni që Polonia nuk ishte një kundërshtar ububu. Përkundrazi është një skuadër gjigante, e nivelit evropian. Djemtë luajtën më mirë se sa herën e kaluar kur kishim përballë Zvicrën, por jo si në Finlandë. Surpriza do të ishte e vështirë nëse periodën e parë do ta kishim mbyllur 19-22, por ajo që do të ishte do të bënim një lojë më të bukur me Poloninë. Skuadra çaloi në mbrojtje shumë. Edhe pse i bëmë disa herë vërejtje, përsëri nuk u korrigjua. Skuadra shpeshherë u gjend e papërgatitur, ndërsa kundërshtari e pati shumë më të lehtë për të shënuar. Shpresojmë të bëjmë lojëra më të bukura në Belgjikë dhe Zvicër. Ne do të mundohemi e gjithmonë mundohemi. Duhet të dini se gjithnjë mësojmë nga këto ndeshje, aq më shumë që është një grup i sapoformuar. Madje unë shpresoja që të kishim diçka më shumë se sa në Finlandë. Mirëpo skuadra e ka marrë atë tronditjen që nga humbja e parë me Zvicrën dhe është shumë e vështirë".

A.Pipan (trajneri i Polonisë) - "Jam i kënaqur nga prezantimi i lojtarëve të rinj. Kanë patur dëshirë të madhe për t'u ndeshur duke luajtur. Kanë luajtur mirë. Ajo që kemi bërë ishte thjesht detyrë. Erdhëm në Shqipëri për të fituar. Të gjithë lojtarët kanë patur mundësi për t'u provuar. Nuk është ndonjë sekret i madh që Shqipëria është një skuadër e mirë evropiane. Tani duhet ta harrojmë këtë ndeshje për të patur mundësi për të fituar të tjerat".

Jashtë "Asllan Rusit" Gentian Cici, bilbili shqiptar në Serbi

Në ditën e katërt të kualifikueseve të Kampionatit Europian "Slloveni 2013" për meshkuj në parket ka qenë dhe gjyqtari ndërkombëtar, Gentian Cici. Cici ka qenë arbitër i tretë në ndeshjen e grupit A, Serbi-Estoni 88-63 (26-15, 24-13, 20-13, 18-22). Kjo ndeshje që u zhvillua në Novi Sad, në prani të 7250 shikuesve, si arbitër të parë ka patur slloveni Sasa Puhl, kurse të dytë grekun Anastasios Piloidis. Në këtë sezon vere, kjo ishte ndeshja e dymbëdhjetë e Cicit, që bëhet kështu i pari shqiptar që arbitron Serbinë në basketboll për meshkuj.

Lojërat Paraolimpike, të hënën Nishani i dorëzon flamurin Haki Dokut

Shqipëria për herë të parë do të jetë pjesëmarrëse në Lojërat Paraolimpike, të cilat do të zhvillohen në Londër, më 29 gusht-9 shtator. Dhe përfaqësuesi i kuqezinjve do të jetë Haki Doku, në disiplinën e çiklizmit. E për ta nderuar këtë sportist, që prej vitesh stërvitet e përgatitet në

Itali, ndërsa ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet botërore e evropiane, presidenti i Republikës, Bujar Nishani, do t'i dorëzojë flamurin. Kjo ceremoni, sipas njoftimit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, do të zhvillohet ditën e hënën, në ora 11:00, në presidencë. KOKSH në këtë

iniciativë është e mbështetur nga Fondacioni Vodafone Albania dhe Këshilli Britanik. Doku do të konkurrojë në dy gara; më 5 shtator, në ora 14:30, në kronometrin individual dhe më 7 shtator, në ora 16:32, në garën e rrugës. Për Nishanin, si president i Republikës, është hera e parë

në mandatin e tij njëmuorë që dorëzon flamurin kombëtar për delegacionin shqiptar. Për pjesëmarrësit në Lojërat Olimpik "Londër 2012", si asnjëherë tjetër, Romela Begaj ia dorëzoi flamurin ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Aldo Bumçi. Gj.V.



STARTON SERIA A E varfër dhe e bukur

Klubet kanë përjetuar verën më të vështirë të historisë së këtij kampionati

E kotë të fshihemi: sot Seria A starton në shenjë të merkatos më të vështirë të historisë së futbollit italian. Të tjerët e kanë "zbratur" këtë kampionat (Ibra, Tiago Silva, Lavecini...), ndërsa drejtuesit nuk kanë qenë në gjendje të mbajnë as të rinjtë (Verrati, Borini...), por megjithatë presidentët kanë folur për Top Player ndërsa në të vërtetë kanë bërë vetëm ndërrime lojtarësh, kanë marrë borxh dhe futbollistë në fund të kontratës. E kotë të fshihesh, por pavarësisht kësaj këtë kampionat që fillon sot nuk mund ta quash të shëmtuar. Jo domosdoshmërisht disa largime e bëjnë kampionatin të shëmtuar. Përkundrazi. Këtë verë ka ndodhur diçka tjetër. Përtej merkatos në krizë, Italia është shpallur nënkampione e Europës në futboll, duke mundur kombe me kampionate shumë më të pasura (Anglia, Gjermania) dhe duke humbur vetëm kundër përfaqësueses së La Liga-s. Italia ka surprizuar dhe mahnitur jo me individualitetet, por me cilësinë e lojës.

Linjë e kuqe-Kjo është rruga për t'u ndjekur. Ky precedent të çon te besimi në potencialin spektakolar të kampionatit Italian. Ka një linjë të kuqe që lidh shumë pankina të Serisë A. Montela drejton Fiorentinën, por më parë drej-

tonte U-16 të kësaj skuadre, ndërsa Stramaçioni te Interi vjen nga skuadra e të rinjve, Ferra i Samporias nga U-21 e Italisë, Stropa, tekniku i ri i Peskarës ka pas krahëve një të shkuar jo të vonë me të rinjtë. Janë të gjithë trajnerë që janë të etur për të mësuar futboll. Eklipsi i yjeve të futbollit i ka bërë anakronikë ata që drejtonin futbollistit të kalibrit të lartë, alla-Kapelo. Tani që duhet të drejtohen të rinjtë dhe talentet e marrë me kosto të ulët, me shpresën se shumë shpejt do të kthehen në lojtarë të kalibrit të Sancezitet (nga Udineze te Barcelona), nevojiten trajnerë që të kenë rolin e edukatorëve të lojës së futbollit. Nuk është e rastësishme që është kthyer në Serinë A një mjeshtër si Zeman. Dhe nuk është e thënë që këtë herë futbollit Italian do të humbasë. Lamtumira e Ibrës, p.sh do ta detyrojë Alegrin t'i japë një fytyrë tjetër skuadrës së tij, të bazuar mbi të gjitha te kreativiteti, te loja e grupit. Skema, top Ibrës dhe ky i fundit "le të vrasë veten" nuk është më e praktikueshme.

Laboratorë-Pasi ka humbur Lavecini, Maxarri ka kërkuar rrugë të reja për Napolin e tij ambicioz, duke kthyer prapa Hamshikun dhe duke i besuar Pandevit. Fiorentina që



62 milionë euro shiti Milani yjet e tij, Ibrahimoviç dhe Tiago Silva te Paris Sg. Kjo goditje e dyfishtë në aspektin e "shërimit" të arkës së klubit ka qenë në fakt një goditje e rëndë për shpresat e ekipit për titull.

5 yjet që Interi vendosi në merkato në fund të sezonit të kaluar. Forlan, Pacini, Lucio, Hulio Sezar dhe Maikon. Tre të parët janë larguar tashmë, ndonëse klubi nuk qëndroi pas edhe për zëvendësuesit e tyre

ka punuar në mënyrë të zgjuar në merkaton e krizës ka një mesfushë që të josh. Roma ka marrë Destron, por mbi të gjitha është dashuruar me ideologjinë e Zemanit. Ashtu si Interi i Stramaçionit që ka një arsenal ofensiv prepotent por që duhet të disiplinohet. Me pak fjalë, pas Juves që mbetet favoritja nuk është e vështirë të kapet me intuit që po ziejnë ide të reja, që laboratorët e teknikës janë vënë në punë. Nga kjo pikënisje mund të dalin protagonistë dhe surpriza. Kjo paparashikuesmëri luan në favor të kampionatit që nis sot. Do të ketë më pak yje, por me shumë mundësi ndeshje më të mira. Italia e futbollit është më e varfër, por me shumë mundësi më e bukur. Sikurse përfaqësuesja në Euro 2012.

Trajnerët

Zeman-Stramaçioni: gjyshi dhe fëmija në duelin e stolit

Trajneri i Romës është më i vjetri, ndërsa ai i Interit më i ri. Do të ndeshen që në javën e dytë

Gjyshi dhe fëmija, sikurse sugjeron titulli i një kënge të vjetër italiane. Zdenek Zeman është trajneri më i vjetër i Serisë A, Andrea Stramaçioni është më i ri. Bohemi ka lindur në majin e vitit 1947 dhe mund me vetëm tetë muaj Xhiamperio Venturën e Torinos. "Strama", i lindur në janarin e vitit 1976, mund të ishte i biri i Zemanit, djali i këtij të fundit është moshatar me trajnerin e Interit. Kalendari do i vendosë kundër njëritjetrit menjëherë, të dielën më 2 shtator. Një qark i shkurtër gjeneratash dhe emocionesh: Stramaçioni është roman dhe tifoz romanist, ka marrë diplomën në këtë qytet dhe ka drejtuar të rinjtë e ekipit.

Të ndryshëm-Zem-

ani e Stramaçioni kanë përshkruar rrugë të ndryshme. I pari ka mbërritur në Serinë A kur ishte 44 vjeç te Foxhia, pas shumë vitesh në Serinë C e B. I dyti, nga skuadra e të rinjve te piaca e madhe, stoli i Interit, pa pasur eksperiencë të mesme. Nga të rinjtë, në një klub të madh. Gjithçka Brenda një nate. Nuk është një kritikë, por kanë ndryshuar kohët dhe modalitetet e hyrjes në futbollin e madhe. Mbetet efekti i habitës për një trajner "djalosh" që është Strama. Atij do t'i duhet të ndeshet menjëherë me një guro të stolit, Zemanin. Përfaqësojnë ekstremet e kampionatit në temën e moshës, dhe ekstremet siç dihet janë të destinuar të takohen...



Stramaçioni dhe Zeman





Të gjithë pas Juves, ja cilët janë rivalët!

Fundi i kampionatit të fundit të Serisë A është spoti më i mirë i mundshëm për futbollin. Milani i Ibrahimoviçit ishte stërfavoriti, por në fund ka fituar Juve e Antonio Kontes. Surprizë për të gjithë. Kjo do të thotë një gjë: titullin në Itali, duhet ta fitosh me djersë, duhet të fitohet pjesë-pjesë, ndeshje pas ndeshjeje, nëntë muaj dhe në fund mund të mos fitojë skuadra më e mirë, por ajo që ka vazhdueshmërinë më të mirë, më e rregullta, më e ekuilibruara. Lojtarët e kalibrit të lartë duhen, do të ishte një blasfemi të mos e pranosh, por më shumë se asgjë ka rëndësi grupi. Me pak fjalë: cilësi po, por edhe shumë shpirt luftarak. Dhe meqë jemi të shpirti luftarak, Juventusin nisët edhe njëherë tjetër përpara të gjithëve. Duket se ka rigjetur, nën drejtimin e Kontes, atë zgjar agonistik që i përkiste në kohët e Lipit. Janë më të fortët, bardhezinjtë, për këtë askush nuk ka dyshimin më të vogël. E përforcuar në mesfushë me blerjet e Asamoah dhe Islës, përfundimisht ka zgjedhur mbrojtjen me tre, tani Juve ka nevojë vetëm që të bëjë atë hapin e fundit cilësor në sulm. Dhe mbi të gjitha vetë manovra ofensive duhet të



Bardhezinjtë janë përforcuar, por u mungon një sulm. Interi josh me merkaton, Milani ka humbur sharmin e dikurshëm. Në pritje të goditjeve "last minute"

përmirësohet. Shumë shpesh gjatë kampionatit të kaluar, pavarësisht një cilësie loje superior ndaj kundërshtarit, bardhezinjtë nuk kanë arritur t'i "mbyllin ndeshjet". Dhe këtë vit, duke pasur parasysh që do të ketë edhe impenjimin Champions League, duhet të kursehen energjitë duke "vrrarë" rivalët në momentin duke menduar më pas për të kontrolluar lojën në mesin e fushës. Përshtypja është që ky handicap i Juves është shpresa e rivalëve të saj,

pasi Juve nuk duket se ka cilësinë e duhur në sulm.

Rivalët-Konkurrentët për titull janë Interi, Milani, Napoli dhe, nëse kura Zeman do të funksionojë, edhe Roma. Zikaltrit e Stramacionit kanë ndryshuar shumë dhe për të përshtatur një grup të ri nuk është kurrë e lehtë. Megjithatë trajneri ka ide të qarta. Dhe nëse Milito vazhdon të shënojë me lehtësinë e sezoneve të kaluar... Milani, nga ana tjetër njeh një moment të një ndryshimi rrënjësor. Kanë ikur Ibra e Tiago Silva, është menduar për bilancet dhe nuk ka vend për ëndrra... Mungojnë kampionët, mungojnë cilësitë teknike dhe këtë vit mungojnë edhe senatorët që garantonin shpirtin e grupit. Nuk do të jetë një shëtitje dhe alegri këtë e di shumë mirë. Dëmtimi i

Faktorët e titullit?

Konte i dënuar

Juve duhet të kalojë një problem në luftën për t'u konfirmuar kampion i Italisë. Skuadra bardhezi nuk do të ketë me shumë gjasë për të gjithë sezonin, trajnerin Konte. Me Juve që këmbëngul për ta mbajtur në stol, vështirësitë mund të ndihen gjatë kampionatit.

Merkato

Pa dyshim, Juventusin është edhe këtu protagonist. Një skuadre cilësore i janë shtuar futbollistë me peshë. Katër më kryesorët: Lucio, Isla, Asamoah dhe Xhovinko. Interi është përforcuar, po ashtu por ka ndryshuar thuhet gjithë ekipin. Milani është dobësuar ndjeshëm me largimin e senatorëve dhe sidomos të Ibrës dhe Tiago Silvës.

Efekti "Ibra"

Zlatan Ibrahimoviç është një lojtar i prerë për tipin e lojës së Serisë A. Jo më kot, ai ka humbur vetëm një titull në 7 vitet që ka qëndruar në Itali. Ai ishte i vetmi futbollist që mund të bënte të ndryshojë peshorja e pretendentëve. Ai nuk është më në Serinë A. Pa të Milani është automatikisht disa shkallë më poshtë në nivelin e pretendentëve.

Kriza ekonomike!

Ka qenë kryefjala e merkatos së verës. Të gjithë kanë kursyer, duke përjashtuar Juventusin që nuk e ka ndjerë krizën ekonomike italiane për shkak të suksesit të Fiatit jashtë vendit. Milani e Interi skuadrat që e kanë ndjerë më shumë dhe për këtë arsye, janë dy ekipet që kanë humbur më shumë gjatë verës. Në merkato pikësëpari, por edhe në rrogat për lojtarët.



Revolucioni/ Gjyqtarë pas porte edhe në Serinë A

Seria A do të bëjë realitet për herë të parë në një kampionat kombëtar, aplikimin e gjyqtarëve pas porte. E ka bërë dje publike në një konferencë shtypi, kreu i Shoqatës së Arbitrave italiane, Massimo Niki. "Do e nisim me gjyqtarët pas porte, jemi gati për këtë edhe pse askush më parë në botë, në nivel federate nuk e ka bërë diçka të tillë", ka shtuar ai. Deri më sot, gjyqtarët pas portave janë eksperimentuar vetëm në evenimentet e mëdha të organizuara nga UEFA dhe FIFA. Kjo e fundit ka futur në lojë edhe opsionin teknologji. Gjyqtarët pas portave do të tentojnë të ulin polemikat për atë që ka ndodhur shpesh në futbollin Italian, ku gjyqtarët janë kryqëzuar për vendimet e tyre.

ri i Patos shqetëson. Ndonjë kros për kokën e Pacinit mund të japë pak qetësi. Por sektori që shqetëson më tepër është mbrojtja. Largimet e Nestës dhe Tiagos kanë lënë jetim një repart të tërë. Dhe në Itali titujt fitohen duke pësuar më pak gola se kundërshtarët, dhe duke shënuar një më tepër se ata...

"Mushkonja"-Napoli është gati të bëjë mushkonjën, që do të thotë të shqetësojë grupin e favoritëve. Largimi i Lavecit është kompensuar me kalimin si titullar të Pandevit, edhe pse mbrapa mungon një element i nivelit të lartë. Entuziasmi i publikut dhe mungesa e Champions League-s mund të ndihmojnë skuadrën e Maxarrit të përqendrohet në kampionat. Diskutim tjetër për Romën. Këtu dyshimet janë për

Zemanin. Do t'ia dalë trajneri bohem të tregojë në kryeqytetin Italian, lojën e bukur që ka zhvilluar në provincat italiane si Foxhia e Peskara?

Surpriza-Udineze meriton këtë titull, për atë që ka bërë vitet e shkuara. Shumë kampionë të rinj kanë lënë skuadrën e Guidolinin, por friulanët dinë përherë të mahnisin. Një shkallë më poshtë, Fiorentina e Lazio, Palermo e Parma. Mes këtyre ekipeve do të dalë surpriza e përvitshme e kampionatit Italian. 10 të tjerat, do të luftojnë në zonën e mesit. Aty, një fitore do të thotë të notosh në ujëra të qeta, një humbje të keshmakthin e rënies. Mbijetesa, si përherë sezonet e fundit mendohet të jetë rreth 40 pikëve. Ai që do të mbërrijë më parë do të ketë mundësi të dëfretet...



“Juve në avantazh, por Milani e Interi kanë entuziazëm”

ANALIZA E LIPIT

Një nga trajnerët që kanë fituar më shumë dy dekadat e fundit në futbollin Italian, njëkohësisht një hero kombëtar në Itali pasi fitoi Botërorin në vitin 2006. aktualisht, në stolin e një klubi kinez, Marçelo Lipi ka pranuar të analizojë për La Gazzetta Dello Sport, nisjen e sezonit të ri në Itali.

Lipi, të gjithë kundër Joves?

- Është normale që të jetë kështu. Vjen pas një sezoni fitues, ka forcuar vetëbesimin, ka bërë blerje të goditura dhe ndoshta do të ketë edhe më shumë se kaq. E shoh të vështirë të ketë një skuadër më të fortë se ajo, edhe pse Napoli, Milani i rinovuar dhe Interi do të jenë aty”.

- Sa do të mungojë Konte?

- Pa trajnerin në stol, natyrisht nuk është e njëjta gjë. Por Antonio ka gjetur te Karrera një person të besueshëm që e njuh mirë. Zgjidhje e shkëlqyer për të limituar dëmet. Nëse humbet, Juve nuk do e ketë fajin te skualifikimi i trajnerit.

- I duhet vërtet një sulmues?

- Nëse ata që janë aty prej një viti mendojnë se është e nevojshme, kush janë unë që e mendoj ndryshe? Edhe pse unë mendoj që të sakrifikosh Matrin nuk është normale.

- Jorente, Xheko, Asamoah, Xhovinko: çfarë ju vjen në mendje?

- Dy sulmuesit janë të fortë fizikisht dhe nga ana mentale: boshnjaku është i rrezikshëm në zonë, spanjollit lëviz më shumë. Asamoah nuk do e ketë të vështirë të luajë në krah; ka dinamizëm dhe vrapin. Xhovinko, në fund: gjenialiteti është Ok kudo...

- Milani: si i bëhet pa Ibrën, Tiago Silvën, Nestën, Akuilinin dhe Van Bomelin?

- Bëhet edhe pa ta. Nëse vijnë oferta që nuk mund të refuzohen si ajo e Psg-së, më pas duhet ndryshosh duke rinovuar ekipin. Ajo që sot duket negative nesër do të jetë pozitive. Edhe për të gjetur entuziazëm. E kuptoj tifozerinë, por duhet të ketë besim te drejtuesit si Galiani që prej vitesh e mban Milanin në nivele të larta.

- Ibra një kampion apo një i mbivlerësuar?

- Kampion. Një që ka fituar nëntë tituj nga 10 kampionatet e fundit që ka luajtur, të mos bëjmë shaka. Nuk ka të njëjtin impakt në nivel ndërkombëtar, por mbetet kampion.

- Montolivo mund të bëjë Pirlon te Milani?

- Mund të jetë roli i tij natyral; regjizor para mbrojtjes. Nuk është një fantasist; e ka bërë këtë rol në kombëtare.

- Kush ka fituar në shkëmbimin Paçini-Kasano?

- Të dyja. Siç duket janë lojtarë të kërkuar nga dy tra-

Ish-trajneri kampion bote me axurrët: “Bardhezinjtë janë përforcuar ndjeshëm, milanezët kanë rinovuar ekipet e tyre dhe mund të shpërthejnë. Konte? Dënimi do të ndihet, por jo aq sa për të humbur kampionatin”

Vlerësimet e Lipit

Juve

“Pa trajnerin në stol, natyrisht nuk është e njëjta gjë. Por Antonio ka gjetur te Karrera një person të besueshëm që e njuh mirë. Nëse humbet, Juve nuk do e ketë fajin te skualifikimi i trajnerit”.

Milan

“Nëse vijnë oferta që nuk mund të refuzohen si ajo e Psg-së, më pas duhet ndryshosh duke rinovuar ekipin. Ajo që sot duket negative nesër do të jetë pozitive. Edhe për të gjetur entuziazëm. E kuptoj tifozerinë, por duhet të ketë besim te drejtuesit”.

Inter

“Palasio e Milito janë dy sulmues të mëdhenj, që lëvizin shumë dhe që kuptohen lehtë nga shokët e ekipit. Interi do të jetë i një profili shumë të lartë”



Marçelo Lipi

nerët.

- Interi më në fund ka lënë pas një cikël fitues dhe hijen e Murinjos?

- Ajo e mirënjohjes së tepruar për lojtarët apo një trajner është diçka e gabuar. Më ka ndodhur edhe mua pas botërorit të fituar dhe tani edhe Prandelit pas finales së Euro 2012. Nuk është e lehtë megjithatë të heqësh dorë nga lojtarë që kanë fituar dhe kanë dhënë shumë. Tani, megjithatë, ajo epokë është mbyllur dhe mua më duket se Stramacioni transmeton entuziazëm dhe besim.

- Palasio-Milito përpara, Guarino-Mudingai në mes, plus ardhjet e Kasanos, Garganos dhe Pereirës. Çfarë Interi duhet të presim?

- Interi na ka mësuar me goditjet e minutës së fundit:

Snajder erdhi në këtë mënyrë. Dy uruguajanët, edhe nëse nuk mund të konsiderohen Top Player, janë lojtarë të një rendimenti shumë të lartë, të nevojshëm në çdo skuadër. Palasio e Milito janë dy sulmues të mëdhenj, që lëvizin shumë dhe që kuptohen lehtë nga shokët e ekipit. Interi do të jetë i një profili shumë të lartë.

- Napoli: ka ikur Lavec, mjafton që t'i ndryshosh rolin Hamshikut siç ka bërë Maxarri për të mbetur në të njëjtin nivel?

- Mendoj që Napoli ka një mesfushë të nivelit shumë të lartë me Hamshik si gjysmëallë si Markizio dhe Inlerin në rolin e plejmejkërit. Ka një mbrojtje me mekanizma të konsoliduar dhe një portier të besueshëm.

- Dhe talentin Insinje....

- Një si ai di të entuziasmojë. Mbi të gjitha në një qytet si Napoli, që është mësuar me lojtarë të tillë

- Roma është një pikëpyetje e madhe...

- Të presim, e të shohim. Në ambient ka një entuziazëm të madh dhe një ndjesi ekuilibri pavarësisht tre sulmuesve, mes të cilëve i talentuar Destro. Pres që të mos e shesin De Rosin që është i shkëlqyer.

- Mund të jenë në zonat e larta të renditjes, Udineze dhe Fiorentina?

- Udineze është e pabesueshme; çdo vit shesin dy tre më të mirë dhe mbeten në majë. Projekti Montela te Fiorentina dhe mesfusha e tij me cilësi teknike më pëlqen.

- Nga Italia është larguar edhe një talent si Verrati. Si ka mundësi?

- Nuk besoj që klubet italiane nuk kanë menduar për të. Por nuk ka asnjë shans për to që të përballen me PSG-në që paguan shifra të çmendura”.

- Kinë, Katar, Emirate, Angli, Spanjë, PSG: Italia po zbret në vazon e dytë për nga rëndësia në futboll, siç profetizonte Galiani?

- Fatmirësisht është në mes fair play financiar: më duket se ndokush për momentin nuk ka ndërmend ta respektojë. Shpenzimet megjithatë nuk janë sinonim i suksesit. Sa kohë i është dashur Çelsit për të fituar një Champions?

- Po, por të humbasësh në dy vjet lojtarë si Sanchez, Pastore, Eto'o, Ibra, Silva, Lavec është një dobësim i dukshëm.

- Nuk ke çfarë të bësh; paguhen më tepër. Por futbollit ofron mundësi. Të mendojmë për të rinjtë që po rriten dhe rilindjes që pritet. Dy vjet më parë Under 21 merre lojtarë në Serinë B dhe C, sot ka titullarë në A.

- Moda e re duket 3-5-2: gjysma e kampionatit luan kështu. Vetëm një modë?

- Shumë joshen nga ky modul, edhe unë e kam bërë. Në mbrojtjen me katër, nëse nuk ka kompaktësi, nëse nuk respektohen distancat, nëse lojtarët e krahut nisen por nuk kthehen, rrezikohet shumë. Në Kinë, p.sh luajnë të gjithë 4-2-3-1 edhe pse dy mesfushorët qendrorë vuajnë shumë sepse ata që janë përpara tyre qëndrojnë shumë larg. Unë po kërkoj agresivitet në pressing dhe lëvizje pa top. Nuk është e lehtë edhe për shkak të nxehtësisë dhe lagështisë.

- Shumë mbrojtës qendre, shumë sulmues por në Itali po vuhet në mbrojtje. Mbi të gjitha nga krahët...

- Është Abate, Maxhio, por është e vërtetë që momenti është negative. Edhe mbrojtësit e qendrës janë më pak se dikur. Çështje cikli.

- Një surprizë për 2012-13?

- Mund të jetë Palermo. Mua më pëlqen Sanino: jep ekuilibër, konkretizim, organizim të mirë loje dhe agresivitet për skuadrat e tij. Mund të jetë viti i duhur për të gjetur atë vazhdimësi që skuadrës i ka munguar shpesh. Xhenoa, është një tjetër kandidat.

- Një i ri që mund të shpërthejë?

- Marrone është shumë interesant, do të varet nga minutat që do të ketë në dispozicion. Sigurisht që Destro mund të bëjë hapin përfundimtar: ka të dhënë të shkëlqyer dhe luan në një skuadër që privilegjon sulmin.

- Kampionati do të nisë pa Del Pieron...

- E di që do donte të luante sërish. Por mua nuk do të vinte keq nëse do e mbyllte te Juve; do të ishte shumë romantike...



Juventus - Parma (sot, ora 20:45)

Zëvendësi i Kontes: Juventusit fiton edhe me mua në stol

Karrera flet përpara debutimit në Serinë A: "Nuk e kisha menduar kurrë se do të arrijë deri këtu. Ne favoritë? Jo, ka edhe skuadra të tjera"

Pas debutimit në Superkupën e Italisë në Pekin, Masimo Karrera do të bëjë debutimin e tij në Serinë A, kundër Parmës. "Sigurisht që emocionet ekzistojnë, por vetëm në vërshëllimën e parë, më pas do të hyjë në klimën e ndeshjes. Nuk e kisha menduar kurrë se do të debutoja në Serinë A duke drejtuar Juven. Objektivi i çdo trajneri është që të arrijë në nivele të larta, siç jam këtu tek Juventusit. Por unë jam thjesht një bashkëpunor i Kontes dhe jam i vetëdijshëm për këtë".

Pa Konten - "Antonio arrin ta karikojë skuadrën gjatë stërvitjes dhe ndeshjes. Gjatë ndeshjeve, edhe pse lojtarët e dinë se çfarë duhet të bëjnë, këshillat janë gjithmonë të nevojshme. Është e vështirë të zëvendësosh Konten, sepse ka treguar se është një trajner i madh, por unë do të mundohem të bëj më të mirën time".

Maxarri - "Çfarë përsh-typpesh më bënë fjalët e tij? I uroj Maxarrit që të fitojë si trajner ato që unë i kam fituar si futbollist. Nuk dua të flas më shumë, sepse dua që t'ia lë fushës".

Favoritë - "Jemi favoritë ashtu siç janë shumë skuadra të tjera. Ne do të mundohemi që të konfirmohemi në fushën e lojës. Nuk jemi favoritët e vetëm, sepse ka edhe skuadra të tjera që mund të fitojnë titullin. Kemi një grup shumë të mirë dhe do të mundohemi të bëjmë më të mirën tonë".

Parma-Karrera foli edhe për kundërshtarit e parë: "Do të jetë një ndeshje shumë e rëndësishme kundër një kundërshtari shumë të fortë. Do të na duhet të djersijmë shumë për të marrë tri pikët. Shpresojmë që ta nisim si sezonin e kaluar, kur fituam bindshëm ndaj Parmës".

10

muaj do të qëndrojë Masimo Karrera nën drejtimin e Juventusit, për shkak të pezullimit të Antonio Kontes nga Gjykata Sportive, për moskallzim të trukimit të ndeshjeve kur drejtonte stolin e Sienës



Konte (m) dhe zëvendësi i tij Karrera

Dilema, Matri apo Xhovinko titullar?

Sot Juventusit do të luajë ndeshjen e parë të kampionatit kundër Parmës dhe dyshimi më i madh për trajnerin Karrera mbetet reparti i sulmit. Alesandro Matri apo Sebastian Xhovinko? Lufta ka nisur, ndërsa vendimi do të merret disa orë përpara ndeshjes. Për momentin Matri duket më i favorizuar për të luajtur që nga minuta e parë, kjo edhe për shkak të paraqitjes që ka bërë deri më tani, duke shënuar pothuajse në çdo ndeshje. Ndërkohë, Xhovinko është i vetmi sulmues i Juves që nuk ka mundur të shënojë deri më tani në miqësore dhe në Superkupë ndaj Napolit.

Seria A/ Java I

Sot	Kievo-Bolonja	20:45
Fiorentina-Udineze	Xhenoa-Kaljari	20:45
Juventus-Parma	Palermo-Napoli	20:45
Të dielën	Peskara-Inter	20:45
Milan-Sampdoria	Roma-Katania	20:45
Atalanta-Lacio	Siena-Torino	20:45

Merkato bardhezi

"Top-Player", për Juven mbetet vetëm Jorente

Sulmuesi i Bilbaos është i preferuari. Dy palët kanë arritur një marrëveshje, por pritet vetëm OK i drejtuesve të Bilbaos

Kohë pritjeje për Juventusin përpara se të kompletjë skuadrën në prag të fillimit të Champions League, kompeticion i cili po mban gjallë edhe merkaton e klubit bardhezi, që ka qenë i aftë që në këtë merkato të bëjë goditje si Asamoah, Isla, Xhovinko e Lusio. Lojtarët të rëndësishëm dhe cilësorë, në pritje të goditjes së madhe për të blerë sulmuesin me peshë. Një merkato që ka muaj që zgjat dhe që është shndërruar në një telefonelë. Nga përgjigjet negative të Van Persit e Luis Suarezit, e deri te Edin Xheko. Dhe mbetet shumë i vështirë për t'u realizuar edhe arritja e një marrëveshjeje për Fernando Jorenten, me të cilin Juventusit ka arritur një akord 3-vjeçar, me 3,5 milionë euro në sezon, por pritet OK i Bilbaos. Me 195 centimetrat e tij, Jorente përfaqëson një "dem të çmendur" që do të vihej nën urdhrat e Antonio Kontes, "sponsor" i tij i vërtetë. Megjithatë, gjithçka mbetet e vështirë për t'u realizuar, pavarësisht 18 milionë eurove të ofruara nga "Zonja e Vjetër", që kërkesë të frikshme nga klubit bask, i cili kërkon thuajse dyfishin. Juvja nuk fal asnjë centimetër dhe duket se në anën e saj ka dëshirën e futbollistit. Marcelo Bielsa nuk e grumbulloi sulmuesin bask as për sfidën e Europa League ndaj Helsinkit, që do të thotë se largimi është shumë më pranë. Mbeten "gjallë" pistat e Jovetiç dhe

sidomos Edin Xheko, për të cilin trajneri i Sinit, Mançini, tha se do të largohet vetëm në rast se vjen një tjetër sulmues.

Alternativat - Në një skenar të tillë, operacioni "last minute" mbetet për momentin më i mundshmi. Në listën e Juves është gjithmonë Marko Borielo, i cili shpreson të një rikthim në Torino. Dëshira e Romës është që ta lërë të lirë. Orët e fundit është folur edhe për kandidaturën e Dimitar Berbatov, 31 vjeç, shumë pranë lamtumirës nga Mançester Junajtid. Bullgari, protagonist prej vitesh në "Old Trafford", mund të vendosë që të ndryshojë ambient.



Pereira zbarkon në Milano: Interi, një ëndërr e realizuar!

"Më duket e pabesueshme. Mund të luaj që tani. Së bashku do të fitojmë shumë tituj"

Alvaro Pereira zbarkoi në Milano duke iu bashkuar grupit zikaltër. Ish-mbrojtësi i Portos që u ble nga Inter për 10 milionë euro plus bonuset u prit nga një numër i madh tifozësh dhe gazetarësh në aeroportin e Malpensas, të cilëve u shprehu menjëherë euforinë për ditën e tij të parë të aventurës zikaltër: "Është e pabesueshme të jem këtu", komentoi Pereira. "Jam shumë i lumtur që më në fund jam i Interit. Është një ëndërr të luaj këtu, pasi nuk e keni idenë se çfarë do të thotë jashtë Italisë, e sidomos në Amerikën e Jugut të luash për Interin. Mund të fitojmë shumë tituj".

Pas konkretizimit të akordit 4-



10

milionë euro plus bonuset shpenzoi Interi për ta blerë Alvaro Pereirën nga skuadra e Portos. Mbrojtësi ka firmosur deri më 2016-n

vjeçar të Pereirës, Interi mendon dhe për largimet. Hulo Sezar është i destinuar për QPR-në pas udhëtimit në Londër, ndërsa e ardhmja e Maikon është mes Mançester Sinit dhe Çelsit. Blutë faktikisht morën nga Marseja dhe anësorin spanjoll Sezar Azpiliketa që u ble për 8 milionë euro plus bonuset nga blutë e Londrës.

Debutimi - Menjëherë sapo ka arritur në aeroportin e Malpensas, Pereira ka udhëtuar për në qendrën stërvitore të Interit. Pasi ka kryer me sukses vizitat mjekësore, mbrojtësi uruguajan ka firmosur kontratën e tij deri në vitin 2016.

Gargano - Ndërkohë, është prezantuar edhe mesfushori tjetër uruguajan, Gargano, i huazuar nga Napoli për 1,25 milionë euro. Lojtari do të mbajë veshur fanelën me numër 21 dhe pritet që të luajë që në ndeshjen e parë të kampionatit ndaj Peskarës në transfertë.

Inter, "bomba" e vërtetë është Paulinjo

Inter ka qenë aktiv në këto ditë të fundit të merkatos, por, "bomba" e vërtetë është braziliani Paulinjo. Ylli i Korinthiansit, i ndjekur për më shumë se një muaj së bashku me brazilianin tjetër të San Paolos, Lukas, ka tashmë akordin me Interin, zyrtarizimi i të cilit do të bëhet në janar, kur Paulinjo do t'u bashkohet zikaltërve. Për të, drejtori teknik Marko Branka i ka premtuar Korinthiansit 10 milionë

euro. Talentido të vazhdojë të qëndrojë në Brazil, për faktin se skuadra e tij do të luajë në Botërorin për Klube, por menjëherë pas kësaj do t'i bashkohet zikaltërve në "Apiano Gentile". Vetë Paulinjo e ka konfirmuar akordin me Interin: "Interi është një klub i madh dhe unë e kam ëndërr të luaj në Europë, por me ta do të bashkohem pasi të mbyll Botërorin për Klube me Korinthiansin".

Zaneti krenar për paraqitjen e 800-të

Legjenda e Interit, Javier Zaneti, e ka festuar paraqitjen e tij të 800-të në fitoren ndaj Vasluit në sfidën e zhvilluar në kuadër të Europa League mbrëmjen e kaluar. "Unë ndihem mirë dhe shumë krenar që kam arritur një rekord aq të rëndësishëm në një klub aq prestigjioz si Interi, aq

më shumë si kapiten. Gjëja më e rëndësishme është që të ndjej se po i ndihmoj ekipit. Ne kemi marrë rezultat të mirë ndaj Vasluit, por ende nuk jemi tutje. Vaslui është ekip i madh dhe ata po shkojnë përpara mirë, kështu që duhet të jemi të kujdesshëm", është shprehur kapiteni.

Krizë në shtëpinë kuqezi, Allegri gati të japë dorëheqjen

Shtypi italian zbulon se ka një krisje mes trajnerit të Milanit dhe Galianit. Merkato e dobët dhe rikthimi i Kakasë janë arsytet e forta

Ndoshta mund të jetë i nxehti sub-tropikal, por në shtëpinë e Milanit gjërat nuk po ecin ashtu si duhet. Ambienti është më shumë se sa i ftohtë. Gjithçka lidhet me marrëdhëniet e trajnerit Allegri me drejtuesit e klubit. Gjithçka lidhet me merkaton, kërkesat e paralelizuar dhe sidomos me rikthimin e Rikardo Kakasë, diçka që trajneri aktual i Milanit nuk e ka dashur kurrë.

Sfida Galiani-Allegri - Prej kohësh flitet për një raport jo shumë të mirë mes trajnerit të Milanit dhe administratorit të deleguar.

45

vjeç është trajneri i Milanit, Allegri, i cili do të nisë sezonin e tij të tretë në stolin kuqezi. Në sezonin e tij të parë fitoi titullin kampion, duke shpërblyer besimin e drejtuesve të klubit



Acarimi dhe mërzi i Galianit pas humbjes 5-1 në miqësoren me Realin në Nju Jork ishte e dukshme. Drejtuesi i klubit kuqezi kritikoi haptazi skuadrën e tij dhe sidomos trajnerin Allegri. Padyshim që ky i fundit nuk i ka pritur aspak mirë këto kritika. Në këtë mënyrë, Allegri i ka kuajtuar Galianit shitjen e yjeve si Zlatan Ibrahimoviç dhe Tiago Silvës. Dy vendime shumë të rëndësishme dhe që e kanë dobësuar dukshëm Milanin dhe sidomos i kanë dhënë të drejtë trajnerit Allegri që të "hap gojën" për gjithçka. Si të mos mjaftonte kjo, duket se në Milanelo ambienti nuk është më i njëjtë dhe sipas shtypit italian, Allegri është gati të kërkojë dorëheqjen.

Merkato e dobët - Blerjet që ka bërë Milani deri më tani nuk bëjnë optimist as tifozin më të zjartë. Ardhja e Paçini dhe largimi i Kasanos ka lënë një tjetër "shije të hidhur" tek tifozët kuqezi, të cilët kanë parë se si më pak se një muaj u kanë dhënë lamtumirën tre idhujve të tyre. Dhe si të mos mjaftonte një merkato zhgënjyese, vjen edhe një tjetër lajm i keq, që acaron

pa masë trajnerin Allegri, duke e bërë atë që të mendojë largimin. Është fjala për Aleksandre Paton, i cili ka pësuar një tjetër dëmtim muskular, që do ta lërë për reth tre javë larg fushave të lojës. "Kupa është mbushur" dhe duket se edhe Allegri po i sosit durimi. Skuadër e përgjysmuar, një Milan pa lider dhe kërkesa që nuk plotësohen. Marrëdhëniet janë prishur dhe asgjë nuk është më si më parë.

Çështja "Kaka" - Një ndër arsytet e prishjes së marrëdhënieve mes Allegri dhe Galianit është padyshim edhe Rikardo Kaka. Drejtuesit kuqezi duan me çdo kusht që të rikthejnë brazilianin në "San Siro", për të justifikuar në një fare mënyre merkaton e dështuar. Por, dëshira e Galianit për të rikthyer Kakanë ka hasur me përgjigjen negative të Allegri, i cili nuk ka nevojë për një lojtar me karakteristikat e brazilianit, por i duhet një mesfushor shkatërrues. Largimet e Van Bomelit, Akuilanit e Gatuzos e kanë lënë të vetëm Ambrozinin, i cili me moshën që ka nuk mund të përballojë dot një sezon kaq të gjatë.

Milani ka ende 6 ditë kohë për të rikthyer në "San Siro" Rikardo Kakanë. "Ka disa dashuri që nuk përfundojnë kurrë", ka thënë Adriano Galiani disa kohë më parë. Dhe administratori i deleguar i Milanit ka shumë të drejtë, sepse braziliani i ka të gjitha shanset për të riveshur fanelën kuqezi.

Kontakti i parë - Ndërmjetësi i merkatos Itali-Spanjë, Ernesto Bronxeti, ka udhëtuar për në vendin iberik për t'u takuar me presidentin Florentino Perez dhe për t'i bërë të ditur ofertën e Milanit, që e kërkon Kakanë në formë huazimi. Në këtë mënyrë, sulmi i kuqezinjve për Kakanë ka nisur në mënyrë zyrtare.

Ftesa - Milano-Madrid-Barcelona, gjithçka është "e nxehtë". Ndërkohë, Galianit i ka ardhur ftesa për të qenë në "Bernabeu" të mërkurën për të ndjekur finalen e kthimit të Superkupës së Spanjës. Nuk dihet nëse Galiani do të shkojë në Madrid apo jo, por po punohet fortë në një drejtim: për të rikthyer Kakanë në Milano.

Niang, shumë pranë - Në një kohë kur nuk po vijnë lajme të rëndësishme nga Madridi, Milan në këto momente duket shumë pranë sulmuesit francez M'Baje Niang. Klubi kuqezi ishte në pritje të vendimit të Kaen pas ofer-

Rikthimi i Kakasë, Milani përgatit "sulmin" final

Ndërkohë, kuqezinjët janë shumë pranë 17-vjeçarit Niang të Kaen dhe interesohen për Denilson të Arsenalit



tës që kishin bërë për sulmuesin 17-vjeçar dhe sipas asaj që raporton "Gazzetta dello Sport", klubi francez i ka dhënë dritën jeshile transferimit të talentit në Itali. Me pak fjalë, M'Baje Niang duket vetëm një hap larg Milanit. Lëvizja vjen në një kohë delikate për sulmin kuqezi, ku vetëm para pak ditësh u dëmtua sërish Aleksandre Pato, i cili do të qëndrojë jashtë fushave të lojës për më shumë se një muaj.

Denilson, ideja më e fundit - Ideja më e fundit e Milanit për mesfushën duket se është Denilson. Siç

raporton "Skysports.com", mesfushori brazilian i Arsenalit, aktualisht i huazuar te San Paolo, mund të jetë objektivi primar i Masimiliano Allegri. Denilson është në pronësi të Arsenal por asnjëherë nuk e ka veshur fanelën e "Topçinjëve" pasi menjëherë u huazua në Brazil. Futbollisti i datëlindjes 1988 mund t'i bashkohet Milanit sërish në formën e huazimit për një sezon dhe më pas me të drejtë blerje të plotë të kartonit të tij. Një tjetër klub italian dhe disa rusë interesohen gjithashtu për Denilson.

Kur firmosi për Interin një vit e gjysmë më parë, me siguri Xhampalo Paçini mendoi po të njëjtën gjë, gjithsesi gjërat për të tashmë marrin një drejtim krejt tjetër dhe sulmuesi u prezantua te tifozët kuqezi duke thënë se nuk mund të refuzohet kurrësi një skuadër si Milani. Gjatë deklaratës së tij të parë për shtyp te klubi i tij i ri, 28-vjeçari u shfaq tepër entuziast. "Dëshiroj të jem sërish futbollisti që kam qenë 5 muaj më parë, kohë në të cilën isha tepër i rëndësishëm edhe për kombëtaren italiane". Paçini nuk mund të linte pa përmendur edhe shkëmbimin mes tij dhe ish-shokut të skuadrës te Sampdoria, Antonio Kasano. "Në momentin kur u vura në dijeni për këtë shkëmbim i telefonova menjëherë Antonios. Nuk i di arsytet që e shtynë të largohet nga skuadra, por e verteta është se ndihem shumë i lumtur që jam një futbollist i Milanit".

Sigurisht që edhe ndarja nga Interi nuk ka qenë aspak e thjeshtë për të, por duket se Pazzini e ka hedhur pas kravëve divorcin me zikaltërit. "Më telefonuan dhe më lajmëruan se nuk do të isha më pjesë e ekipit, madje as në ndeshjet miqësore. Besoj që është e kotë të mbaj inat pasi të vazhdosh të flasësh për të kaluarën, do të thotë të

Paçini: Këtu është maksimumi, Interi më përzuri!

Flet blerja e re e kuqezinjve: "Dua të kthehem lojtari që kam qenë 5 muaj më parë dhe gjithashtu dua të rifitoj kombëtaren"



Paçini prezantohet me fanelën e Milanit, do të mbajë numrin 11

hapësh polemika pa vlerë". Gjithsesi, nëse mund të shërbejë si ngushëllim, pavarësisht mënyrës se si u largua nga Interi, Xhampalo Paçini ndihet mirë pas mbështetjes që i kanë dhënë nëpërmjet mesazheve të ndryshme, ish-shokët e tij të skuadrës, duke i treguar se për ta vazhdon të mbetet "il pazzo", ose ndryshe i çmenduri, pasi një vit më parë

ishte pikërisht Paçini që me 2 gola e shënuar ndaj Çezenës u prishi festën kuqezinjve për titullin kampion, ndërsa tani është ai që ka nevojë për Milanin. Sidoqoftë, kjo ndoshta është mënyra më e mirë që 28-vjeçari toskan të rikthehet ai i mëparshmi, e të prekë nga afër njëkohësisht edhe kombëtaren e Prandelit, të cilën e ëndërron aq shumë.

7,5

milionë euro dhe kartonin e Kasanos shpenzoi Milani, për të marrë në skuadër sulmuesin, Paçini

Superkupa e Spanjës/ Post Barcelona - Real Madrid 3-2

Pike: Të mundesh nga Reali, njësoj sikur të hash m...!

“Vitin e kaluar kam vuajtur shumë nga humbja në “Camp Nou”, por këtë herë dominuam ne”. Mesi gërvisht: “Do ta ngremë Superkupën në “Bernabeu”

Mbrojtësi i Barcelonës, Xherard Pike, foli për ndeshjen e fituar ndaj Realit të Madridit, duke i dhënë shumë rëndësi fitores 3-2 në “Camp Nou”. Ky sukses ka qenë një çlirim për shtatlartin katalanas, i cili tregoi se sa ka vuajtur sezonin e kaluar, kur skuadra madriline fitoi në “Camp Nou”. “Vitin e kaluar më është dashur “të ha m...” për shkak të fitores së Realit, ndërsa këtë herë ishte e rëndësishme ta fillojmë me një fitore”, tha Pike, i cili mendon se tani skuadra është në rrugën e duhur. “Përshtypjet për këtë klasike të parë janë shumë të mira. E dominuam ndeshjen dhe e fituam atë. Padyshim që rezultati 3-2 është i kënaqshëm për ne, por duhet të bëjmë të njëjtën gjë në “Camp Nou”, tha Pike, i cili ishte një ndër më të mirët në fushën e lojës për Barçën. Megjith-

25

vjeç është Xherard Pike, i cili luan tek Barça që prej vitit 2008, kur katalanasit e blenë nga Manchester Junajtidi për 5 milionë euro. Për të ishte një rikthim te skuadra ku u formua si futbollist

atë, mbrojtësi 25-vjeçar “qan” rastet e humbura dhe pësimin e golit të dytë, që erdhi si pasojë e një gabimi amatoresk të portierit Valdes. “Ndonjëherë duhen shumë raste për të shënuar një gol, ndërsa Reali erdhi vetëm një herë në portën tonë dhe shënoi dy gola. Ndonjëherë është edhe çështje fati. Mendoj se duhet të kishim fituar më thellë, megjithatë largohemi të kënaqur nga kjo sfidë”.



Mesi-Edhe Lionel Mesi foli për fitoren e arritur ndaj rivalëve të përjetshëm: “Ishte një ndeshje shumë e vështirë, ashtu siç janë gjithmonë klasiket. Pësuam një gol, por u treguam të gatshëm për të përmbysur gjithçka. Jemi të kënaqur me rezultatin dhe shpresojmë që të ngremë Superkupën në “Bernabeu”.

Maskerano-Pa dyshim një ndër më të mirët në fushën e lojës, por pas

ndeshjes argentinasi ka dashur t'i japë kurajo portierit Valdes: “Janë gjëra që ndodhin. Viktor është një portier i jashtëzakonshëm dhe ka merita të mëdha në sukseset që kemi arritur. Ndonjëherë futbollit është edhe çështje fati, diçka që Valdes nuk e pati në atë moment me Di Marian. Superkupa? Me këtë fitore mendoj se jemi favoritë për ta fituar, por duhet të shënojmë me çdo kusht në “Bernabeu”.

Komenti Murinjo është po i njëjti, Vilanova fiton respektin

Klasikja e parë sezonale ishte edhe përballja e parë mes Hoze Murinjos dhe Tito Vilanovës, dy trajnerë që pas sherrit vitin e kaluar, këtë herë arritën të bënin paqe mes tyre.

Murinjo - Sfida e së enjtes tregoi edhe një herë tjetër se Reali dhe Murinjo janë po të njëjtët. Skemë e njëjtë loje, stil i ngjashëm dhe një skuadër që e pret kundërshtarin për të goditur me kundërsulm. Po të njëjtët futbollistë, por shumica prej tyre jashtë shumë larg kondicionit të duhur fizik. Mungesa e Pepes kushtëzonte shumë gjëra. Aktivizimi i Albiolit në qendër nuk jepte shumë garanci, ndërsa skuadra u desh që të mbronte shumë metra më pas. Murinjo tha se Barça nuk është një skuadër që ka dominuar, sepse nuk ka mundur të fitojë dy Champions League radhazi. Ndoshta mund të ketë pak të drejtë, por ndaj Realit historia vazhdon të mbetet e njëjta. Katalanasit dominojnë kundrejt në lojë, ndaj një skuadër që mendon vetëm të mbrojtë dhe që në pjesën e parë nuk e pa pothuajse asnjëherë “fytirën” e Valdesit. Ndoshta sepse ishte ndeshja e parë dhe Murinjo nuk donte që skuadra e tij të pësonte gol, megjithatë nuk ka snjë diskutim se Reali është po i njëjti. Asnjë ndryshim madje

edhe në konferencën për shtyp pas ndeshjes. Përsëri “e kap” me gjyqtarin, edhe pse ka një farë të drejte për golin e Pedros.

Vilanova - Dy ndeshje zyrtare, dy fitore. Tito Vilanova e ka nisur me “këmbën e mbarë” aventurën e tij me Barcelonën. Edhe pse është ende herët për të nxjerrë përfundime, dora e tij ndihet dukshëm në skuadrën katalanase. Stili vazhdon të mbetet i ngjashëm. Zotërimi i topit është vendimtar, lëvizshmëria është bazë dhe përqendrimi duhet të jetë maksimal. Edhe vetë Murinjo e pranoi në konferencën për shtyp pas ndeshjes se “Barça ishte superiore dhe se arriti të dominonte ndeshjen”. Eliminimi në gjysmëfinalen e Championsit sezonin e kaluar dhe humbja e titullit kampion i ka dhënë një motivim më shumë skuadrës katalanase, që pak nga pak po rikthehet aty ku duhet. Edhe pse pa Guardiolen, gjërat duken se po vzhdojnë në rrjedhën e tyre. Deri tani mund të flasin për një vazhdim ciklit, gjithmonë nëse Vilanova do të vazhdojë me këto ritme. Në futboll nuk ka asgjë të sigurt dhe fati i një trajneri varet nga çdo 90-minutësh. Për momentin Vilanova e ka fituar “betejën” e tij, por çka është më e rëndësishmja ka fituar respektin e të tjerëve.

Kasijas: Në Madrid do të jetë tjetër gjë!

Portieri i Realit të Madridit, Iker Kasijas, u shfaq optimist për finalen e kthimit të Superkupës së Spanjës, që do të luhet më 29 gusht në “Bernabeu”. Madrieneve u mjafton edhe një fitore minimale për të ngritur trofeun e Superkupës për herë të nëntë në historinë e tyre. “Ishte një ndeshje shumë e vështirë dhe duhet ta pranojmë se vuajtëm shumë. Në pjesën e parë menduam vetëm të mbronim dhe Barça e dominoi ndeshjen. Në 45 minutat e dyta gjërat shkuan më mirë për ne. Barça pati fatin që barazoi shumë shpejt, por në futboll duhet edhe fat”, tha Kasijas, i cili ishte vendimtar në pritjen që i bëri Mesit kur ndeshja ishte 3-1. Në aksionin e radhës, erdhi edhe gafa e Valdesit që e dërgoi ndeshjen në 3-2. “Largohemi të kënaqur nga kjo ndeshje. Goli i dytë na bën më shumë optimist dhe jam i bindur se në Madrid do të jetë tjetër gjë. I kemi të gjitha shanset për të fituar trofeun. Me mbështetjen e publikut do të arr-



“Me 3-1 do të kishte qenë shumë e vështirë, por goli i Di Marias na mbush me optimizëm”

ijmë të marrim atë që duam”.

Ozil - “Ishte një ndeshje shumë e vështirë dhe Barça ishte me shumë fat, sepse arriti të barazonte shumë shpejt. Më vjen keq që nuk arritëm të evitonim

këtë humbje, por edhe kështu është mirë. Tani duhet të mendojmë për ndeshjen e kthimit. Duhet me çdo kusht ta fitojmë ndeshjen dhe jam i bindur se kemi shumë shanse për ta bërë një gjë të tillë”.

7,2 mln ndjekin klasiken në Spanjë

Klasikja e parë sezonale mes Barcelonës dhe Realit të Madridit ka qenë kryefjala e të gjithë botës, duke patur një shikueshmëri shumë të lartë. Kanë qenë plot 7,2 milionë njerëz që e kanë ndjekur këtë ndeshje në Spanjë, duke qendruar me sytë nga “Camp Nou” për rreth dy orë. Minuta që arrin shikueshmërinë më të lartë është 70-ta, kur Leo Mesi merr përsipër të godasë penalltinë, duke shënuar golin e dytë për Barçën.

Fotolajm



Gafa e portierit Valdes është komentuar gjatë në shtypin spanjoll, por nga trajneri Vilanova e deri tek futbollistët, të gjithë e kanë mbështetur “gardianin” katalanas. “Janë gjëra që ndodhin, sepse i kemi thënë Valdesit që të jetë pjesë e lojës sonë kombinate”, tha trajneri i Barçës në konferencën për shtyp pas ndeshjes.

Falkao: S'jam aq i mirë sa Mesi e Ronaldo!

Radamel Falkao pranon se Lionel Mesi dhe Cristiano Ronaldo janë më të mirë se ai dhe shprehet se është i nderuar të luajë në një kampionat kundër dy futbollistëve më të mirë në planet. “Mesi dhe Ronaldo janë padyshim më të mirët në botë. Ata të dy janë të pabesueshëm. Realisht, unë jam shumë i lumtur të jam bashkëkohës me këta dy gjenitë të futbollit dhe t'i gëzohem asaj që dhurojnë në fushën e lojës”. Falkao ka shënuar 36 gola në 50 ndeshje me Atletikon në sezonin e kaluar, kur skuadra e drejtuar nga Diego Simeone arriti të fitonte Europa League.

Primera Division/ Java II

Sot	
R.Sociedad - Selta V.	19:00
Betis - R.Vajekano	21:00
Espanjol - Saragoza	21:00
Malaga - Majorka	23:00
Të dielën	
Osasuna - Barcelona	19:00
Getafe - Real Madrid	21:00
Granada - Sevija	21:00
Valencia - Deportivo	23:00
Të hënën	
Valadolid - Levante	20:00
Atletiko M. - A.Bilbao	22:00

Renditja

1.Barcelona	3
2.Betis	3
3.Deportivo	3
4.Majorka	3
5.Sevija	3
6.Malaga	3
7.R.Vajekano	3
8.Valadolid	3
9.Atletiko M.	1
10.Levante	1
11.Real Madrid	1
12.Valencia	1
13.Espanjol	0
14.Getafe	0
15.Selta V.	0
16.Granada	0
17.Saragoza	0
18.A.Bilbao	0
19.Osasuna	0
20.R.Sociedad	0

Edicioni i 50-të i kampeonatit gjerman të Bundesligës ka nisur me një të papritur, që, këtë radhë vjen nga Bajerni i Mynihut. Trajneri i bavarezëve, Jup Hajnkes, ka deklaruar vetëm një ditë përpara se Bajerni i tij të luajë ndaj Groitther Furthit, në javën e parë të Bundesligës se ai do të largohet nga skuadra që drejton në fund të këtij sezoni dhe se do të jetë një dorëheqje e parevokueshme. Një gjë të tillë trajneri e ka deklaruar për gazetën gjermane, "Süddeutschen Zeitung", në një intervistë që ai ka dhënë. Kështu, pavarësisht se në fund të prillit, drejtori i Bajernit, Karl Hainc Rumenige, kish thënë se "nëse ai do mund të rinovojmë kontratën që i skadon në vitin 2013", duket se Hajnkes tashmë e ka marrë vendimin e tij. Ndërkohë, lidhur me këtë, ka folur në fillim të gushtit edhe vetë drejtori sportiv, i sapoardhur tek bavarezët, Matias Samer. "Unë e di që kontrata e tij përfundon në 2013-n, por mesa kam informacion, një kontratë edhe rinovohet. Është në dorën e tij se cila do të jetë zgjedhja", ka thënë Samer. Por, kësaj pasigurie, më në fund, i është përgjigjur vetë Hajnkes, i cili ka deklaruar se ai do të tërhiqet dhe, pas fundit të sezonit s'do të jetë më trajneri i Bajernit. Trajneri, i ardhur në 1 korrik 2011 do të zhvillojë edhe sezonin e tij të fundit tek bavarezët, teksa dështimi i një sezoni më parë, ka sjellë padyshim edhe këtë vendim. Humbja e kampionatit, e Kupës së Gjermanisë, por edhe finales së Champions League-s, ka bërë që Hajnkes (pavarësisht Superkupës së sapofitur) të kuptojë se nuk ka se çfarë bën më me këtë skuadër. Këtë sezon ai ka një detyrë shumë të vesh-

Shokon Hajnkes: Iki nga Bajerni në fund të sezonit!

Trajneri gjerman lëshon bombën që në startin e Bundesligës; bavarezët nuk u besojnë veshëve



2013
është viti kur skadon kontrata e Jup Hajnkesit, teksa, me të përfunduar sezoni, ai nuk do ta rinovojë më atë

66 vjeç
është Jup Hajnkes, teksa e ka marrë Bajernin në verën e vitit 2011 dhe e ka nxjerrë atë të dytin, në të tre kompeticionet

tirë, që ta çojë këtë skuadër në vendin e parë të renditjes dhe, mesa duket, një gjë e tillë, nuk e ka bindur atë kaq shumë.

Guardiola - Ndërkohë, duket se tashmë, në fund të sezonit, mund të jetë Pep Guardiola kandidati kryesor për të drejtuar Bajernin e Mynihut. Tekniku katalanas, që çoi Barcelonën drejt rekordeve historike, jo vetëm në Spanjë, aktualisht nuk po drejton asnjë skuadër dhe ai është duke qëndruar pushim. Por, në fund të këtij sezoni, mesa duket Hënes dhe Rumenige, do të bëjnë një sforc për ta bindur, goftë kjo edhe financiare.

Rumenige: Ende s'e kuptoj si humbëm me Çelsin

Drejtori i Bajernit të Mynihut, Karl Hainc Rumenige, ende po vuan që të kuptojë se si bavarezët dështuan të mposhtin Çelsin në finalen e sezonit të kaluar në Ligën e Kampionëve. "Ju mund të shihni vetëm atë që vërtet ndodhi dhe të shikoni pa emocion. Unë e kam shikuar përsëri finalen e Champions-it gjatë pushimeve dhe më duhet të pranoj se ishte interesante. Sidoqoftë, unë nuk po mund të kuptoj se si kemi mundur të humbim atë ndeshje ndaj Çelsit. Ishte një rast jetësor dhe ne nuk e shfrytëzuam. Ne kurrë nuk do ta harrojmë këtë. Ju luani në finale në stadiumin tuaj dhe duhet të fitoni. Nuk ka lidhje nëse ekipi ishte favorit apo jo. Ne thjesht është dashur t'i mposhtim patjetër. Dhe ne humbëm pa pasur kurrëfarë fati në penallti", ka thënë Rumenige.

Dëmtohet Riberi, Shaqiri titullar

Bajerni i Mynihut do të luajë në ndeshjen e sotme, pa Frenk Riberinë ndaj Groitther Furthit. Mesfushori francez është dëmtuar në stërvitje dhe mesa duket nuk do të jetë në gjendje që të luajë në përballjen "derbi" të landit të Bavarisë. Por, surpriza është se, në vend të tij pritet të jetë Xherdan Shaqiri, i cili do ta nisë përballjen që nga 1' pikërisht në krahun e Riberisë, teksa, në anën tjetër do të jetë Roben dhe në mes të "rombit" Myler.

Franca

2 javë për Lavecín, Paris SG shpreson tek Ibra

Sulmuesi argjentinës ndëshkohet nga Disiplina për kartonin e kuq ndaj Ajaçios; Ançeloti shpëton për momentin, kthehet suedezi



Nuk nis mirë aventura e Lavecit në Francë. Kështu, dje, Komisioni i Disiplinës në Ligue 1 ka vendosur që ta skualifikojë sulmuesin argjentinës për tre ndeshje (por njëra, më pas është anuluar). Ish-lojtari i Napolit ishte nxjerrë me karton të kuq të dielën e shkuar në ndeshjen që PSG-ja kishte barazuar ndaj Ajaçios, pas një faulli shumë të rëndë, në dëm të një kundërshtari. Lavecit tashmë do të detyrohet të mos luajë në ndeshjet ndaj Bodosë, këtë të dielë dhe atë ndaj Lilës në 2 shtator. Ndërsa, përsa i përket trajnerit Karlo Ançeloti, edhe ai i nxjerrë nga pankina për protesta dhe një gjest antisportiv, do të dëgjohet nga Komisioni i Disiplinës më 13 shtator.

Ibra - Duket se tashmë, të gjitha shpresat e PSG-së janë tek sulmuesi suedez, gjigandi Zlatan Ibrahimović. Ish-lojtari i Milanit, që mungoi në sfidën me

Ajaçion (për shkak dëmtimi) do të kthehet të dielën dhe do të luajë ndaj Bodosë, ose të paktën kështu shpresohet. Sulmuesi ishte ai që shënoi dy gola në ndeshjen e parë të kryeqytetasve, teksa barazoi shifrat në 2-2, duke i dhënë një pikë shumë të vlefshme PSG-së së tij që po mundej.

Tiago Silva - Nga ana tjetër, duket se, këtë javë, e reja më e madhe e PSG-së do të jetë pikërisht mbrojtësi brazilian, Tiago Silva. Kështu, ish-mbrojtësi i Milanit, pritet të luajë që nga 1' dhe kjo do të jetë një "frymëmarrje" për skuadrën e Ançelotit, i cili, nga ana tjetër nuk do të jetë në pankinë këtë ndeshje. Parisi rikthehet në "Parc de Princes", pas barazimit 2-2, në javën e parë, teksa, barazimi i javës së dytë ka ardhur në Korsikë, ndaj Ajaçios, atje ku PSG-së iu fikën edhe dritat e stadiumit.

BUNDESLIGA / JAVA I

Dje	G. Furth - Bajern M.	15:30
Dortmund - Bremen	Hamburg - Nyrenberg	15:30
Rois 11', Gëtce 81' / Selasi 75'	Frankfurt - Leverkusen	18:30
Sot	Shtuttgart - Wolfsburg	20:45
Augsburg - Dyseldorf	Të dielën	
Borussia M. - Hofenhaim	Hanover - Schalke	17:30
Fraiburg - Mainz		

Renditja

Skudra	N	P	Skudra	N	P
1. Dortmund	1	3	10. Hamburg	0	0
2. Augsburg	0	0	11. Hanover	0	0
3. Leverkusen	0	0	12. Hofenhaim	0	0
4. Bajern M.	0	0	13. Mainz	0	0
5. Borussia M.	0	0	14. Nyrenberg	0	0
6. Frankfurt	0	0	15. Schalke	0	0
7. Dyseldorf	0	0	16. Shtuttgart	0	0
8. Fraiburg	0	0	17. Wolfsburg	0	0
9. G. Furth	0	0	18. Bremen	1	0

Dortmund s'gabon; por Bremeni e bën të vuajë

Një gol i Marko Rois dhe një tjetër i Gëtces kanë mjaftuar për t'i dhënë kampionëve suksesin

Ndeshja e parë e Bundesligës gjermane për sezonin 2012-13 i dhuron kampionëve në fuqi, Borussia Dortmundit tre pikët e para. Verdhezinjtë kanë mundur mbrëmë, edhe pse me vuajtje, në "muret" mike të "Eestfalenstadion"-it (sot "Signal Iduna Park") Verder Bremenin. Një Marko Rois i papërbajtshëm dhe një Mario

Gëtce në ditën e tij kanë mjaftuar për të marrë triumfin e parë dhe për të nisur presionin ndaj rivalëve të Bajernit të Mynihut. Megjithatë, goli i Gebre Selasisë ka rihapur lojën dhe ka barazuar shifrat, duke e bërë përballjen interesante përpara golit të Gëtces që ka bërë Klop të ngrihet nga stoli dhe të duartrokasë.

LIGUE 1 / JAVA III

Dje	Trojes - Lorient	20:00	
Evian - Lion	1-1	20:00	
Sot	Valensien - Ajaçio	20:00	
Nicë - Lilë	17:00	Të dielën	
Nensi - Tuluzë	20:00	Montpelie - Marsejë	17:00
Reims - Sosho	20:00	St. Etien - Brest	17:00
Rene - Bastia	20:00	PSG - Bordo	21:00

Renditja

Skudra	N	P	Skudra	N	P
1. Lion	3	7	11. Ajaçio *	2	2
2. Marsejë	2	6	12. PSG	2	2
3. Bastia	2	6	13. Montpelie	2	1
4. Bordo	2	6	14. Nicë	2	1
5. Lorient	2	4	15. Evian	3	1
6. Lilë	2	4	16. St. Etien	2	0
7. Tuluzë	2	4	17. Reims	2	0
8. Nensi	2	4	18. Rene	2	0
9. Valensien	2	4	19. Sosho	2	0
10. Brest	2	3	20. Trojes	2	0

* Ajaçio është penalizuar me -2 pikë

Manchester Siti nuk ka përfunduar ende merkaton e tij. Kështu, skuadra e "qytetarëve", duket se tani do të bëjë gjithçka për të mposhtur konkurrencën e fortë që pritet t'i bëjë Manchester Junajtdi këtë sezon. Fakti që drejtuesit e klubit blu nuk kanë arritur të përmbushin dëshirat e trajnerit Mançini gjatë kësaj merkatoje, e kanë çuar këtë të fundit deri në kërcënimeve konkrete madje në drejtim të klubit. Ai nuk mund ta kapërdijë dot humbjen e shumë prej futbollistëve që kishin në listë për të blerë. Dhe, pikërisht për këtë, sheiku Mansur mund të jetë i gatshëm t'i plotësojë atij një dëshirë të fundit përpara se merkato verore të mbyllet. Dhe dëshira më e madhe e Mançinit është Havi Martinez. Po, pikërisht mbrojtësi i Atletik Bilbaos, të cilin Bajerni i Mynihut tashmë ka nisur ta shikojë më larg. Kështu, sipas "Daily Mail", por edhe gjermanes "Bild", Mançini, së bashku me sheikun Mansur kanë një plan sekret për të marrë Martinezin. Madje, nga sa mësohet, duket se klubi bask po i bën të gjitha tentativat për të larguar bavarezët pikërisht sepse në lojë

Siti tenton t'i marrë Bajernit, Havi Martinezin

Sheiku Mansur dhe Mançini po presin që bavarezët të dorëzohen për të bërë ofertën zyrtare



Havi Martinez, lojtari problematik i merkatos

40

mln euro ka ofruar Bajerni i Mynihut për Martinezin, kërkesë e cila nuk është pranuar nga ana e Bilbaos

2

javë ka Martinez që vetëm stërvitet me skuadrën, teksa nuk ka luajtur në ndeshjen e parë të kampionatit spanjoll

Sherr me Argjentinën për Agueron

Kun Agueron është kthyer në një "mollë sherri" tashmë mes Manchester Silit dhe Argjentinës. Kështu, një javë pasi Peruja çoi në FIFA Bajernin pasi ai nuk i dha Klaudio Pizzaron për një ndeshje miqësore, këtë radhë duket se është Argjentina ajo që mund ta bëjë këtë me skuadrën angleze. Shkaku? Federata Argjentinase ka dërguar një ftesë për Agueron që të grumbullohet me përfaqësuesen, çka, sipas Silit, nuk do të jetë e mundur, pasi ai është i dëmtuar. Një gjë e tillë nuk i ka pëlqyer Argjentinës, e cila mund të protestojë në FIFA për këtë gjë. Megjithatë, duket se një "luftë" e tillë nuk do të përfundojë kaq kollaj. Mançini do që lojtari i tij të rikthehet në fushë, çka do të ndodhë pas një muaji (të paktën siç sqaron edhe stafi mjekësor i Silit), kurse Argjentina do ta marrë atë për ta future në ndeshje. Një gjë e tillë Mançini nuk mund ta lejojë dot, edhe pse kështu shkelet një rregullore e FIFA-s. Pra, ideja është e qartë. Komitetarja kërkon lojtarin që të shikojë gjendjen e tij, ndërsa Siti nuk do ta lodhë atë me rrugën deri në Amerikën e Jugut.

mund të jenë më shumë se 40 milionë euro nga ana e "qytetarëve". Gazeta "Bild" ka shkruar se Bajerni duhet të ketë kujdes, sepse Siti është gati të risë ofertën për Martinezin, sapo bavarezët të deklarojnë tërheqjen e tyre nga objektivi dhe kështu Bilbao do të dorëzohet. Pra, mesa duket, tashmë Siti po tenton t'ia "rrëmbejë" atë gjermanëve. Ndërsa, sipas "Daily Mail"-it, një gjë e tillë mund të ndodhë për të paktën një arsye. Martinez është lënë jashtë grumbullimit nga ana e trajnerit Bielsa, çka tregon se,

herët a vonë, ai do të largohet nga Bilbao. Kjo ka bërë që Siti, duke parë edhe problemet që ka Bajerni për ta marrë lojtarin - edhe pse është paraqitur me 40 milionë euro ofertë - mund të futet në tratativa. Martinez mund të jetë lojtari i fundit që Siti do të blejë këtë merkato, nëse arrin të bëjë këtë "ulje" në "Etihad". Megjithatë, ditët në vijim do të tregojnë se çfarë do të bëjë klubi dhe Mançini, i cili, nëse nuk merr këtë futbollist, mund të ketë probleme në prapavijë, atje ku trajneri italian mendon se shumë gjëra nuk shkojnë.

Ditët e pritjes për Robin Van Persin tashmë përfunduan. Kështu, pas aktivizimit të tij në minutën e 72-të në ndeshjen e parë dhe qëndrimin në stol për pjesën tjetër të kohës, tashmë Aleks Ferguson ka vendosur që ta aktivizojë sulmuesin e blerë për 24 milionë sterlina, si titullar në ndeshjen e sotme, ndaj Fulhamit. Kështu, në ndeshjen që do të luhet sot në "Old Trafford", në orën 16:00, tifozët do të kenë mundësi që, më në fund, të shikojnë në fushë që nga 1' Van Persin, së bashku me Uejn Runin. Një zgjedhje kjo që vjen menjëherë pas humbjes që Junajtid pësoi në ndeshjen e parë të kampionatit, teksa, të gjitha mediat iu "hakërryen" Fergusonit, për faktin se ky i fundit nuk e aktivizoi blerjen e tij më të shtrenjtë të kësaj vere në ndeshjen e parë të kampionatit, duke menduar se Evertoni mund të mundej lehtë, çka nuk rezultoi e tillë. Kështu, pas presionit të vazhdueshëm të mediave dhe të specialistëve të futbollit, më në fund, Ferguson vendosi ta aktivizojë Van Persin në ndeshjen e sotme ndaj Fulhamit. Dhe, sigurisht, duhet që edhe skuadra të punojë për të.

Junajtid vendos: Van Persi, titullar ndaj Fulhamit



Shakaja e Fergit: Më duhet mbrojtja e viteve '80?!

Pavarësisht seriozitetit në punë, edhe Aleks Ferguson, ndonjëherë mund të bëjë ndonjë shaka. Një shaka e tëra "angleze" për plakushin skocez, i cili, i pyetur nga gazetarët për merkaton, tha se tani Junajtid nuk do të blejë më këtë verë. Vetëm, nëse do të ishte fjala për Stiv Brusin dhe Geri Pelisterin (mbrojtësit e viteve '80-'90 të Junajtidit. Kështu, Fergi tha: "Nuk do bëjmë më blerje. Por, mund të marr në telefon Stiv Brusin dhe Geri Pelisterin dhe t'u kërkoj atyre që të rikthehen në mbrojtjen e Junajtidit tim të sotëm. Atëherë s'do të ketë njeri që do të na kalojë në mbrojtje. I imagjinoi në një skuadër me Van Persin dhe Runin?!".

Totenhami s'e lë Van der Vartin të iki

Rafael van der Vart nuk do të shkojë asgjekundi. Ka qenë ky vendimi i klubit të Tottenham Hotspurs, për sulmuesin holandez, i cili ishte nisur tashmë drejt Hamburgut, me dëshirën për t'u rikthyer tek ish-skuadra e tij, edhe për arsye familjare. Kështu, edhe pse gjermanët kishin bërë një ofertë prej 7 milionë sterlinash për të marrë lojtarin, tratativa është ndërprerë menjëherë nga klubi i Tottenhamit. Nuk dihen ende arsyet e kësaj ndërprerjeje, por duket se ka qenë pronari i Tottenhamit ai që nuk e ka lejuar një gjë të tillë.

Trajneri i Arsenalit tani kërkon të mos dalë me "gisht në gojë", këtë merkato

Nuri Shahin do të shkojë tek Liverpooli. Ka qenë vetë trajneri i Arsenalit, Arsen Wenger, ai që e ka pranuar se e ka humbur tashmë duelin me të kuqtë për mesfushorin turk të Realit të Madridit. Por, ai ka pohuar se do të kërkojë të blejë përforcime, deri në fund të merkatos. Tekniku francez ka parë të largohen nga skuadra dy lojtarë të rëndësishëm si Robin Van Persi e Aleks Song, por edhe ka blerë Santi Kazorla, Lukas Podolski dhe Olivier Zhirud. Me sa duket, ai kërkon t'i shtojë një tjetër emër skuadrës së tij. "Disa gjëra mund të ndodhin ende. Nuk dua të bëj premtime të cilat nuk mund t'i mbaj. Gjithçka nuk varet vetëm nga unë. Por mund të ketë ende lëvizje në merkato, hyrje dhe dalje". "Po punojmë në merkaton e lojtarëve dhe po shohim se çfarë mund të bëjmë për të përmirësuar skuadrën ekzistuese. Ndonëse merkatoja është e hapur për dy muaj, një muaj e tra javë është thuar e mbyllur pasi në javën e fundit çdo minutë bëhet e rëndësishme. Të gjithë kanë ecur ngadalë për 7-8 javë, ndërsa tani duket sikur vrapojnë, tani bëhet gjithçka më intensive".

Shahin i Liverpoolit; Wenger e pranon "dështimin"!

Çelsi blen Azpilikuëtën

Sezar Azpilikueta, më në fund, ka plotësuar dje transferimin e tij nga radhët e Olimpik Marsejës te Çelsi, duke u shfaqur edhe në stërvitjen e parë me ekipin e tij të ri. Lojtari 22-vjeçar iu bashkua për rreth 7 milionë sterlina skuadrës angleze, ndërsa kishte arritur të shpërthente me francezët dhe u kthye në një nga lojtarët më premtues në këtë rol.

Azpilikueta luajti në dy ndeshjet e para të kampionatit me Olimpik Marsejën, por, që sot është futbollist i Çelsit, pasi ka arritur të nënshkruajë një kontratë pesëvjeçare me blutë londinezë. Kështu, tashmë duket se londinezët e kanë kompletuar skuadrën.

Premier League / Java II

Sot	Orë	Lojtari	Orë
Suonsi - Uest Ham	13:45	Sandërlend - Reding	16:00
A. Vila - Everton	16:00	Totnam - Uest Brom	16:00
Man Junajtid - Fulham	16:00	Çelsi - Njukasëll	18:30
Noruç - QPR	16:00	Të dielën	
Sauthampton - Uigan	16:00	Stouk - Arsenal	14:30
		Liverpul - Man Siti	17:00

Renditja

Skuadra	N	P	Skuadra	N	P
1.Çelsi	2	6	11.Sandërlend	1	1
2.Fulham	1	3	12.Reding	2	1
3.Suonsi	1	3	13.Sauthampton	1	0
4.Uest Brom	1	3	14.Totnam	1	0
5.Man Siti	1	3	15.A.Vila	1	0
6.Njukasëll	1	3	16.Man Junajtid	1	0
7.Everton	1	3	17.Uigan	1	0
8.Uest Ham	1	3	18.Liverpul	1	0
9.Stouk	1	1	19.Noruç	1	0
10.Arsenal	1	1	20.QPR	1	0

FUNDI I ARMSTRONG I hiqen titujt dhe dënohet përjetë!

Agjencia amerikane e anti-dopingut, "USADA" i fshin 7 Turet e Francës; çiklisti e pranon vendimin

Dorëzohet çiklisti Lens Armstrong. Agjencia anti-Doping në SHBA, "USADA", ka deklaruar se do t'i heqë sportistit teksan të 7 titujt e fituar në Turin e Francës, pasi ish-çiklisti amerikan deklaroi se ai nuk do të luftonte më kundër akuzave të vazhdueshme që bëheshin ndaj tij për përdorim substancash të palejuara. Ky vendim pritet të shoqërohet edhe me përjashtimin e përjetshëm të Armstrong nga bota e çiklizmit.

Armstrong, i cili u tërhoq nga garat një vit më parë, vendosi të refuzonte procesin e arbitrimin nga "USADA",

41

vjeç është Lens Armstrong, teksa është tërhequr nga bota e çiklizmit në 23 shkurt të vitit 2011, një vit më parë

7

titujt turi i Francës, të fituara, do t'i hiqen tashmë atij nga Agjencia amerikane e anti-dopingut, "USADA"



pasi bëri të qartë se ishte lodhur duke luftuar pa fund ndaj akuzave që i bëheshin atij për përdorim substancash të palejuara. Ai tregoi se kush kërkonte përgjigje, do ta gjente atë tek qindra testet antidoping që ka bërë gjatë paraqitjeve të tij të jashtëzakonshme në Turin e Francës, gjatë viteve 1999-2005.

"Vjen një moment në jetën e një njeriu kur ai duhet të thotë "mjaf". Për mua ka ardhur kjo kohë. Jam përballur me akuzat për mashtrim në sukseset e mia në Turin e Francës. Kjo ka ndikuar në jetën time familjare dhe punën për fondacionin e bamirësisë, ndaj

më ka çuar te vendimi që kam marrë për t'i dhënë fund kësaj gjëje të pakuptimtë", thuhej në deklaratën e Armstrong për "AP" (associated press). Sipas "USADA"-s, kjo ishte prova e pranimin të fajit nga ish-çiklisti. "Kjo është një ditë e trishtueshme për të gjithë ne që dashurojmë sportin. Ky është një shembull trishtues për ata që duan të fitojnë me çdo kusht duke anashkaluar mundësinë që ta bëjnë këtë në rrugën me të ndershme dhe të sigurt. Nuk ka sukses kur dëshiron të mashtrosh", ishte deklarata që bënte drejtuesit e "USADA"-s.

Kanceri—Kjo është beteja e parë që Armstrong humbet në jetën e tij. Kështu, pasi ka fituar shumë tituj, ai ka fituar edhe betejën më të vështirë, atë me kancerin. Madje, asokohe, sipas vetë doktorit Kreig Nikols, onkologjisti i amerikanit, "impakti i trajtimeve për të luftuar kancerin e Lensit ishte shumë i fortë dhe shkatërrues, edhe nga ana e aparatit tretës. Dhe, nëse mua do të më kërkohet që t'i përgjigjesha pyetjeve: a) t'i mbijetosh sëmundjes; b) të mbash çdo nivel atletik pas trajtimit; c) të fitosh njërën nga Turet e Francës, sigurisht që nuk do të kisha marrë në konsider-

atë asnjërin nga këto, sepse mundësitë ishin të gjitha kundër tij". Por, Lensi i luftoi dhe i fitoi të trija betejat. Ai kishte kancer në mushkëri dhe e mposhti, u rikthye në formën e tij më të mirë dhe fitoi Turin e Francës. Por, beteja e fundit, ajo me dopingun, ishte e papërballueshme për çiklistin nga Teksasi. Aq sa, për herë të parë në jetën e tij, ai pranoi dorëzimin dhe ngriti "flamurin e bardhë". Pas shumë akuzash, më në fund, vjen edhe vendimi. Karrera e Armstrongut, tashmë mund të mbetet vetëm një kujtim i hidhur, për fatin e tij të keq dhe të tifozëve që e kanë mbështetur atë.

"Ndihem më mirë, në krahasim me 12 muaj më parë; kur shkoja në Nju Jork nga humbjet me Tsongën në Montreal dhe Berdish në Sinsinati dhe më pas gjysmëfinalja me Xhokoviçin ishte brutale, pasi humba 2 sete, me zero. Psikologjikisht jam i qetë me veten". I lumtur, i lirë, i sigurtë. Në moshën 31-vjeçare, Roxher Federer që fiton "Wimbledon"-in, shkon në finalen e Sinsinatit dhe e fiton edhe atë, teksa është favorit për suksesin në U.S Open, që nisin të hënën në çimenton e "Flushing Meadows". Sekretet e tij. "Vajzat rriten", thotë ai ai për binjaket Carlene Riva dhe Mila Roz. "Mirka dhe unë besojmë se mamaja dhe babai duhet të jenë të dy prezentë dhe po ia arrijmë, sepse atop o udhëtojnë me ne".

- Nuk arritët dot arin olimpiq që ëndërronit në këto 4 vitet e fundit...

- U zhgënjeva për 5 minuta, teksa prisja medaljen. Por, kur pashë lumturinë e Marreit dhe Del Potros që u ngjitën në podium me mua, thashë me vete se mund të jem i zhgënjyer, ose i kënaqur. Zgjodha të dytën, sepse jam krenar për veten. Kam medaljen individuale që ëndërroja që fëmijë dhe mora një edhe për Zvicrën. Po jetoj një verë ëndrrash".

- Finalen olimpike e keni humbur ju, apo e ka fituar Marrei?

"Do më duroni edhe 4 vite të tjera!"

Roxher Federer nuk e hedh "peshqirin"; tenisti zvicerian do të fitojë ende edhe shumë trofe



Federer për...

... Nadalin

"I uroj Rafas të kthehet sa më shpejt në fushë, me gjithë zemër. Unë e kuptoj se sa shumë po humbet ai me këtë dëmtim"

... rivalitetin

"Më përpara unë kërkova të matesha me Sampras, Agasin, Mojën, apo Henman; tani Tomiç, Raon, apo Gofin, duan të maten me mua"

- Arin e humba unë, duke mos shfrytëzuar rastet në fillim të ndeshjes. Ndoshta isha i lodhur prej gjysmëfinalës që zgjati 4 orë e gjysëm me Del Potron. Nuk kisha më energji. Megjithatë, respekto Endit.

- Xhokoviç, në fakt, s'ka qenë simpatik në veçanti...

- Ende me atë historinë e Devis? Është e 2006-s. Isha vetëm i mërziur, sepse, kundër mikut tim Stan (Uaurinka), thërriste trajnerin për gjëra që nuk i kuptoja. Por, në Madrid u sqarua. Gjërat

kanë ecur mirë mes nesh, pavarësisht se nuk i kam shkuar për darkë në Paris.

- Federer shkon mirë me të gjithë, edhe me ata që vuan, dkur Hjujt dhe Nallbandian, ndërsa sot, me Xhokoviç dhe Marrein...

- Ishin shumë rezistentë për mua: Mund të më kthenin gjithmonë një top mbropa, ndoshta nuk kishin shërbimin më të mirë, por unë kisha përgjigjen më të mirë. Dhe kështu nuk arrija të kisha avantazh dhe mbetesh në fund, duke bërë batuta. Por, më pas fillova t'ua merrja kohën dhe i sulmoja. E di se ç'mund të bëj unë dhe ç'mund të bëjnë ata. Sidomos, e di se në fund është sulmuesi ai që ka çelësin e suksesit. Pak si përballjet Sampras - Agasi. Andre ishte më agresiv, por Pit shkonte në maksimum dhe merrte më shumë rreziqe përsipër.

- Xhokoviç ka fituar Melburnin, Nadal Parisin, Federer "Wimbledon"-in, Marrei Olimpiadën: Në Nju Jork çdo të ndodhë?

- Këtë vit nuk do të përfundojë me kaq. Ka sërish turne të rëndësishëm, përfshirë Masters-at, por, me siguri situata është interesante dhe rrit volumin e "U.S Open". Por, është pikërisht ky ekuilibër që na thotë sa e vështirë është të bësh parashikime.

- Pavarësisht 16 triumfeve "Slam", edhe Federer

rrit ende volumin, teksa Nadal e ul atë për dëmtim...

- Rafës i uroj me gjithë zemër të kthehet sa më shpejt dhe më i fortë. Të jetë jashtë Olimpiadës dhe Nju Jorkut duhet t'i kushtojë shumë. Unë e quaj veten me fat për mënyrën se si reagon ende trupi im. Pastaj e adhuroj tenis, por edhe të lëviz nëpër botë dhe të shkoj në qytete të ndryshme. Nuk do të më pëlqente nëse ky lloj sporti do të ishte vetëm Europian.

- Ndoshta luan deri në Olimpiadën e Rios, në 2016-n...

- Mund të tërhiqem dhe më pas të rikthehem për një Olimpiadë. Jo, do të vazhdoj dhe më pas të shikojmë se si shkojnë gjërat. Rios? Është e mundur. Nëse mbaj këtë motivim që vjen nga fitoret dhe rekordet, si të kthehesh numri 1. Gjithësesi, për ne tenistët, edhe moshë e daljes në "pension" po rritet. Mjafton të shikosh se sa moshatarë janë ende kompetitivë, duke filluar nga Tomi Has. Më pëlqen, edhe sepse rinovohen rivalitetet e përgjithshme. Përpara isha unë që matesha me Agasin, Samprasin, Mojën, Henmanin. Kurse tani, njerëz si Tomiç, Raoniç, Gofin, Nishikori, ndoshta përmirësohen, duke u martur me ne veteranët.

Vuelta

Degekolb fiton etapën e shtatë

Është gjermani Xhon Degekolb (Argos-Shimano) ai që ka marrë në zbritje fitoren e tij të tretë në Turin e Spanjës (Vuelta 2012), në fund të etapës së shtatë (164,2 km nga Hueska, deri në Alkaniz). Në vendin e dytë është vendosur italiani Elia Viviani (Liguigas), ndërsa i treti ka përfunduar australiani Alan Devis (Orika-Grinedxh). Spanjollit Hoakim Rodrigez (Katusha) konservon deri tani edhe fanelën e liderit të klasifikimit të përgjithshëm, me 10 sekonda avantazh ndaj britanikut Kris Frum (Sky) dhe 36 sekonda ndaj spanjollit tjetër Alberto Kontador (Sakso).

Moto GP

Spis: S'kam menduar largimin

Nuk ka nisur në mënyrën më të mirë fundjava për Ben Spisin në Bërno të Çekisë. Pasi ka munguar në Laguna Seka të SHBA-ve, amerikani ka mbyllur dje provat e lira në pistën cceke në vend të tetë, duke u shkëputur me 9 të dhjetat nga kreu. Ajo që ka komplikuar punën e tij, ka qenë një rreshkitje në gjysmën e seksionit të dytë. Por, duket se ai nuk e ka aspak mendjen tek kjo mungesë e fati. Madje, ai ka thënë: "Do mundohem të bëj më të mirën. A kam menduar të tërhiqem? Në asnjë mënyrë, nuk e kam çuar nëpër mend", ka thënë ai.